



SHËRBIMET E UJËSJELLËS  
DHE KANALIZIMEVE  
NË RAJONIN E DANUBIT

# SITUATA E SEKTORIT

Raport Rajonal | Maj 2015

© 2015 International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore  
1818 H Street NW, Washington, DC 20433  
Telephone: 202-473-1000; Internet: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

**Deklarim.** Ky punim është një produkt i stafit të Bankës Botërore, me kontribut të jashtëm. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të saj të Drejtorëve Ekzekutivë, apo të qeverive që ata përfaqësojnë. Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë punim. Kufijtë, ngjyrat, prerjet dhe informacionet e tjera të treguara në çdo hartë të këtij punimi nuk janë gjykime nga ana e Bankës Botërore në lidhje me statusin ligjor të ndonjë territori apo mbështetje apo pranim të këtyre kufijve.

**Të Drejtat dhe Lejimet.** Materiali i këtij punimi i nënshtrohet të drejtës së autorit. Duke qenë se Banka Botërore inkurajon shpërndarjen e njohurive të saj, ky punim mund të riprodhohet i tërë ose pjesërisht, për qëllime jo tregtare, për sa kohë i referohet punimit plotësisht. Të gjitha pyetjet mbi të drejtat dhe licencat, përfshirë të drejtat e subsidiaritetit, duhet t'i drejtohen Office of the Publisher, The World Bank, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA; fax: 202-522-2422; e-mail: [pubrights@worldbank.org](mailto:pubrights@worldbank.org).

**Financimi.** Ky raport është hartuar me mbështetjen e **Programit të Ujit të Danubit (Danube Water Program)** financuar nga Qeveria e Austrisë. Ekipi i Programit mund të kontaktohet në adresë: Praterstraße 31, 20th floor, A-1020 Vienna  
Telefon: +431 217 07 48; Internet: [www.danube-water-program.org](http://www.danube-water-program.org)  
Email: [office@danube-water-program.org](mailto:office@danube-water-program.org)

**Burime të mëtejshme.** Ky raport është pjesë e shqyrtimit Situata e Sektorit drejtuar nga David Michaud, Banka Botërore. Autorët mirëpresin komente dhe mund të kontaktohen përmes David Michaud ([dmichaud@worldbank.org](mailto:dmichaud@worldbank.org)). Një variant elektronik i raportit si dhe 16 shënime për vendet, janë të mundësuar në adresën [SoS.danubis.org](http://SoS.danubis.org). Informacioni mbi performancën e shërbimeve komunale është i mundësuar në adresën [www.danubis.org/eng/utility-database](http://www.danubis.org/eng/utility-database). Burime të tjera për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve në secilin vend, janë mundësuar në faqet burimore të vendeve në faqen e internetit të DANUBIS, me adresë: ([www.danubis.org](http://www.danubis.org)).



Vienë, Austri / Maj 2015

# Përmbajtja

Përmbajtja.....	i	V. PERFORMANCA E SHËRBIMEVE	38
Kutitë .....	ii	A. Cilësia e Shërbimit dhe Praktikat me Klientët	38
Figurat .....	iii	B. Efikasiteti.....	42
Tabelat.....	v	C. Shtysat dhe Prirjet e Performancës së Përgjithshme .....	45
Shkurtimet.....	vi	VI. FINANCIMI I SHËRBIMEVE	51
<b>MIRËNJOHJE</b>	<b>vii</b>	A. Burimet e Financimit: Tarifat, Tatimet dhe Transfertat .....	51
<b>FJALË HAPËSE</b>	<b>viii</b>	B. Shpenzimet e Shërbimeve: Kostot e Operimit dhe Investimeve.....	54
<b>PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME</b>	<b>x</b>	C. Rikuperimi i Kostos: Prirjet e Kostove dhe Tarifave .....	55
<b>I. HYRJE</b>	<b>1</b>	D. Trajtimi i Përbalueshmërisë .....	57
<b>II. KONTEKSTI I SHËRBIMEVE</b>	<b>3</b>	VII. PËRFUNDIME	61
A. Pikëpamja Historike .....	3	A. Qëndrueshmëria e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Ndotura në Rajon.....	62
B. Situata Social-Ekonomike .....	5	B. Sfidat e Mbetura .....	64
C. Organizimi Administrativ .....	9	C. Mundësitë .....	67
D. Burimet Ujore dhe Ndryshimet Klimaterike ..	10	D. Fushat e Punës së Ardhshme.....	68
<b>III. ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE</b>	<b>14</b>	<b>FAQET E VENDEVE</b>	<b>71</b>
A. Ofrimi i Shërbimeve.....	14	<b>SHËNIME METODOLOGJIKE</b>	<b>104</b>
B. Politikë Bërja.....	22	A. Të dhënat e aksesit .....	104
C. Menaxhimi i Burimeve .....	24	B. Indeksi i Performancës së Kompanive Komunale të Ujit .....	106
D. Rregullimi .....	25	C. Financimi i Sektorit .....	108
E. Monitorimi dhe Matja e Sektorit .....	28	D. Përlllogaritja e përbalueshmërisë.....	109
<b>IV. AKSESI NË SHËRBIME</b>	<b>30</b>	E. Vlerësimi i Qëndrueshmërisë së Shërbimeve të Ujit .....	109
A. Uji .....	30	<b>BURIMET</b>	<b>111</b>
B. Shërbimet Sanitare dhe Kanalizimet .....	33		
C. Trajtimi i Ujërave të Ndotura .....	35		

## Kutitë

Statusi i integritimit në BE në rajonin e Danubit. . . . .	4
Përmbytjet e vitit 2014 në Bosnje Hercegovinë . . . . .	12
Rajonalizimi i ndërmarrjeve komunale në Kosovë, 2002-2007 . . . . .	16
Karakteristikat e kompanive komunale me performancë të mirë . . . . .	18
Upper Austria Water, një shoqatë kooperativash rurale. . . . .	21
Direktiva e Kuadrit të Ujit. . . . .	22
Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane. . . . .	23
Direktiva e Ujit të Pijshëm . . . . .	23
Agjencitë kombëtare të ujit. . . . .	25
Burimet rajonale të informacionit mbi sektorin: IBNET dhe DANUBIS.org. . . . .	28
Kërkesa për largimin e ushqyesvenë basenin e Danubit . . . . .	35
Standardet teknike në rajonin e Danubit. . . . .	37
Standardet e shërbimit dhe zgjidhjet me efikasitet kostoje nën direktivat e BE-së . . . . .	37
Standardet e cilësisë së ujit të pijshëm . . . . .	40
Standardet e cilësisë për trajtimin e ujërave të ndotura . . . . .	40
Uji pa të ardhura . . . . .	42
Indeksi i Performancës së Kompanive të Ujit . . . . .	45
Kuadri Tre T i OECD-së . . . . .	51
Performancae subvencioneve . . . . .	60



## Figurat

Figura 1: Vendet e mbuluara në raportin rajonal të situatës së sektorit . . . . .	1	Figura 22: Mbulimi me ujë nga rrjeti 2000-12. . . . .	30
Figura 2: Statusi i anëtarësimit në BE në rajon. . . . .	4	Figura 23: Përqindja e popullatës me ujë rrjeti sipas vendndodhjes dhe llojit të ofrimit . . . . .	31
Figura 3: PBB për frymë, 1990-2013. . . . .	5	Figura 24: Vendndodhja e popullatës pa ujë rrjeti në banesë . . . . .	32
Figura 4: Rritja e të ardhurave në 40% e poshtëm . . . . .	5	Figura 25: Aksesimi në ujë rrjeti – popullata e përgjithshme, 40 përqindshi i poshtëm dhe më të varfrit. . . . .	32
Figura 5: Numri dhe përqindja e të varfërve që konsumojnë më pak se 2.50 usd / ditë, ppp . . . . .	6	Figura 26: Aksesimi i romëve dhe fqinjëve të tyre jo Romë në shërbime uji dhe shërbime sanitare . . . . .	33
Figura 6: Romët fitojnë më pak se fqinjët e tyre dhe fëmijët e tyre hasin rrezik më të madh varfërie. . . . .	7	Figura 27: Mbulimi me kanalizime, 2000-12 . . . . .	33
Figura 7: Vendndodhja e të varfërve (që jetojnë me më pak se 2.50 usd/ditë, ppp) . . . . .	7	Figura 28: Përqindja e popullatës me tualete private me shkarkim dhe lidhje me kanalizimet, sipas vendndodhjes . . . . .	34
Figura 8: Prirjet e popullsisë në zonën ujëmbajtëse të Danubit . . . . .	8	Figura 29: Vendndodhja e popullatës pa akses në tualete private me shkarkim. . . . .	34
Figura 9: Numri i bashkive dhe popullsia mesatare për bashki për vend . . . . .	9	Figura 30: Aksesimi në tualete private me shkarkim – popullata e përgjithshme, 40 përqindshi i poshtëm, dhe më të varfrit. . . . .	35
Figura 10: Burimet e rinovueshme me ujë të ëmbël për frymë në vendet e basenit të lumit danub . . . . .	10	Figura 31: Mbulimi me trajtim të ujërave të ndotura në rajon, 2012 . . . . .	36
Figura 11: Reshjeve në vend / burimet e brendshme ujërave të ëmbla për vendin . . . . .	11	Figura 32: Krahasimi i mbulimit me trajtim ujërash të ndotura midis vendeve anëtare të BE-së, vendeve kandidate dhe vendeve jashtë BE-së . . . . .	36
Figura 12: Ndryshimet mesatare të temperaturave vjetore, 2021-2050 . . . . .	11	Figura 33: Shkalla e përputhshmërisë me kërkesat e direktivës së ujërave të ndotura urbane: largimi, trajtimi dhe trajtimi më i rreptë . . . . .	37
Figura 13: Ndryshimet mesatare të reshjeve verore, 2021-2050 . . . . .	11	Figura 34: Vazhdimësia e shërbimit në vendet e rajonit të Danubit . . . . .	39
Figura 14: Gjendja ekologjike e ujit të lumenjve në basenin e lumit danub (gjatësia në lidhje me gjatësinë totale) . . . . .	12	Figura 35: Kënaqësia e klientit me cilësinë e ujit në vitin 2013 dhe krahasuar me performancën e shërbimit . . . . .	41
Figura 15: Gjendja kimike e ujit të lumenjve në basenin e lumit danub (gjatësia në lidhje me gjatësinë totale) . . . . .	12	Figura 36: Evoluimi paralel i lidhjeve të matura dhe konsumi për frymë në kompanitë kampion nga vendet e përzgjedhura në rajon . . . . .	41
Figura 17: Shpërndarja e ujit të ëmbël sipas përdorimit. . . . .	13	Figura 37: Konsumi banimi ujit në vendet e rajonit . . . . .	42
Figura 16: Raporti midis ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore burim ujit të pijshëm . . . . .	13	Figura 38: Uji i shpërdoruar në vendet e rajonit . . . . .	43
Figura 18: Ofruesit e shërbimit të ujit dhe popullata e shërbyer në çdo vend. . . . .	15	Figura 39: Evoluimi i kostove të energjisë për m3 prodhuar në kompanitë kampion në rajon. . . . .	43
Figura 19: Numri dhe masa mesatare e kompanive komunale të ujit në rajonin e Danubit . . . . .	15	Figura 40: Evoluimi i efikasitetit të plotësisimit me staf me kalimin e kohës në rajon (uji dhe ujërat e ndotura) . . . . .	44
Figura 20: Niveli i centralizimit të pronësisë së kompanive komunale dhe ofrimit të shërbimit. . . . .	17		
Figura 21: Koha e krijimit të agjencive rregullatore të themeluara në rajonin e Danubit . . . . .	25		

Figura 41: Raporti i mbledhjes (të ardhurat në para / të ardhurat e faturuara) në vendet e rajonit. . . . .	44	Figura 55: Kostot o&m dhe tarifat rezidenciale (uji i pijshëm dhe ujërat e ndotura) në vendet e rajonit . . .	56
Figura 42: Karakteristikat dhe përfaqësimet e kampionit ibnet për llogaritjet WUPI . . . . .	45	Figura 54: Evoluimi i faturës vjetore për njësi uji të pijshëm dhe kanalizimesh në ofruesit/vendet e përzgjedhura . . . . .	56
Figura 43: Proporcioni i fitimit me treguesin e performancës së përdorimit të ujit në secilin segment përqindjeje prej 20%. . . . .	46	Figura 56: Mbulimi i kostos operative në vendet e rajonit (të ardhurat operative të faturuara/kostot operative) . . . . .	57
Figura 44: Proporcioni i fitimit me treguesin e performancës së përdorimit të ujit në secilin segment performance përqindjeje prej 20% me kalimin e kohës. . . . .	47	Figura 57: Tarifat aktuale të përballueshmërisë së ujit të pijshëm dhe ujit të ndotur nga grupet e ndryshme të të ardhurave: mesatarja (paneli i majtë) dhe 40% i poshtëm (paneli i djathtë). . . . .	58
Figura 45: Konvergjenca e fitimeve të ulëta dhe të larta me kalimin e kohës. . . . .	47	Figura 58: Kufizimet e mundshme të përballueshmërisë për të ardhurat mesatare . . . . .	58
Figura 46: Performanca e fitimeve në rajonin e Danubit dhe lidhja e tyre me nivelin e tarifës. . . . .	48	Figura 59: Kufizimet e mundshme të përballueshmërisë për 40% e poshtëm . . . . .	59
Figura 47: Performanca mesatare e fitimit nga sasia e përdorimit . . . . .	48	Figura 60: Vlerësimi i progresit të sektorit në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme për të gjithë . . . . .	61
Figura 48: Sektori financiar ndërmjet vendeve të rajonit për frymë dhe përqindja e PBB . . . . .	51	Figura 61: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve në rajon (sa më i lartë, aq më mirë) . . .	63
Figura 49: Proporcioni i financimit të sektorit nga tarifat, taksat dhe transfertat në vendet e rajonit të Danubit. . . . .	52	Figura 62: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve krahasuar me ppb për frymë në vendet e rajonit . . . . .	64
Figura 50: Prirjet dhe burimet kryesore të financimit të jashtëm për investimet në ujë dhe ujëra të ndotura. .53		Figura 63: Ku janë këto tualete me shkarkues ose uji nga rrjeti në rajonin e Danubit? . . . . .	65
Figura 51: Shpërndarja e shpenzimeve të përgjithshme që shkojnë drejt o&m dhe investimeve. . . . .	54	Figura 64: Hendeku për praktikat më të mira ndërkombëtare për një kampion kompanish komunale në rajon . . . . .	66
Figura 52: Kostot e investimit aktual krahasuar me ato të nevojshme për frymë në vendet e rajonit . . . .55		Figura 65: Mbulimi i kostos o&m dhe hendeqet financiare në investime në rajon . . . . .	67
Figura 53: Evoluimi i kostove operative për njësi uji të pijshëm dhe kanalizimesh në ofruesit/vendet e përzgjedhura . . . . .	56		



## Tabelat

Tabela 1: Lloji, numri dhe madhësia mesatare e kompanive komunale në rajonin e Danubit	16
Tabela 2: Qeverisja e kompanive komunale në vendet e rajonit	19
Tabela 3: Panoramë e shoqatave të ujit në rajon dhe shërbimeve që ofrojnë	20
Tabela 4: Tarifat e burimeve ujore	24
Tabela 5: Praktikat e rregullimit ekonomik në vendet e rajonit të Danubit	26
Tabela 6: Tiparet kryesore të agjencive rregullatore në rajonin e Danubit	27
Tabela 7: Sisteme të institucionalizuara informacioni për performancën e kompanive dhe skemate matjes në rajon	29
Tabela 8: Vazhdimësia e shërbimit në vendet e rajonit të Danubit	39
Tabela 9: Praktikat rajonale të mbrojtjes së konsumatorit	40

Tabela 10: Ndikimi irritjes së performancës mbi tarifat	49
Tabela 11: Tiparet kryesore të financimit të sektorit në rajonin e Danubit	53
Tabela 12: Evolucionin e ofrimit të shërbimeve të ujit	62
Tabela 13: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve vend për vend	64
Tabela 14: Burimet e të dhënave dhe pyetjeve të familjeve	105
Tabela 15: Treguesit, njësitë dhe shkallët wupi	106
Tabela 16: Përkufizimi i treguesve wupi	107
Tabela 17: Treguesit, njësitë dhe shkallët e vlerësimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve	110
Tabela 18: Përkufizimet e treguesve të vlerësimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve	110

## Shkurtime

ARA	Asociatia Romana a Apei (Shoqata Rumune e Ujit)	LSMS	Anketimi i Matjes së Standardeve të Jetesës
BiH	Bosnje Hercegovina	MICS	Anketimi i Grupimeve me Shumë Tregues
BOT	Ndërto-Opero-Transfero	n.a.	Nuk Mundësohet
CEN	Comité Européen de Normalisation (Komiteti Evropian për Normalizim)	NRW	Ujë pa të Ardhura
CPA	Agjenci e Mbrojtjes së Konsumatorit	O&M	Operim dhe Mirëmbajtje
DWD	Direktiva e Ujit të Pijshëm	OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
DWP	Programi i Ujit i Danubit	OVGW	Österreichische Vereinigung für das Gas- und Wasserfach (Shoqata Austriake e Gazit dhe Ujit)
KE	Komisioni Evropian	p.e.	e Barasvlershmja e Popullatës
EEA	Agjencia Mjedisore Evropiane	PPP	Partneritet Publik Privat
BE	Bashkimi Evropian	PPP	Barazia e Fuqisë Blerëse
BE MS	Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian	SHUKALB	Shoqata e Ujësllës Kanalizime e Shqipërisë
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë	SILC	Anketimi mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto	SoS	Situata e Sektorit
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (Agjencia Gjermane e Bashkëpunimit Teknik)	UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
HBS	Anketimi i Buxhetit Familjar	UWWTD	Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane
IAWD	Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive Ujësllëse në Zonën Ujëmbledhëse të Lumit Danub	BB	Banka Botërore
IBNET	Rrjeti Ndërkombëtar i Matjeve	WDI	Treguesit e Zhvillimit Botëror
ICPDR	Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit Danub	WFD	Direktiva e Kuadrit të Ujit
IFI	Institucioni Ndërkombëtar Financiar	OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
IPA	Instrument i Para Anëtarësimi	WISE	Sistemi i Informacionit i Ujit për Evropën
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit	WSS	Ujësllës dhe Shërbime Sanitare
JMP	Program i Përbashkët Monitorimi i OBSH / UNICEF	WUPI	Indeksi i Performancës së Shërbimit Komunal të Ujit





# MIRËNJOHJE

Ky raport u përgatit nga një ekip i stafit të Bankës Botërore dhe këshilltarë të drejtuar nga David Michaud. Ekipi i këshilltarëve përbëhej nga Stjepan Gabric, Kirsten Hommann, dhe Anastasia Shegay. Të dhënat dhe analizat mbështetëse u përgatitën nga Michael Klien, Maria Salvetti, dhe Petra Sauer. Konsolidimi dhe vërtetimi i të dhënave u drejtua nga Nikolaus Clemenz me mbështetjen e Katharina Baumgartner, Angelika Heider, Christoph Leitner, dhe Eva Staribacher. Raporti u redaktua nga Diane Stamm dhe u faqos nga Miodrag Veselinovic. Angelika Heider ofroi mbështetje të përgjithshme bashkërenditëse. Autorët mirëpresin komente dhe mund të kontaktohen përmes David Michaud (dmichaud@worldbank.org).

Shënimet e Vendeve përkatëse u përgatitën nën drejtimin e Maria Salvetti, me mbështetjen dhe mbledhjen e të dhënave nga individët dhe institucionet e mëposhtme: Semira Kasimati (Shqipëri), OVGW (Austri), Selim Babic dhe Nebojsa Budovic (Bosnje dhe Hercegovinë), Ivaylo Kolev (Bullgari), Miroslav Steinbauer (Kroaci), Miroslav Klos (Republika Çeke dhe Sllovakia), REKK (Hungari), Ramiz Kokollari (Kosovë), Georgi Hristov (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), Evghenii Caraus (Moldavi), Dragan Cvetkovic (Mali i Zi), ARA (Rumani), Ninoslav Petrovic (Serbi), Primoz Banovec (Slloveni), dhe MDI (Ukrainë). Ndihmesa specifike e vendeve është e përfshirë në Shënimet e Vendeve përkatëse.

Ekipi dëshiron të falënderojë në veçanti shqyrtuesit Caroline van den Berg, Manuel Marino, Diego Rodriguez, Dominick de Waal, dhe Philip Weller, si dhe Anna Bjerde, Anna Cestari, Stéphane Dahan, Alexander Damlenko, Sumila Gulyani, Michael Jacobsen, Ivaylo Kolev, Igor Palandzic, Christoph Prandstetten, Paula Restrepo, Jennifer Sara, Steven Schonberger, Vladimir Tausanovic, Dina Umali-Deining, Violeta Wolff, dhe stafin dhe ekipin drejtues të Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura të Shqipërisë, Rrjetin Aguan në Bosnje dhe Hercegovinë, Komisionin Rregullator të Energjisë dhe Ujit në Bullgari, Autoritetin Rregullator Hungarez të Energjisë dhe Shërbimeve Komunale Publike, Zyrën Rregullatore të Ujit dhe Ujërave të Ndotura të Kosovës, Autoritetin Rregullator Rumun të Shërbimeve Vendore Publike, Zyrën Rregullatore të Industrive të Rrjetit në Sllovakia, Komisionin Kombëtar për Energjinë Shtetërore dhe Rregullimin e Shërbimeve Komunale Publike në Ukrainë, dhe shumë individë e institucione të tjera në të gjithë rajonin për mbështetjen, komentet dhe informacionet e tyre të dobishme përgjatë ideimit dhe realizimit të këtij studimi dhe Shënimeve mbështetëse për Vendet.

Ky raport është produkt i Bankës Botërore pjesë e programit të Ujit të Danubit ([www.danube-water-program.org](http://www.danube-water-program.org)) financiar nga Qeveria Austriake. Ky kontribut ka mirënjohjen tonë të plotë.

Ky raport i plotësohet me 16 shënime vendesh që përshkruajnë në detaje më të thella situatën e sektorit në secilin nga vendet e mbuluara nga shqyrtimi i Situatës së Sektorit. I gjithë materiali është i mundur në mënyrë elektronike në adresën [SoS.danubis.org](http://SoS.danubis.org). Burime të tjera mbi shërbimet e ujës-jellësit dhe ujërave të ndotura, shërbimet komunale, dhe politikat në Rajonin e Danubit mund të gjenden në adresën [DANUBIS.org](http://DANUBIS.org).

# FJALË HAPËSE

## Junaid Ahmad,

DREJTOR I LARTË, PRAKTIKA UJORE BOTËRORE, GRUPI I BANKËS BOTËRORE

Të Dashur Kolegë,

Dy vjet më parë, 120 zyrtarë dhe profesionistë përgjegjës për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve në rajonin e Danubit u mbledhën në Vienë për të diskutuar situatën e sektorit dhe për të hapur Programin e Ujit të Danubit. Atëherë, ashtu si edhe sot, përparësia ishte shkëmbimi i përvojave dhe njohurive rreth prirjeve rajonale, sfidave dhe mundësive për të siguruar politika inteligjente, shërbime komunale të shëndosha dhe shërbim të qëndrueshëm për të gjithë. Në shumë aspekte, diçka e tillë pasqyron vetë qasjen e Bankës Botërore për të reduktuar varfërinë e tejskajshme dhe për të rritur prosperitetin e ndarë, që janë edhe synimet madhore të institucionit tonë.

Në Praktikën Botërore të Ujit, ne nuk përqendrohemi vetëm tek mundësimi i shërbimit, por gjithashtu edhe tek qëndrueshmëria dhe ne e kuptojmë se institucionet dhe politikat kanë rëndësinë e tyre. Në punojmë me klientët tanë dhe me analizat dhe njohuritë më të mirë të mundësuar për të informuar, hartuar dhe zbatuar politikat dhe programet që do të rezultojnë në shërbime ujësjellësi dhe ujërash të ndotura të qëndrueshme për të gjithë, veçanërisht për të varfrit dhe më pak të privilegjuarit. Si rrjedhojë, jam veçanërisht i kënaqur t'ju paraqes këtë shqyrtim rajonal të Situatës së Sektorit, që shpresoj t'ju ofrojë një bazë tjetër për vijimin e shkëmbimeve të rëndësishme për gjetjen e zgjidhjeve për qytetarët e këtij rajoni.

Dëshiroj të falënderoj përzemërsisht Ministrinë e Financës të Austrisë, mbështetja financiare e së cilës ka qenë thelbësore për suksesin e Programit të Ujit të Danubit. Dhe veçanërisht për realizimin e këtij studimi dëshiroj të falënderoj Shoqatën Ndërkombëtare të Kompanive Ujësjetëse në Zonën Ujëmbajtëse të Lumit Danub, që ka qenë një partnere e fuqishme e Bankës Botërore në kuadrin e Programit të Ujit të Danubit, dhe akoma më veçanërisht dëshiroj t'ju falënderoj ju, individët dhe institucionet që ka dhënë kontribut me informacion, njohuri, përvojë, dhe kohë për aktivitetet e Programit dhe këtë raport në veçanti. Shpresoj që në rastin e këtij raporti barra t'ia ketë vlejtur qiranë. Mirëpres vijimin e këtij partneriteti për të siguruar shërbime të qëndrueshme për të gjithë në rajonin e Danubit.



Junaid Ahmad

Drejtor i Lartë  
Praktika Botërore e Ujit  
Grupi i Bankës Botërore



## Walter Kling

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I IAWD

Krijimi i Programit të Ujit të Danubit kishte të bënte me bashkimin e dy organizatave shumë të ndryshme. Nga njëra anë ishte IAWD një shoqatë shërbimesh komunale ujësjellëse në zonën ujëmbledhëse të Lumit Danub, dhe Banka Botërore ishte ana tjetër. Bashkimi i këtyre dy organizatave shumë të ndryshme pasqyrohet në menaxhimin e programit, ku IAWD është përgjegjëse për ngritjen e kapaciteteve, veçanërisht drejtpërsëdrejti për ndërmarrjet komunale, ndërsa Banka Botërore është kryesisht përgjegjëse për politikën, anën analitike, dhe aspektet e qeverisjes së programit. Pavarësisht këtyre ndarjeve, programi është menaxhuar në mënyrë të përbashkët, duke u përqendruar tek ndërlidhja midis përvojës dhe rrjeteve të organizatave përkatëse.

Ky studim i Situatës së Sektorit është një produkt i këtij bashkimi, ku Banka ka marrë drejtimin dhe ka sjellë përvojën e saj tejet të gjerë botërore dhe aftësitë analitike për të hartuar një studim rajonal i pari në llojin e tij për shërbimet ujësjellëse. IAWD është e kënaqur që ka luajtur një rol mbështetës për mbledhjen e të dhënave dhe duke ofruar informacione të nevojshme, por në të njëjtën kohë është gati të luajë një rol më të madh duke u siguruar që ky studim të shtyjë veprimtari për të përmirësuar shërbimet.

Ekipi i Bankës Botërore ka bërë një punë për t'u përgëzuar gjatë analizimit dhe paraqitjes së informacionit mbi sektorin. Pritshmëria ynë është që studimi do të lehtësojë dhe do të mbështesë debatin në nivel të lartë rreth problematikave në lidhje me politikën (si, caktimi i tarifave, ofrimi i shërbimit për të varfrit), por edhe për fillimin e diskutimit në nivelin e ndërmarrjeve komunale se si të organizohen dhe administrohen sa më mirë shërbimet ujësjellëse për të arritur në shërbime efikas edhe të frytshme. Banorët e rajonit të Danubit kanë të drejtën e ujit dhe të shërbimeve sanitare të pastra, të sigurt dhe efikas dhe ky studim shqyrton se ku janë mangësitë që pengojnë arritjen e këtij qëllimi.

Studimi dhe puna analitike që është bërë për të, janë etapa të rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve ujësjellëse. IAWD mirëpret ndërmarrjen e një roli aktiv në lidhje me kuptimin dhe përdorimin e informacionit të paraqitur në këtë studim tejet informues. Ne gjithashtu do të vijojmë të punojmë me komunitetin e personave aktivë në sektorin e ujit për të marrë mesazhin dhe mësimet e këtij studimi dhe të punojmë së bashku për të siguruar politika inteligjente, ndërmarrje të shëndosha dhe shërbime të qëndrueshme në rajonin e Danubit.

Sinqerisht,



Walter Kling

Sekretari i Përgjithshëm  
Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive Ujësjellëse  
në Zonën Ujëmbledhëse të Lumit Danub (IAWD)

# PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport analizon progresin dhe sfidat e 16 vendeve në zonën ujore të Danubit në lidhje me ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme ujësjellëse dhe të ujërave të ndotura për të gjithë, ndërkohë që përmbushin acquis mjedisore të Bashkimit Evropian. Pas krijimit të kontekstit të shërbimeve të ofruara, raporti analizon organizimin e shërbimeve në rajon dhe nivelin e aksesit në shërbime, pra sa të suksesshme janë vendet në lidhje me ofrimin e aksesit në ujë dhe shërbime të largimit të ujërave të ndotura për të gjithë popullatën. Më pas raportin shqyrton performancën e sektorit, përfshirë cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe kënaqësinë e klientëve. Gjithashtu raporti jep një panoramë të efikasitetit të shërbimeve, përfshirë faktin nëse ato pasqyrojnë praktikën e mira të njohura dhe pranuar. Së fundmi, raporti analizon financimin e shërbimeve, duke shqyrtuar nëse sigurohet financimi i veprimtarisë, mirëmbajtja, dhe investimet dhe nëse ato janë të përballueshme. Raporti plotësohet me 16 shënime për vendet që mundësohet në adresën SoS. danubis.org.

Raporti e merr informacionin në pjesën dërrmuese nga burime ekzistuese publike të dhënash në nivel kombëtar dhe rajonal, dhe i njehson ato në një analizë dhe narrativë koherente dhe rajonale. Metodën e analizës përfshijnë krahasime horizontale midis vendeve në momente të caktuara kohe dhe midis prirjeve brenda vendeve apo në rajon përgjatë një periudhe kohe. Duke gatur parasysht mangësitë në mundësimin dhe krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet të 16 vendeve, raporti mundohet të inkurajojë dhe të japë informacion për një dialog politikash mbi sfidat e sektorit, dhe jo vetëm të japë një grupim të prerë rekomandimesh për politika.

## Konteksti

Pjesa më e madhe e zonës ujëmbajtëse të Danubit ka patur një trajektore të përbashkët përgjatë 30 viteve të fundit dhe zhvillimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe atyre sanitare ka ndjekur një proces pak a shumë të ngjashëm transformimi. Ky proces është shtyrë nga dy procese politiko-ekonomike, rënia e sistemeve komuniste dhe integrimi në Bashkimin Evropian (BE). Ndërkohë që në periudhën post socialiste shumica e vendeve përjetuan një decentralizim të fuqishëm dhe përfshirje me rëndësi nga sektori privat, integrimi në BE ka sjellë nevojën për legjislacion të përmirësuar për shërbimet bashkiake, futjen e parimit të rikuperimit të kostos, një shtysë drejt ndryshimeve strukturore, dhe efikasitet më të madh e qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve.

Pas përqaimit të parimeve ekonomike të bazuara në ekonominë e tregut dhe kufijve të hapur, vendet kanë arritur rritje të konsiderueshme në PBB për frymë, megjithëse ka ndryshime midis vendeve. Megjithatë rreth 2.3 milion njerëz në rajonin e Danubit jetojnë me më pak se 2.50 USD në ditë (barazia e fuqisë blerëse [PPP]), që është edhe niveli rajonal i varfërisë ekstreme. Të varfrit jetojnë në raport të zhdrejtë në zonat rurale dhe ka 10 deri në 12 milion Romë, që është edhe grupi më i madh dhe më i varfër minoritar në rajon.

Baseni i Lumit Danub është relativisht i pasur në burime ujore, dhe megjithëse kjo pasuri nuk është e ndarë në mënyrë të barabartë midis pjesëve të ndryshme të basenit, vetëm një vend, Republika Çeke, mund të konsiderohet si me probleme në burime ujore, duke patur një nivel më pak se 1.700 metra kub burime të rinovueshme ujore për frymë në vit. Ujërat tokësore janë burimi dominues i furnizimit me ujë në rajon, duke prodhuar rreth 72% të ujit të pijshëm. Administrimi i ujit në basenin e Danubit drejtohet nga parimet e Direktivës së Kuadrit Ujor të BE-së (WFD), nën mbikëqyrjen e Komisionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit Danub (ICPDR).

## Organizimi i Shërbimeve

Organizimi i shërbimeve karakterizohet kryesisht nga decentralizimi i ofrimit të shërbimeve dhe nga pronësia në nivel bashkiak, ndërsa përfshirja e sektorit privat mbetet më së shumti e kufizuar. Të shtyrë nga procesi i anëtarësimit në BE, disa nga prirjet e kohëve të fundit përfshijnë grumbullimin dhe kthimin në korporatë të ofruesve të shërbimeve dhe krijimin e autoriteteve të pavarura rregullatore.



Afërsisht tre të katërtat e popullatës së rajonit marrin shërbime publike nga një prej më shumë se 10.000 ndërmarrjeve komunale ofruese formale në rajon, ndërsa pjesa tjetër mbështetet tek ofruesit jo formalë apo vetë shërbehen, veçanërisht në zonat rurale. Madhësia e ofruesve formalë ndryshon shumë, dhe mesatarisht baza më e madhe konsumatore shërbehet nga ofruesit privatë, ndjekur nga ofruesit rajonalë, bashkiakë, dhe ata të vegjël. Në përpjekje për të përfituar nga ekonomitë e shkallës dhe për të lehtësuar thithjen e fondeve të BE-së, disa vende po promovojnë bashkimin e ofruesve të vegjël në ofrues rajonalë. Menaxhimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura shpesh ofrohet nga e njëjta kompani shërbimesh komunale, përveç disa vendeve ku ato janë entitete të veçanta.

Hartimi i politikave të sektorit mbetet përgjegjësi e autoriteteve të qeverisë qendrore, ndërkohë që axhenda e BE-së dhe harmonizimi i direktivave të BE-së për ujin si Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane dhe Direktiva e Ujit të Pijshëm, janë një forcë kyçe shtytëse e ndryshimeve në sektor. Në 15 vitet e fundit, është vënë re një prirje drejt një rregullimi të pavarur më të zgjeruar të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura, dhe nëntë vende kanë autoritete rregullatore të tilla. Të gjithë rregullatorët luajnë një rol formal në përcaktimin dhe miratimin e tarifave, shpeshherë përkrah qeverive vendore, por vetëm tre prej tyre trajtojnë sektorin e ujit veçanërisht dhe ato ndryshojnë shumë nga pikëpamja e pavarësisë. E përbashkëta e të gjitha autoriteteve është vështirësia e rregullimit të një numri të madh ndërmarrjesh publike në pronësi të bashkive që priren më së shumti nga përparësitë vendore se sa nga fitimet financiare.

Përveç disa vendeve, të dhënat dhe informacioni mbi sektorin dhe ofruesit kyç të shërbimeve është akoma relativisht i paplotë dhe të dhënat disa herë nuk kanë vijueshmëri dhe kanë cilësi të kufizuar. Përpjekjet për të gjurmuar performancën e ndërmarrjeve dhe për t'i krahasuar ato me homologët e tyre dhe praktikatat e mira ndërkombëtare po shtohen, por informacioni rrallëherë bëhet publik.

## Aksesi në Shërbime

Aksesi për shërbime ujësjellësi dhe sanitare në rajon është i lartë krahasuar me pjesën tjetër të botës. Largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura, nga ana tjetër, mbetet prapa niveleve të larta të aksesit në ujë rrjeti dhe tualete me shkarkim vetjak, veçanërisht në lidhje me standardet e BE-së. Mbulimi i familjeve me ujë rrjeti ka qenë vijueshmërisht i lartë që prej fillimit të mijëvjeçarit, me 83% të popullatës që ka ujë nga rrjeti në banesat e tyre, duke lënë kështu 17% ose rreth 22.5 milion njerëz pa këtë shërbim, sidomos në zonat rurale. Romët kanë përgjithësisht akses më të ulët në shërbime uji dhe sanitare krahasuar me pjesën tjetër të popullatës, rreth 80% e popullatës së zonës së Danubit raportojnë se kanë një tualet me shkarkim në shtëpitë e tyre, ama vetëm 66% e tyre janë të lidhur me rrjetet publike të kanalizimeve. Ndryshimet më të mëdha vihen re në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, dhe në Malin e Zi. Më pak se 20% e më të varfërve dhe më pak se gjysma e 40% të poshtëm të popullatës kanë një tualet vetjak në Bullgari, Moldavi dhe Rumani. Mbulimi me trajtim të ujërave të ndotura ka patur përmirësime të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, por ama mbetet akoma shërbimi më pak i zhvilluar i sektorit në rajon.

## Performanca e Shërbimeve

Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujit dhe të ujërave të ndotura për sa i përket cilësisë dhe efikasitetit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në rajon, dhe është përgjithësisht nën praktikatat e mira ndërkombëtare. Megjithatë, ka patur prirje pozitive nga një sërë pikëpamjesh. Në shumë prej vendeve të rajonit, shërbimi me ujë është përgjithësisht i vazhdueshëm dhe uji i pijshëm është në standardet kombëtare të cilësisë. Nuk është për t'u habitur se kënaqësia e klientëve është më e lartë aty ku edhe cilësia e shërbimit është më e lartë, por në përgjithësi mekanizmat e mbrojtjes së konsumatorit nuk janë të zhvilluara si duhet, veçanërisht në vende pa agjenci rregullatore. Në shumë vende niveli i matjes së konsumit është rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe ka tashmë pothuajse mbulim universal me matës, duke e ulur kështu konsumin individual të ujit në 100 litra për frymë për ditë deri në 120 litra për frymë për ditë në shumicën e vendeve, që përkon edhe me standardet e BE-së. Me gjithë përmirësimet dhe konvergjencën, efikasiteti i ndërmarrjeve komunale në shumicën e vendeve, është nën standardet ndërkombëtare, dhe uji që nuk sjell të ardhura dhe punësimi mbi nevojat në ndërmarrjet komunale mbeten sfida me rëndësi.



Raporti përdor një Tregues të Performancës së Ndërmarrjeve Ujës-jellëse (WUPI) të propozuar për të vlerësuar performancën e përgjithshme të ndërmarrjeve. Analiza e WUPI tregon se performanca ndryshon shumë brenda rajonit dhe në çdo vend, por edhe që ajo përgjithësisht rritet me nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit. Performanca e përgjithshme e ndërmarrjeve ujës-jellëse është përmirësuar gjatë 10 viteve të fundit, dhe ato ndërmarrje që tregojnë performancë më të mirë përgjithësisht kanë edhe tarifa më të larta. Një analizë ekonometrike tregon se ndërkohë që ndërmarrjet më të mëdha kanë prirjen të punojnë më mirë se ndërmarrjet e vogla, nuk është e qartë nëse bashkimi i ndërmarrjeve komunale (grumbullimi apo rajonalizimi) sjell gjithmonë një ndikim pozitiv në performancën e përgjithshme.

## Financimi i Shërbimeve

Rritja e kostove ka sjellë rritje të tarifave në të gjithë rajonin, deri në atë pikë sa shërbimet mund të bëhen të papërballeshme nga klientët me të ardhura të ulëta në disa vende. Megjithatë rajoni është larg zbatimit të parimit të rikuperimit të kostos të Direktivës për Kuadrin e Ujit. Në përgjithësi niveli i financimit të sektorit nga tarifat, tatimet dhe transferimet ndryshon midis vendeve të ndryshme, ndërkohë që vendet e BE-së kanë nivele më të larta financimi për frymë. Struktura e financimit është gjithashtu e ndryshme midis vendeve, por në përgjithësi investimet mbështeten nga fonde publike dhe transferime nga jashtë, ndërsa shpenzimet operative mbulojnë më së shumti nga të ardhurat e ndërmarrjeve nga tarifat. Me gjithë përfshirjen e gjerë të parimit të rikuperimit të kostos në legjislacionin kombëtar, vetëm dy vende, Austria dhe Moldavia, vendi më i pasur dhe më i varfër përkatësisht, varen më së shumti tek tarifat për financimin e sektorit. Pak vende kanë krijuar një mekanizëm të përkushtuar për financimin e sektorit duke siguruar fonde të parashikueshme, dhe tashmë fondet e BE-së përbëjnë pjesën më të madhe të financimit të huaj në rajon.

Sektori përdor mesatarisht rreth gjysmën e të gjitha shpenzimeve për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe gjysmën tjetër për rinovimin dhe zgjerimin e saj. Investimet në ujës-jellës dhe sisteme të ujërave të ndotura në rajon kapin rreth 3.5 miliard USD në vit, që është dukshëm më pak se 5.5 miliard USD të përlogaritur nga vendet përkatëse si nevoja për të arritur pikësynimet kombëtare dhe ato të BE-së. Kosto e ofrimit të shërbimit ndryshon midis vendeve, por kjo kosto është rritur në masë të konsiderueshme gjatë 20 viteve të fundit, duke sjellë edhe rritjen paralele të tarifave. Si kostot operative dhe ato të mirëmbajtjes dhe tarifat rezidenciale zakonisht ndjekin nivelin e zhvillimit ekonomik të vendeve, dhe kostot e tarifat më të larta shihen në vendet e BE-së.

Me gjithë rritjen e tarifave, nivelet aktuale janë akoma të përballueshme për konsumatorin e mesëm, dhe përlogaritjet e shpenzimeve të 40%-shit më të varfër tregojnë se ata kanë kufizime të dukshme me përballimin vetëm në Ukrainë. Disa vende kanë përcaktuar kufij për të identifikuar kufizimet e përballueshmërisë në më pak se 5% të të ardhurave, dhe Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Sllovenia, dhe Ukraina raportojnë se kanë skema formale subvencionimi për të siguruar përballueshmërinë për persona me të ardhura të ulëta.

## Përfundime

Raporti arrin në përfundimin se sektori i ujës-jellësit dhe ujërave të ndotura është ndikuar fuqishëm nga trajektorja e rajonit gjatë 30 viteve të shkuara, duke kaluar nga një periudhë komuniste përmes një faze tranzicioni dhe duke u përfshirë në procesin e anëtarësimit në BE. Procesi i anëtarësimit në BE shërben si një shtysë për të përmirësuar aksesin, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të ujit dhe vlerësimit tregojnë se statusi i vendeve në lidhje me anëtarësimin në BE është i lidhur në mënyrë pozitive me nivelin e zhvillimit të shërbimeve të ujërave të ndotura. Disponueshmëria e të dhënave është e kufizuar, duke përfshirë çuditërisht edhe vende më të zhvilluara si Austria dhe Sllovenia. Nevojitet punë e mëtejshme analitike për të kuptuar disa nga aspektet e ofrimit të shërbimeve në rajon, si situata e popullatës pa akses në ofrim publik, shtysat e performancës së ndërmarrjeve komunale, ndikimin e reformave të vazhdueshme institucionale, mënyrat për të trajtuar përballueshmërinë afatgjatë të shërbimeve, dhe administrimin më të mirë të mundshëm të trajtimit të ujërave të ndotura nga pikëpamjet financiare dhe institucionale.

Pavarësisht mangësive në informacion dhe të dhëna, dalin në pah disa sfida të qarta ndërsa vendet përpiqen të ofrojnë shërbime të qëndrueshme për të gjithë qytetarët, duke qenë në përputhje me acquis mjedisore të BE-së,



përfshirë sa vijon: (a) ndërkohë që ofrimi i shërbimeve mbetet përgjegjësi e qeverisjes vendore në shumicën e vendeve, prirjet e politikave në lëmin e anëtarësimit në BE prirën ta vendosin sektorin nën mbikëqyrjen e shtuar rregullatore dhe institucionale të qeverisjes qendrore, duke krijuar kështu nevojën për mekanizma të qartë llogaridhënie; (b) pavarësisht nivelit të lartë të aksesit në shërbim në rajon dhe përqendrimit në mbledhjen dhe administrimin e ujërave të ndotura, ka akoma 22.5 milion persona që nuk marrin ujë nga rrjeti në ambientet e tyre dhe ka akoma 28 milion persona që nuk kanë tualete me shkarkim; (c) performanca e ofruesve të shërbimeve është përmirësuar në 15 vitet e fundit, por mbetet akoma nën standardet ndërkombëtare, duke kërcënuar qëndrueshmërinë afatgjatë të programeve të vazhdueshme të investimeve; (d) kuadri i përgjithshëm i financimit të sektorit nuk garanton shërbim universal dhe me cilësi të lartë në periudhën afatgjatë, dhe ndërkohë që parimi i rikuperimit të kostos është gjerësisht pjesë e legjislativitetit, shumë ndërmarrje komunale mezi po rikuperojnë kostot e tyre të operimit nga tarifat dhe investojnë shumë pak për administrimin dhe zhvillimin e aseteve.

Me gjithë këto sfida, rajoni mund të zhvillohet më tej bazuar në disa mundësi të rëndësishme. Historia e kohëve të fundit ka treguar se sektori i ujit dhe ujërave të ndotura është i gatshëm për ndryshime, dhe nëse qeveritë që po shqyrtojnë reforma në rreth një të tretën e vendeve, i bazojnë përpjekjet e tyre në analiza të shëndosha, ato mund të vijojnë të krijojnë moment pozitiv për sektorin. Integrimi në BE vazhdon të përbëjë një mundësi të jashtëzakonshme për politika dhe financim në shumë vende; miratimi i gjerë i kuadrove rregullatore formal dhe kthimit të ndërmarrjeve në korporata mund të sjellë llogaridhënie më të lartë; dhe pavarësisht mungesës së suksesit në menaxhim, sektori ka një fuqi punëtore teknike të shëndoshë. Raporti gjithashtu tregon nevojën për punë të mëtejshme në përgjigje të disa sfidave të identifikuar dhe pikat ku informacioni i disponueshëm aktualisht është tejet i kufizuar për të arritur në përfundime të qarta. Shembuj të analizave të mëtejshme përfshijnë krijimin e modeleve për të ofruar shërbime të qëndrueshme në zonat përtej shtrirjes së ndërmarrjeve publike, trajtimin e sfidave të përballueshmërisë përmes subvencionimeve të mirë përcaktuara, dhe / ose përmirësimin e kuadrit financues dhe institucional për trajtimin e ujërave të ndotura në ato vende me përvojë të mëparshme të munguar apo të kufizuar.





# I. HYRJE

1. **Qeveritë dhe profesionistët e ujit në rajonin e Danubit po përballen me një sfidë të përbashkët që ka lidhje me përmbushjen e kërkesës së qytetarëve të tyre për shërbime universale, me cilësi të lartë, efikase, dhe financiarisht të shëndosha, ose me fjalë të tjera shërbime të qëndrueshme, ndërkohë që përpiqen të ruajnë hapin me kërkesat mjedisore të acquis të Bashkimit Evropian.** Ashtu siç tregon edhe ky raport, kërkohet punë për të ofruar shërbime uji dhe ujërash të ndotura për të gjithë Rajonin e Danubit, veçanërisht për sa i përket anëtarëve të rinj ose të ardhshëm të BE-së. Miliona persona në rajon nuk kanë ujë nga rrjeti në banesat e tyre, apo një tualet me shkarkim dhe pjesa më e madhe e këtyre personave përbëhet nga 40%-shi i poshtëm, nga të varfrit dhe nga minoritetet. Disa ofruet shërbimesh kanë akoma vështirësi me ofrimin e vazhdueshëm të ujit të pijshëm klientëve të tyre; tarifat e ulëta dhe praktikat jo efikase të ndërmarrjeve krijojnë sfida për operimin dhe mirëmbajtjen e duhur të infrastrukturës ekzistuese. Në të njëjtën kohë, për të qenë në përputhje me acquis, Direktiva e Kuadrit të Ujit po harmonizohet në kuadrot ligjorë dhe institucionalë të vendeve të rajonit, dhe po ndërmerren investime të mëdha për përmirësimin apo zhvillimin e asetëve të ujit dhe ujërave të ndotura, që në vetvete krijojnë pengesa të mëtejshme teknike dhe financiare për ofruesit e shërbimeve. Si rrjedhojë, qeveritë në rajon po rishqyrtojnë mënyrën si ofrohen dhe financohen shërbimet dhe ky shqyrtim i Situatës së Sektorit përpiqet të dokumentojë dhe të japë informacion mbi procesin, duke treguar se si politikat që nuk përqendrohen vetëm tek përputhshmëria me legjislacionin e BE-së, por që përqendrohen më gjerë në ofrimin e shërbimeve universale, me cilësi të lartë, efikase dhe financiarisht të shëndosha për të gjithë, përfshirë edhe të varfrit do të ndihmojnë me përmbushjen e frymës të acquis të BE-se dhe pritshmërive të qytetarëve në një mënyrë të qëndrueshme dhe të barabartë.



**FIGURA 1**  
 VENDET E MBULUARA NË RAPORTIN RAJONAL TË SITUATËS SË SEKTORIT

BURIMI: KRIJUAR NGA AUTORËT.

2. **Raporti i Statusit të Sektorit analizon progresin dhe sfidat e rajonit në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme të ujit dhe ujërave të ndotura për të gjithë.** Synimet paralele të Bankës Botërore janë të zhdukë varfërinë ekstreme dhe të rrisë prosperitetin e të gjithëve, dhe uji luan një rol të rëndësishëm në arritjen e tyre. Si rrjedhojë raporti përqendrohet dhe i jep vëmendje të veçantë kuptimit të situatës së 40%-shit të poshtëm të popullatës (për sa i përket të ardhurave), dhe të të varfërve ekstremë që jetojnë me më pak se 2.50 USD në ditë PPP. Ndërkohë që një pjesë e informacionit është e disponueshme vetëm për shërbimet e ofruara nga ndërmarrjet komunale, raporti ka si qëllim të mbulojë të gjithë popullatën, përfshirë zonat rurale. Shqyrtimi mbulon 16<sup>1</sup> vende që janë brenda ose në kufi me zonën ujore të Danubit (Figura 1), që përfaqësojnë një diversitet të madh realitetesh social-ekonomike, zhvillimore, dhe

1 Një pjesë e vogël e territorit kombëtar të Gjermanisë, Italisë dhe Zvicrës janë gjithashtu brenda Zonës Ujëmbajtëse të Danubit. Megjithatë, këto tre vende nuk janë mbuluar, sepse historikisht ato nuk janë parë si pjesë e rajonit të Danubit dhe realiteti dhe organizimi i shërbimeve të tyre të ujit ka rëndësi të drejtpërdrejtë të kufizuar për vendet në zonën ujëmbajtëse.

gjeografike, por që ndajnë një burim të përbashkët si Danubi; një histori të ndërthurur; dhe një trajektore të ngjashme drejt integritimit në Evropë. Duke patur parasysh rëndësinë e procesit të anëtarësimit në BE për shërbimet e ujit, raporti paraqet shumë rezultate veçmas për shtetet anëtare të BE-së, vendet kandidatë (përfshirë kandidatët e mundshëm) dhe vendet jashtë BE-së. Raporti është një produkt parësor i Bankës Botërore / Programit të Ujit të Danubit të Shoqatës Ndërkombëtare të Kompanive të Furnizimit me Ujë në Zonën Ujëmbajtëse të Lumit të Danubit (IAWD) ([www.danube-water-program.org](http://www.danube-water-program.org)), që i ofron mbështetje paralele shumë prej palëve të interesit në rajon për të arritur **politika inteligjente, ndërmarrje të fuqishme, dhe shërbime të qëndrueshme.**

**3. Analiza merr për bazë se dhënia e shërbimeve të qëndrueshme varet nga katër dimensione kryesore: infrastruktura e aksesit duhet të jetë e ngritur, ofruesit e shërbimeve duhet ta operojnë dhe mirëmbajnë atë, një qeverisje të sektorit që i ndihmon ata të zhvillohen, dhe mekanizmat e duhur të financimit për të mirëmbajtur dhe zgjeruar shërbimet në periudhën afatgjatë.** Përpara se të përshkruhen këto katër dimensione, Kapitulli II përqendrohet në kontekstin në të cilin jepen shërbimet; Kapitulli III jep një panoramë të organizimit dhe qeverisjes së sektorit në vende të ndryshme; Kapitulli IV përshkruan nivelin e aksesit në shërbime uji dhe ujërash të ndotura në rajon; Kapitulli V merret me performancën e ofruesve të shërbimeve në lidhje me cilësinë e shërbimit, efikasitetin, dhe performancën në përgjithësi; Kapitulli VI diskuton financimin e shërbimeve; dhe kapitulli VII paraqet përfundimet. Një sërë kuadratesh me tekst japin informacion shtesë mbi praktikën e mira apo konceptet kyçe. Raporti përfshin edhe dy shtojca; e para (Faqet e Vendeve) ofron një listë gjithëpërfshirëse, vend për vend, me tregues; dhe e dyta (Shënime Metodologjike) ofron detaje të mëtejshme metodologjike në lidhje me pjesët kryesore të raportit. Raporti gjithashtu përfshin, përgjatë të gjithë dokumentit, një listë gjithëpërfshirëse me burime mbi të gjitha të dhënat dhe informacionin e përdorur. Raporti plotësohet me 16 Shënime për Vendet, që japin detaje më të thella mbi Situatën e Sektorit në secilin vend. I gjithë materiali është i mundur në internet në faqen **sos.danubis.org**. Informacione të mëtejshme janë gjithashtu të disponueshme në platformën e ujit **www.DANUBIS.org**, një grumbullim në internet me burime për dhe mbi shërbimet e ujit dhe ato sanitare në rajonin e Danubit.

**4. Ky raport mbi shqyrtimin e Situatës së Sektorit është rezultat i një përpjekjeje në ekip ku kanë kontribuar më shumë se 30 persona të shpërndarë në të gjithë zonën ujore të Danubit dhe më tej, dhe është krijuar më së shumti mbi të dhëna të disponueshme për publikun dhe një përmbledhje punimesh nga shumë institucione në rajon, përfshirë edhe ministrinë e linjës, autoritetet rregullatore, dhe shoqatat kombëtare të ujit.** Raporti bazohet gjerësisht në burime ekzistuese me të dhëna publike në nivele kombëtare dhe rajonale, megjithëse ky raport përfaqëson përpjekjen e parë kur këto të dhëna janë konsoliduar në një narrativë dhe analizë koherente rajonale. Të dhënat e vendeve (njohur si "mbledhja e të dhënave SoS") u mblodhën nga një ekip me këshilltarë vendorë në secilin nga vendet e mbuluara nga raporti, dhe ato u vërtetuan me palët kyçe të interesit në çdo vend. Në mënyrë që teksti kryesor të ishte i lexueshëm, shumë nga referencat janë dhënë në fund të raportit, bashkë me disa nga përshkrimet metodologjike. Të dhënat kombëtare u plotësuan me të dhëna nga anketime vendase të bëra publike në secilin vend, si dhe me burime rajonale si EUROSTAT-i i BE-së, AQUASTAT-i i FAO-s, Treguesit e Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore, WISE e Agjencisë Mjedisore Evropiane (EEA), Programi i Përbashkët i Monitorimit i WFIO / UNICEF dhe baza e të dhënave e IBNET / DANUBIS. Gjatë përgatitjes së raportit u bënë supozime, dhe megjithëse u bë një përpjekje e madhe për verifikime, pritet që disa nga të dhënat dhe informacionet e dhëna mund të vihen në pikëpyetje. Përgatitja e raportit ka nxjerrë gjithashtu në pah se disa nga vendet kanë informacion shumë më të mirë se të tjera vende, dhe ndonjëherë statistikën zyrtare nuk janë në përputhje të plotë me realitetin e njohur nga profesionistët e sektorit. Për këto arsye, ekipi mirëpret komente dhe korrigjime.

**5. Ndërkohë që është treguar kujdes i madh për të siguruar vijueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave dhe informacionit, qëllimi kryesor i këtij raporti është të mbështesë një dialog të informuar rreth sfidave të sektorit, më shumë se sa të ofrojë një grup të përcaktuar me rekomandime për politika.** Ky raport nuk do të zgjidhë, në vetvete, sfidat e theksuara në kapitullin e fundit. Me qëllim, raporti kufizohet në një analizë të situatës aktuale dhe nuk përfshin rekomandime formale për politika as për rajonin dhe as për vendet në veçanti. Palët kombëtare të interesit kanë një pozicion më të mirë për të diskutuar nëse duhet dhe si duhet t'i trajtojnë ato, duke marrë informacion nga analiza e dhënë në këtë raport, si dhe nga mundësitë dhe praktikën e mira të përshkruara në të gjithë dokumentin dhe në Shënime të Vendeve që e mbështesin atë. Ama, shpresa e autorit është që ky raport të ofrojë informacion të shëndoshë dhe një bazë analitike për të informuar dialogun e nevojshëm, pavarësisht kufizimeve dhe mangësive në të dhënat e disponueshme dhe në rezultatet që janë nxjerrë si rrjedhojë e tyre. Autorët do të ofrojnë me kënaqësi të gjithë mbështetjen e nevojshme për këtë proces dhe shpresojnë që edicioni tjetër i këtij Shqyrtimi të Situatës së Sektorit të ketë mundësi të mbështetet në një bazë shumë më të shëndoshë të dhënash dhe progres dokumentacioni në trajtimin e sfidave më të mëdha të sektorit.



## II. KONTEKSTI I SHËRBIMEVE

6. **Shërbimet e ujit varen gjerësisht nga konteksti politik, social-ekonomik dhe natyror në të cilin ofrohen.** Pas rënies së sistemeve socialiste, shumica e vendeve në rajonin e Danubit kanë ndarë një rrugëtim të ngjashëm tranzicioni dhe zhvillimi politik dhe ekonomik gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, dhe me axhendën e integritimit në Bashkimin Evropian (BE) që është një synim i përgjithshëm në pothuajse të gjitha vendet e rajonit. Padyshim që ka ndryshime madhore midis vendeve, por këto ndryshime po veniten gradualisht dhe po ndodh një konvergjençë drejt standardeve të BE-së. Rajoni ka gjithashtu përgjithësisht burime të mira ujore, pavarësisht ndikimit të mundshëm të ndryshimeve klimaterike.

7. Ky kapitull shqyrton kontekstin politik, ekonomik, social në të cilin po kryhet ofrimi i shërbimeve të ujit në rajon; përshkruan pikëpamjen historike dhe zhvillimin, analizon situatën social-ekonomike në vende të ndryshme dhe përshkruan pasurinë dhe llojshmërinë e burimeve të ujit duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme klimaterike dhe ndikimet e tyre të mundshme.

8. Të dhënat dhe informacioni i përdorur në këtë kapitull vijnë kryesisht nga të dhënat e përpunuara/mbledhura nga Banka Botërore, përfshirë Treguesit e Zhvillimit Botëror, por gjithashtu përfshijnë publikime dhe baza të dhënash të disponueshme për publikun të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNPD), Komisionit Evropian (KE) dhe Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO). Informacioni është plotësuar me një përpjekje mbledhjesh të dhënash vend për vend (njohur në tekst si "mbledhja e të dhënave SoS") që mbështetet kryesisht në burimet publike në nivel vendi dhe të cilës i është referuar plotësisht në faqet e vendeve në fundin e këtij raporti.

### A. Pikëpamja Historike

9. **Ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe sanitare dhe zhvillimi i tyre në rajon kanë pasqyruar ndryshimet dramatike politike dhe ekonomike në rajon që prej vitit 1990, gjatë të cilave rajoni ka kaluar nga një ekonomi e planifikuar në qendër, e drejtuar nga shteti dhe socialiste, në një sistem perëndimor kapitalist dhe në anëtarësim në BE.** Pjesa më e madhe e zonës ujëmbajtëse të Danubit i përket gjeopolitikisht Evropës Juglindore dhe në përgjithësi zona ka patur të njëjtat fate gjatë 50 viteve të fundit. Vendet që janë pjesë e këtij raporti që nga Republika Çeke e deri tek Shqipëria (me një përjashtim të pjesshëm të vendeve të Ish Jugosllavisë), gjatë pjesës së dytë të shekullit të 20 kanë qenë pjesë të të ashtuquajturit bllok socialist të vendeve të Evropës dhe situata e tyre ekonomike dhe politike dhe zhvillimi i tyre, pavarësisht ndryshimeve rrënjësore midis tyre, kanë ndjekur përgjithësisht të njëjtat drejtime. Zhvillimi dhe problematikat e ofrimit të shërbimeve të ujit dhe atyre sanitare në këto vende, duke qenë se kanë qenë pjesë e shërbimeve të përgjithshme bashkiake, kanë ndjekur gjithashtu një proces përgjithësisht të ngjashëm transformimi që mund të shihet si një proces zhvillimi i të gjithë rajonit.

10. **Gjatë 25 viteve të fundit zhvillimi dhe ndryshimet në sektor u stimuluan nga dy procese madhore politike dhe ekonomike.** I pari ishte rënia e komunizmit dhe zhbërja e bllokut socialist të Evropës Lindore në vitin 1990, që solli ndryshimin e sistemit politik dhe ekonomik në këto vende. I dyti ishte zgjerimi i BE-së drejt Evropës Lindore, duke sjellë një harmonizim gradual të legjisllacionit me acquis e BE-së në vendet kandidatë dhe në shtetet e reja anëtare. Të dy këto procese kanë ndikuar gjithashtu seriozisht në ofrimin e shërbimeve të ujit dhe standardet mjedisore në rajon, duke sjellë ndryshime në standardet e shërbimit, financim dhe qeverisje. Ndërkohë që organizmi aktual i sektorit përshkruhet në detaje në Kapitullin III, më poshtë jepet një sintezë e shkurtër historike e fazave kryesore të dhënies së shërbimeve publike në rajon në të shkuarën e afërt.


- ▶ **Periodha e sistemit socialist (deri në vitin 1990).** Kjo periudhë pati si karakteristikë industrializimin e shpejtë, një mungesë të ndjeshmërisë ndaj mjedisit dhe një urbanizim të fuqishëm. Zhvillimi i shpejtë i nevojshëm i infrastrukturës së furnizimit me ujë nuk u ndoq nga ofrimi i përshtatshëm i shërbimit të ujërave të ndotura dhe nga trajtimi i ujërave të ndotura, duke shkaktuar dëme të mëdha në cilësinë e ujërave pritëse të ujërave të ndotura. Ofrimi i shërbimeve të pronës dhe administrimi i ofruesve të shërbimeve komunale në pjesën më të madhe të rasteve ishin në duart e qeverisë qendrore (me disa ndryshime në Ish Jugosllavi). Zhvillimi i përgjithshëm i sektorit të ujit dhe qasja e çmimeve u përqendrua në dhënien e shërbimeve të përbalueshme për të gjithë në kurriz të efikasitetit ekonomik, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimeve, dhe në mungesën e menaxhimit të kërkesave kombinuar me përdorim jo efikas të burimeve.

- ▶ Periudha post socialiste (1990 deri në integrimin në BE).**  
 Pas rënies së sistemit socialist, vendet e rajonit eksploruan kuadro të ndryshëm për dhënie të shërbimeve publike. Në shumicën e vendeve, u ndërmor një decentralizim i gjerë, ndonjëherë i shoqëruar me përfshirje më të rëndësishme të sektorit privat (në Republikën Çeke dhe Hungari, për shembull). Mos lëvrimi i fondeve shtetërore dhe nevoja për modernizimin e infrastrukturës, solli një vëmendje më të madhe mbi efikasitetin ekonomik dhe financimin e bazuar tek konsumatori. Institucionet ndërkombëtare financiare (IFI) luajtën një rol të rëndësishëm në këtë tranzicion.
- ▶ Integrimi në BE (nga fillimi i integrimit e deri më sot).**  
 Procesi i anëtarësimit në BE dhe harmonizimi i legjislacionit të BE-së në ligjet kombëtare ka sjellë futjen e parimit të rikuperimit të plotë të kostos, një shtysë drejt ndryshimeve strukturore në sektorin e ofrimit të shërbimeve dhe në periudhën afatgjatë, efikasitet dhe qëndrueshmëri të shtuar të ofrimit të shërbimeve. Politika rajonale e BE-së me synimet e saj për të ngushtuar pabarazitë zhvillimore të shteteve anëtare, nënkuptonte se financimet e BE-së u bënë një burim i rëndësishëm investimesh në sektor, sidomos përmes Fondeve të Kohëzimit që financuan projekte infrastrukturore mjedisore dhe transporti.

### Statusi i integrimit në BE në rajonin e Danubit

Nga 16 vende në rajon, 8 janë aktualisht Shtete Anëtare të BE-së (Austria, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Rumania, Sllovakia, dhe Sllovenia), dhe 4 (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, dhe Serbia) kanë statusin formal të shtetit kandidat dhe janë në nivele të ndryshme të procesit të anëtarësimit. Dy vende (Bosnje Hercegovina dhe Kosova) kanë shprehur dëshirën e tyre për t'u bërë eventualisht pjesë e BE-së dhe kanë marrë një status të një shteti të mundshëm kandidat; ato janë në fazat paraprake të harmonizimit të organizimit të tyre qeverisës me aktet e BE-së, por nuk kanë një status formal të shtetit kandidat. Dy vende (Moldavia dhe Ukraina) nuk e kanë akoma një objektiv formal anëtarësimit në BE, megjithatë të dy qeveritë kanë nënshkruar në vitin 2014 një marrëveshje asociimi me BE-në dhe kanë shprehur angazhimin e tyre për integrim në BE. Si rrjedhojë i gjithë rajoni është në faza të ndryshme të integrimit, duke e bërë këtë një proces të përgjithshëm rajonal që do të vijojë të kryesojë zhvillimin në rajon në të ardhmen e parashikueshme. (Figura 2)

FIGURA 2: STATUSI I ANËTARËSIMIT NË BE NË RAJON




BURIMI: KE 2015.



## B. Situata Social-Ekonomike

11. **Me ndryshimin e sistemeve politike, siç edhe u tha edhe në seksionin para rendës, vendet e Evropës Lindore kanë kaluar tranzicion të fuqishëm ekonomik dhe demografik.** Duke qenë se ishin të mbyllur ndaj lëvizjes së mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe ideve nën regjimin socialist, hapja e kufijve pas shpërbërjes së Ish Bashkimit Sovjetik u mundësoi njerëzve dhe parave të lëviznin në drejtim të zonave me mundësi ekonomike, duke sjellë kështu ndryshime në PBB për frymë dhe në popullatë në nivele nën kombëtare.

FIGURA 3: PBB PËR FRYMË, 1990-2013



BURIMI: (LLOGARITJE BAZUAR NË SHIFRAT E BANKËS BOTËRORE VITI 2015).

12. **Përçafimi i parimeve të ekonomisë së tregut dhe kufijve të hapur krijoi një rritje të ndjeshme të PBB për frymë në disa vende, duke treguar shenja se ekonomitë që janë më larg tregjeve po mbeten prapa.** Siç mund të shihet edhe në Figurën 3 më lart, ndryshimet në PBB për frymë (aktualisht të vitit 2013 në USD barazia e fuqisë blerëse [PPP]) janë akoma të konsiderueshme në vendet e zonës ujore të Danubit ku Moldavia (me USD 4,669) është më e varfra dhe ka një të dhjetën e PBB-së së vendit më të pasur, Austrisë me (USD 44,149).





FIGURA 4: RRRITJA E TË ARDHURAVE NË 40% E POSHTËM

BURIMI: BUSSOLO DHE LOPEZ-CALVA, PROSPERITETI I NDARË: DUKE HAPUR RRUGËN NË EVROPË DHE AZI QENDRORE 2014, 15.

**13. Rritja me PBB-së për frymë nuk ishte e njëtrajtshme brenda vendeve.** Për sa i përket të ardhurave 40% më i varfër i popullatës në Shqipëri, Kroaci, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi kanë patur rritje më të vogël të PBB-së për frymë krahasuar me mesataren e vendeve përkatëse dhe, me përjashtim të Malit të Zi, këto të ardhura kanë pësuar edhe zbritje me 1 ose 2 përqind në vit nga viti 2005 në vitin 2010, siç edhe tregohet në Figurën 4. Nga ana tjetër familjet në 40% më të varfër të Sllovakisë dhe Rumanisë kanë patur rritje vjetore të të ardhurave të tyre me më shumë se dy apo tre fishin e mesatares, Megjithëse përllogaritet se transfertat mbulojnë thuajse 90% të rritjeve në Rumani (Bussolo dhe Lopez-Calva, Prosperitetet i Ndarë: Duke hapur rrugën në Evropë dhe në Azi Qendrore 2014,37). Ndërkohë që disa vende kanë regjistruar rritje në të ardhurat e 40%-shit më të varfër, shumica e vendeve kanë akoma shumë punë për të ngushtuar hendekun e të ardhurave midis këtij grupi dhe 50%-shit më të pasur të popullatës. Pjesa e 40%-shit më të varfër në Bullgari, Hungari, Maqedoni, Moldavi dhe Rumani ishte më pak se 20% e të ardhurave, ndjekur nga afër nga Shqipëria, Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia me rreth 22% (Bussolo dhe Lopez-Calva, Prosperitetet i Ndarë: Duke hapur rrugën në Evropë dhe në Azi Qendrore 2014,19). Edhe në Austri 40%-shi më i varfër mban vetëm rreth 23% të të ardhurave të përgjithshme (llogaritje e autorit duke përdorur të dhënat e EUSILC të vitit 2012).

**14. Rreth 2.3 milion njerëz në rajonin ujqor të Danubit jetojnë me më pak se 2.50 USD në ditë (PPP), niveli rajonal për matjen e varfërisë ekstreme.** Mesatarisht, duke përfshirë Austrinë, kjo do të thotë se rreth 1.8% e të gjithë popullatës në zonë është në varfëri ekstreme. Siç tregon edhe Figura 5 më poshtë, prania më e madhe e varfërisë është në Rumani, që ka një popullsi prej 20 milion banorësh dhe është vendi i dytë për nga madhësia pas Ukrainës. Megjithatë, në lidhje me përqindjen e të varfërve, Maqedonia<sup>2</sup> është mbi vendet e tjera, ndjekur nga Moldavia, Kosova dhe Shqipëria.

**FIGURA 5: NUMRI DHE PËRQINDJA E TË VARFËRVE QË KONSUMOJNË MË PAK SE 2.50 USD / DITË, PPP**



*BURIMET: TREGUESIT JANË MBLEDHUR NGA BAZA E TË DHËNAVE MBI VARFËRINË DHE PABARAZINË E BANKËS BOTËRORE: EVROPA DHE AZIA QENDRORE 2015 DHE RAPORTUAR PËR VITE TË NDRYSHME. TË DHËNAT PËR KOSOVËN U PËRLLOGARITËN NGA ANKETIMI I BUXHETIT TË FAMILJEVE PËR VITIN 2010.*

**15. Komuniteti Rom me 10 deri në 12 milion anëtarë (KE 2015), është minoriteti më i madh dhe më i varfër në Evropë dhe në rajon.** Megjithëse numri i saktë i Romëve debatohet gjerësisht, grupet më të mëdha Rome jetojnë në Bullgari, Republikë Çeke, Hungari, Rumani dhe Sllovaki, Megjithëse ndër vendet e zonës ujëmbajtëse të Danubit ka Romë edhe në Shqipëri, Austri, Bosnje Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Krahasuar me popullatën jo Rome, Romët kanë treguesit më të ulët social dhe ekonomikë në thuajse të gjitha zonat<sup>3</sup>, përfshirë ato të shëndetit, arsimit, pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe kushtet e jetesës, integrimi dhe përmirësimi i kushteve për ta është vënë në fokusin urgjent të axhendës për varfërinë të Komisionit Evropian, Bankës Botërore, dhe partnerëve të tjerë për zhvillim. Për të dhënë një shembull nga një anketim familjesh<sup>4</sup> të kryer në vitin 2012 në këto vende,

<sup>2</sup> Përllogaritjet e varfërisë për Maqedoninë janë raportuar për vitin 2008, dhe përfaqësojnë Anketimin e fundit të Buxhetit Familjar për të cilin u vlerësuar varfëria (Baza e të Dhënave për Varfërinë dhe Pabarazinë e Bankës Botërore: Evropa dhe Azia Qendrore 2015).


<sup>3</sup> Për tregues të detajuar, shihni Banka Botërore 2014.

<sup>4</sup> Në vitin 2011, UNDR, Banka Botërore, dhe Komisioni Evropian kryen një anketim kampionimi të grupeve më të mëdha Rome në këto vende, me qëllim vlerësimin e situatës sociale dhe ekonomike të familjeve Rome dhe jo Rome (20,018 Romë dhe 9,782 jo Romë që jetonin afër njëri-tjetrit). Statistikat e raportuara kanë rëndësi vetëm për nivelin e vend banimeve, dhe jo në nivelin kombëtar.



pagesa mesatare është konsiderueshëm më e ulët për Romët në vende pune me pagesë krahasuar me fqinjët e tyre jo Romë, dhe fëmijët Romë janë më të rrezikuar nga varfëria se sa fëmijët jo Romë që jetojnë një derë më tej, siç mund të shihet dhe në Figurën 6.


**FIGURA 6: ROMËT FITOJNË MË PAK SE FQINJËT E TYRE DHE FËMIJËT E TYRE HASIN RREZIK MË TË MADH VARFËRIE**



BURIMI: PWRSHSTATUR NGA BANKA BOTWRORE 2014, 107.

**16. Në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë dhe Sllovakia, të varfrit janë të shpërndarë midis zonave rurale dhe urbane në përpjesëtim të drejtë me popullatën, por në vendet e tjera, të varfrit jetojnë më së shumti në zonat rurale.** Siç tregohet në Figurën 7, 86% e më të varfërve në Moldavi jetojnë në zona rurale, megjithëse vetëm 55% e popullsisë në tërësi jeton në zona rurale. Në Bullgari, Rumani dhe Ukrainë, me shifra më të larta se 70%, pjesa e të varfërve në zona rurale kalon ndjeshëm pjesën përkatëse të popullsisë rurale në përgjithësi. Në disa vende, si veçanërisht Serbia, Sllovakia dhe Ukraina, pjesa e të varfërve ruralë u rrit midis 2002 dhe 2008 (Sulla 2011). Rritja e pjesës së të varfërve në zona rurale përball shërbimet moderne të infrastrukturës me një sfidë, sepse investimet nuk kanë ekonominë e shkallës në mënyrë që to ofrohen me efikasitet kostojë, dhe popullata nuk ka gjasa të ketë mundësi të përballojë mirëmbajtjen e shërbimeve moderne të infrastrukturës. Shkalla mesatare e urbanizimit në vendet në zonën ujore të Danubit është 63%, që pak më e lartë se mesatarja e vendeve të Evropës Qendrore dhe atyre Baltike (62%), por konsiderueshëm më e ulët se shkalla e vendeve të BE-së me 74%<sup>5</sup>. Në përgjithësi urbanizimi ka mbetur në vend në vendet e Danubit që prej fillimit të viteve 90.

**FIGURA 7: VENDNDODHJA E TË VARFËRVE (QË JETOJNË ME MË PAK SE 2.50 USD/DITË, PPP)**




BURIME: SHKALLA E URBANIZIMIT ËSHTË MARRË NGA BANKA BOTËRORE 2015; SHKALLA E URBANIZIMIT TË KOSOVËS ËSHTË MARRË NGA CENSUSI I KOSOVËS I VITIT 2011; PËRQINDJA E TË VARFËRVE URBANË DHE RURALE QË KONSUMOJNË MË PAK SE 2-50 USD NË DITË PPP ËSHTË PËRLLOGARITUR NGA ANKETIMI I FAMILJEVE DHE JANË RAPORTUAR PËR VITIN 2010-2012, PËRVEÇ MAQEDONISË QË ËSHTË RAPORTUAR PËR VITIN 2008.

<sup>5</sup> Shkallët rajonale të urbanizimit janë marrë nga Banka Botërore 2015. Duke qenë se vendet përdorin përkufizimet të ndryshme për termin "urban", duhet bërë kujdes gjatë krahasimeve.

**17. Kombinimi i rritjes së ulët natyrore të popullsisë me emigrimin kanë sjellë një rënie të numrit të përgjithshëm të personave që jetojnë në zonën ujore të Danubit.** Nga viti 1961 deri në vitin 1989, vendet patën një rritje popullore të përbashkët vjetore prej 0.8%, që ra pas vitit 1990 e këtej me një ritëm prej 0.4% në vit. Shkalla më e ulët e lindjeve dhe popullata në plakje në Evropën Lindore dhe Perëndimore do ta bëjnë Evropën kontinentin e vetëm në botë ku popullata pritet të zvogëlohet gjatë 40 viteve të ardhshme (Bussolo, Koettl dhe Sinnott, akoma i pa botuar). Megjithatë, vendet në zonën ujore të Danubit po shohin që tani një rënie të popullatës të nxitur, përveç rënies natyrore, nga emigrimi që ndoqi hapjen e kufijve me Perëndimin (Figura 8). Megjithëse, më së shumti janë zonat rurale ato që po shpopullohen, disa nga zonat urbane kanë pësuar gjithashtu rënie të popullatës, e vërtetë kjo veçanërisht për zonat e thella dhe të izoluara nga tregjet botërore dhe korridoret e transportit. Kjo ka sjellë disa qytete me një infrastrukturë të madhe dhe pa ekonomitë e shkallës, dhe si rrjedhojë mirëmbajtja dhe përmirësimi kanë kosto të larta.

**FIGURA 8: PRIRJET E POPULLSISË NË ZONËN UJËMBAJTËSE TË DANUBIT**



BURIMI: PËRLLOGARITUR ME TË DHËNAT E BANKËS BOTËRORE 2015.  
 SHËNIM: NUK PËRFSHIHEN KOSOVA DHE SERBIA.






## C. Organizimi Administrativ

18. **Organizimi administrativ në të gjitha vendet e rajonit ka ngjashmëri, por ama ka edhe veçanti në vende të ndryshme që shpesh vijnë si rrjedhojë e zhvillimeve historike.** Të gjitha vendet e rajonit janë të centralizuara (me përjashtim të Austrisë, që është një vend federal, dhe Bosnje Hercegovinës, që ka një strukturë të veçantë me dy entitete), dhe pushteti kyç vendim marrës është shpesh i centralizuar në nivelin më të lartë. Shumica e vendeve në rajon kanë tre nivele qeverisjeje, kombëtar, rajonal, dhe vendor. Megjithatë, tre vende (Maqedonia, Mali i Zi dhe Sllovenia) kanë vetëm dy të tilla (kombëtar dhe vendor) dhe tre vende (Austria, Sllovakia dhe Ukraina) kanë një nivel tjetër të katërt qeverisjeje midis atij rajonal dhe vendor.

19. **Në shumicën e rasteve, qeveria qendrore ka autoritetin e përgjithshëm politikë bërës mbi shërbimet publike, por përgjegjësia e dhënies së shërbimeve është e deleguar në nivelet vendore të qeverisjes.** Shpërndarja më e zakonshme e përgjegjësisë në rajon është ajo ku niveli qendror i qeverisjes ka përgjegjësinë e përcaktimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor të sektorit dhe ka përgjegjësi për administrimin e buxhetit qendror dhe burimeve (zakonisht zbatuar përmes një sërë ministrish të caktuara linje), ndërsa nivelet më të ulëta administrative si rajonet dhe njësitë e qeverisjes vendore kanë zakonisht autoritetin e lidhur me zhvillimin vendor, përfshirë ofrimin e shërbimeve komunale vendore (me një përjashtim të pjesshëm në Bullgari, Hungari dhe Kosovë, ku sektori i ofrimit të shërbimeve komunale vendore është pjesërisht në pronësi të qeverisë qendrore).

20. **Ka ndryshime të mëdha midis vendeve për sa i përket fragmentimit të qeverisjes vendore.** Numri i njësisë vendore, si niveli më i ulët i qeverisjes në vende të veçanta, ndryshon konsiderueshëm midis vendeve dhe shkon nga 11,625 në Ukrainë në vetëm 23 në Malin e Zi. Vendet e Evropës Qendrore si Austria, Republika Çeke, Hungaria dhe Sllovakia që kanë traditë të gjatë të vetë qeverisjes vendore, kanë që të gjitha një numër të madh bashkish të vogla, ndërsa vende relativisht të reja ku kufijtë vendorë janë krijuar së fundmi (si Kosova, dhe Mali i Zi) kanë një numër më të vogël bashkish relativisht më të mëdha. Një krahasim i numrit të bashkive midis vendeve të ndryshme (Figura 9) tregon se ato jo vetëm që ndryshojnë shumë në lidhje me madhësinë territoriale (madhësia mesatare e bashkisë ndryshon nga 12 km<sup>2</sup> në Republikën Çeke në 611 km<sup>2</sup> në Malin e Zi), por edhe për sa i përket popullsisë (popullsia mesatare shkon nga 1,681 në Republikën Çeke deri në 48,000 në Kosovë).

FIGURA 9: NUMRI I BASHKIVE DHE POPULLSIA MESATARE PËR BASHKI PËR VEND




BURIMI: PËRLLËGARITJE E AUTORËVE BAZUAR NË MBELDHJEN E TË DHËNAVE SOS, BANKA BOTËRORE 2015.

## D. Burimet Ujore dhe Ndryshimet Klimaterike

21. **Baseni i Lumit Danub është relativisht i pasur në burime ujore, por kjo pasuri nuk është e ndarë në mënyrë të barabartë dhe ka ndryshime të konsiderueshme midis pjesëve të ndryshme të basenit.** Baseni i Lumit Danub është baseni i dytë për nga madhësia në Evropë dhe zë një sipërfaqe prej 801.463 km<sup>2</sup>, me gjithsej 81 milion njerëz në 19 vende. Gjashtëmbëdhjetë nga 19 vendet janë mbuluar në këtë raport (Gjermania, Italia dhe Zvicra janë përjashtuar, sepse ato zakonisht nuk lidhen me vendet e rajonit të Danubit). Për shkak të gjerësisë së madhe nga perëndimi në lindje, dhe panoramës së ndryshueshme, baseni i Lumit Danub ka ndryshime të mëdha në burime ujore dhe klimë. Danubi lidhet me 27 kontribuues të mëdhenj dhe mbi 300 të vegjël nga burimi i tij në Pyllin e Zi në Gjermani deri në Detin e Zi në Rumani dhe nga kjo pikëpamje është baseni më i madh ujqor në BE. Rajoni është i pasur në burime ujore të rinovueshme, por ka ndryshime rrënjësore në disponueshmërinë e këtyre burimeve në pjesë të ndryshme të rajonit, duke shkuar nga më shumë se 24.000 m<sup>3</sup> për frymë në vit në Kroaci deri në 1.250 m<sup>3</sup> për frymë për vit në Republikën Çeke (Figura 10).

FIGURA 10: BURIMET E RINOVUESHME ME UJË TË ËMBËL PËR FRYMË NË VENDET E BASENIT TË LUMIT DANUB



BURIMI: AQUASTAT I FAO 2015.  
SHËNIM: NUK KA TË DHËNA PËR KOSOVËN DHE MALIN E ZI

22. **Vetëm një vend në basen, Republika Çeke, mund të cilësohet si me mungesa ujore.** Masa më e përdorur për mungesat e ujit është treguesi Falkenmark ose Indeksi i Mangësisë Ujore (Falkenmark, Lundqvist dhe Widstrand 2009), që përdor 1.700 m<sup>3</sup> burime të rinovueshme ujore për frymë në vit si kufi (bazuar në vlerësimet e kërkesave për ujë në sektorët familjarë, bujqësorë, industrialë dhe energjetik.) Duke matur me këtë tregues, nga të gjitha vendet e basenit të Lumit Danub, vetëm Republika Çeke mund të kualifikohet si me mungesa ujore. Në të njëjtën kohë, asnjë vend në basenin e Lumit Danub nuk bie nën kufirin e "skarcitetit të ujit" prej 1.000 m<sup>3</sup>, duke theksuar kështu edhe njëherë disponueshmërinë e shëndoshë të burimeve të rinovueshme ujore në rajon krahasuar me pjesë të tjera të botës.


23. **Reshjet në rajon janë stinore vetëm deri në një masë dhe janë të varura nga kushtet dominuese klimaterike.** Shpërndarja rajonale e reshjeve tregon ndikimin e fuqishëm të klimave të ndryshme, me ndryshime nga kontinentale në mesdhetare në varësi të vendndodhjes në basen dhe me një ndryshim nga 300 milimetra (mm) deri në më shumë se 1.400 mm në vit. Kjo ka një ndikim shumë të rëndësishëm në ndryshimin e burimeve të rinovueshme të ujërave të ëmbla<sup>6</sup>, siç shihet në Figurën 11.

24. **Ndikimi i ndryshimeve klimaterike në rajon është i dukshëm përmes ndryshimeve në ciklin hidrologjik që sjell një ndodhi në rritje të kushteve ekstreme të motit, nga thatësitat e deri tek ujërat dhe reshjet e larta.** Duke qenë se rajoni i Danubit ka më së shumti një klimë mesatare me ndryshime relativisht të ekuilibruara reshjesh, pasojat negative të ndryshimeve klimaterike deri tani kanë qenë vetëm mesatare. Bazuar në gjetjet e studimit të Përshtatjes me Ndryshimet Klimaterike (LMU 2012) për Komisionin Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit Danub (ICPDR), ndikimet

6 Rrjedhat e burimeve të brendshme të ujërave të rinovueshme i referohen rrjedhave të lumenjve të brendshëm dhe ujërave nëntokësore nga reshjet në vend, dhe këto përkufizohen si burime të rinovueshme ujore të krijuara nga precipitime endogjene në territorin e vendit të caktuar, në të kundërt me burimet e rinovueshme të ujërave të ëmbla që përfshijnë rrjedhat e ujërave të ëmbla ndërkufitare në vend.




**FIGURA 11: RESHJEVE NË VEND / BURIMET E BRENDSHME UJËRAVE TË ËMBLA PËR VENDIN**



BURIMI: AQUASTAT / FAO 2015.  
SHËNIM: NUK KA TË DHËNA PËR KOSOVËN


kryesore në sektorët e lidhur me ujin nxiten nga ndryshimet e temperaturës dhe të reshjeve, përfshirë (a) një rritje të temperaturës së ajrit me një përshkallëzim nga veriperëndimi në juglindje, veçanërisht gjatë verës në rajonin juglindor të Danubit; (b) ndryshime të vogla të përgjithshme mesatare të reshjeve vjetore për të gjithë basenin, por ndryshime të mëdha sezonale në basenin e Lumit Danub; (c) ndryshime në modelet sezonale të rrjedhjes të shkaktuara nga ndryshimet në shpërndarjen e reshjeve dhe nga mbledhja e reduktuar e dëborës; (d) gjasat që thatësitrat, situatat e rrjedhave të pakta, dhe skarciteti i ujit të bëhen më të gjata, më intensive dhe më të shpeshta; dhe (e) një rritje të temperaturës së ujit dhe trysni të rritur të cilësisë së ujit (Figura 12 dhe Figura 13).

**FIGURA 12: NDRYSHIMET MESATARE TË TEMPERATURAVE VJETORE, 2021-2050**



BURIMI: LMU 2012.

**FIGURA 13: NDRYSHIMET MESATARE TË RESHJEVE VERORE, 2021-2050**




**25. Dëme të mundshme në sektorin e ofrimit të ujit për shkak të ndryshimeve klimaterike variojnë nga dëmet në infrastrukturë deri në humbje të ardhurash.** Për pasojë të varësisë së tyre nga reshje të rregullta dhe të pritshme dhe konsumit të varur nga temperatura, shërbimet e ujit janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimaterike, thatësirave, dhe depozitave të ulëta të ujërave nëntokësore, dhe mungesat e mundshme të ujit të pijshëm janë të ndjeshme ndaj reshjeve dhe përmbytjeve ekstreme. Si rrjedhojë e ndikimeve negative të ndryshimeve klimaterike të përmendura më lart, cenueshmëria më e madhe e shërbimeve të ujit dhe atyre sanitare pritet të përfshijë: (a) mungesa të ujit të pijshëm për shkak thatësirave dhe ulje të depozitave të ujërave nëntokësore, (b) probleme me cilësinë e ujit për shkak të thatësirave apo reshjeve ekstreme, dhe (c) dëme në infrastrukturën rezidenciale dhe industriale të shërbimeve për shkak të ndodhive ekstreme të motit. Vlerësimi i dëmeve pas përmbytjeve të majit 2014 në zonën ujëmbajtëse të Lumit Sava tregon forcën shkatërruese të përmbytjeve mbi infrastrukturën e ndërtuar nga njeriu, por edhe qëndrueshmërinë relative të infrastrukturës së shërbimeve të ujit dhe atyre sanitare, duke qenë se shumica e sistemeve u kthyen në funksion brenda pak javëve.

26. **Ndërkohë që shumica e vendeve të rajonit kanë ecur përpara me përgatitjet e strategjive dhe hartimin e veprimtarive për përgjigjen ndaj ndryshimeve klimaterike, zbatimi i masave konkrete të përshtatjes është akoma prapa në shumicën e vendeve.** Shumica e vendeve kanë hartuar dhe miratuar strategji kombëtare të ndryshimeve klimaterike dhe po analizojnë ndikimet e mundshme dhe janë duke marrë në konsideratë masat e mundshme lehtësuese. Nga 16 vendet e analizuara për këtë raport, 9 kanë miratuar strategjitë e ujit që trajtojnë ose përfshijnë ndikimet e ndryshimeve klimaterike, 6 po i përgatitin dokumente të tilla dhe vetëm 1 (Bosnje Hercegovina) nuk ka nisur akoma një vlerësim të ndikimit të ndryshimeve klimaterike (mbledhja e të dhënave SoS). Kjo tregon nivel relativisht të lartë ndërgjegjësimi për ndryshimet klimaterike në rajonin e Danubit. Megjithatë, thuajse të gjitha vendet e rajonit po përqendrojnë veprimtaritë e tyre në analiza dhe hartim dokumentesh strategjike, ndërsa kthimi i masave të ndryshme në standarde të ujit, apo futja e ndryshimeve klimaterike në projeksionet dhe planet e zhvillimit të ardhshëm nuk ka nisur akoma.


#### Përmbytjet e vitit 2014 në Bosnje Hercegovinë

Ndjeshmëria e sektorit të shërbimeve të ujit ndaj ndryshimeve klimaterike u pa qartë pas reshjeve ekstreme dhe përmbytjeve të mëdha në disa pjesë të rajonit gjatë majit dhe gushtit të vitit 2014, që shkaktuan humbje jete dhe dëme të gjera në basenin e Lumit Sava, përfshirë dëme në infrastrukturën ujësjellëse dhe të shërbimeve sanitare (rreth 1 milion njerëz mbetën pa akses në ujë të pijshëm për disa ditë). Megjithatë, një vlerësim dëmsh ndërmarrë pas ngjarjes tregoi gjithashtu se shërbimet bazë të ujit u vunë përsëri në funksion pas dy ose tre javëve dhe se dëmet në sektorin e ujit ishin vetëm 0.7% e dëmeve totale.

**FIGURA 14:** GJENDJA EKOLOGJIKE E UJIT TË LUMENJVË NË BASENIN E LUMIT DANUB (GJATËSIA NË LIDHJE ME GJATËSINË TOTALE)



**FIGURA 15:** GJENDJA KIMIKE E UJIT TË LUMENJVË NË BASENIN E LUMIT DANUB (GJATËSIA NË LIDHJE ME GJATËSINË TOTALE)




BURIMI: ICPDR 2009.  
SHËNIM: RKM = KILOMETRA LUMORË.

27. **Cilësia e ujërave sipërfaqësore ka mbetur në qendër të veprimtarive gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit dhe ndërkohë që ka përmirësime të dukshme, gjendja e mirë e përgjithshme e ujit nuk është arritur akoma në pjesë të rëndësishme të basenit.** Veprimtaria industriale dhe përqendrimet e mëdha të popullatave janë përgjegjëse për nivelin relativisht të lartë të përqendrimeve të mbetjeve dhe ushqyesve organikë (azot dhe fosfor) të shkarkuara në ujërat e basenit të Lumit Danub. Sasia e ndotësve organikë në ujërat sipërfaqësore është akoma e lartë në disa pjesë të Danubit dhe në shumicën e kontribuuesve të Lumit Danub (rezultatet për të gjithë zonën e basenit të Lumit Danub janë paraqitur në Figurën 14 dhe në Figurën 15). Kjo është pasojë e shkarkimeve akoma të konsiderueshme të ujërave të ndotura të pa trajtuara dhe të trajtuara jo mjaftueshëm nga burime vendore, industriale dhe bujqësore, veçanërisht në pjesën e poshtme të basenit, ku ndodhen vende të reja që nuk janë pjesë e BE-së. Analiza e përgatitur në kuadrin e ICPDR-së tregon se në dy dhjetëvjeçarët e fundit, ka patur përmirësime të konsiderueshme të cilësisë së ujit në basenin e Lumit Danub. Kjo mund të jetë rrjedhojë e nivelit të lartë të investimeve në trajtimin e ujërave të ndotura, të kryera në të shumtën e rasteve në kuadrin e axhendës së anëtarësimit në BE, si dhe si pasojë e një rënieje të konsiderueshme të veprimtarive industriale dhe bujqësore në periudhën post socialiste. Megjithatë, burimet kryesore të ndotjes me ushqyes në basenin e Lumit Danub mbeten bujqësia (50%) ndjekur nga ujërat e ndotura bashkiake (25%) dhe industria (25%) (ICPDR 2009).

28. **Ujërat nëntokësorë janë burimi kryesor i furnizimit me ujë në pjesën më të madhe të rajonit.** Ndërkohë që si ujërat sipërfaqësore edhe ato nëntokësore janë të përfaqësuara mirë si burime të furnizimit me ujë, ujërat nëntokësore janë



burimi kryesor i ujit të pijshëm (Figura 16). 72% e ujit të pijshëm në rajon prodhohet nga ujërat nëntokësore. Megjithatë, pjesa e ujërave nëntokësore që përdoret për qëllime të ujit të pijshëm është e ndryshme në vende të ndryshme dhe shkon nga 30 deri në 50 përqind në juglindje të rajonit, deri në thujtse 100% në pjesën veriperëndimore (Figura 16).




**FIGURA 16:** RAPORTI MIDIS UJËRAVE NËNTOKËSORE DHE SIPËRFAQËSORE BURIM UJIT TË PIJSHËM

BURIMET: ICPDR 2013; MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS PËR SHQIPËRINË, MAQEDONINË, KOSOVËN, DHE MALIN E ZI.

**29. Përdorimi industrial dhe shtëpiak i burimeve të ujit të ëmbël kryeson në rajon edhe pas rënies në prodhim industrial gjatë 20 viteve të fundit. Uji për përdorim njerëzor është i ndarë midis përdorimit shtëpiak, industrial dhe bujqësor.** Një krahasim i kategorive të ndryshme tregon qartë formën e ekonomisë në vende të veçanta (Figura 17), me përdorim më së shumti bujqësor në Shqipëri, më së shumti industrial në Austri dhe më së shumti shtëpiak në vendet që nuk kanë zhvilluar as përdorimin industrial e as atë bujqësor (Bosnje Hercegovina, Kroacia).

**FIGURA 17:** SHPËRNDARJA E UJIT TË ËMBËL SIPAS PËRDORIMIT



BURIMI: BANKA BOTËRORE 2015.

**30. Administrimi i ujit në basenin e Lumit Danub udhëhiqet nga parimet e Direktivës së Kuadrit të Ujit të BE-së (WDF) nën kujdesin e ICPDR-së.** ICPDR-ja u themelua në vitin 1998 bazuar në Konventën e Mbrojtjes së Lumit Danub, instrumenti parësor ligjor për bashkëpunim dhe administrim ndërkufitar uji në basenin e Lumit Danub, dhe platforma për zbatimin e të gjitha aspekteve ndërkufitare të WDF-së së BE-së. Me mbështetje nga ICPDR 19 vendet e zonës ujëmbajtëse të Danubit kanë hartuar një Plan Administrimi të Basenit të Lumit Danub në përputhje me WDF-në. Plani u miratua për herë të parë në vitin 2009 dhe po përditësohet bashkërisht nga të gjitha vendet në vitin 2015, në përputhje me afatin kohor prej gjashtë vjetësh të WDF-së. Qëllimi i planit është të krijojë një kuadër për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore tokësore dhe atyre nëntokësore dhe të sigurojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, si dhe synon që të gjithë ujërat të përbushin "gjendjen e mirë", që është qëllimi përfundimtar i WDF-së.

## III. ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE

31. **Organizimi i shërbimeve të ujit në rajonin e Danubit është i ngjashëm në strukturë dhe në shpërndarje me përgjegjësitë në rajone të tjera të Evropës, por ama ka disa veçanti që vijnë si rrjedhojë e sfondit historik dhe zhvillimit të rajonit.** Decentralizimi i ofrimit të shërbimeve dhe pronësia në nivel vendor janë aktualisht forma më e përhapur e organizimit, ndërsa përfshirja e sektorit privat mbetet gjerësisht e kufizuar. Të shtyrë nga procesi i anëtarësimit në BE, disa nga prirjet e kohëve të fundit përfshijnë bashkimin dhe kthimin në korporata të ofruesve të shërbimeve dhe krijimin e autoriteteve të pavarura rregullatore.

32. Ky kapitull shqyrton se si funksionet kryesore të nevojshme për shërbime uji të mirë strukturuara, ofrimi i shërbimeve, politikë bërja, rregullimi, administrimi i burimeve, dhe monitorimi i sektorit, janë të vendosura në qeverisjen qendrore dhe vendore në vendet e ndryshme. Kapitulli përshkruan madhësinë, pronësinë dhe administrimin e ofruesve të shërbimeve; merr në shqyrtim përgjegjësitë politike bërëse dhe rëndësinë e direktivës së ujit të BE-së për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve; dhe paraqet prirjet e kohëve të fundit në lidhje me monitorimin dhe rregullimin e sektorit.

33. Të dhënat dhe informacionet në këtë kapitull janë marrë kryesisht nga burimet publike në nivel vendi dhe në nivel BE-je dhe nga shqyrtimet vend për vend të kryera nga ekspertët vendorë mbi qeverisjen dhe politikat e sektorit, që njihen në tekst si “mbledhja e të dhënave SoS”. Shifrat janë dhënë të plota në Faqet e Vendeve në fund të raportit.

### A. Ofrimi i Shërbimeve


34. **Rreth tre të katërtat e popullatës së rajonit marrin shërbim publik nga një ndërmarrje komunale formale,<sup>7</sup> dhe një e katërta që përfaqësojnë familje dhe komunitete varen nga vetë-shërbimi ose nga ofrues informale.** Figura 18 tregon llojet kryesore të ofruesve të shërbimit të ujit në rajon dhe pjesën e popullsisë së rajonit të cilës ata i ofrojnë shërbime. Ndërmarrjet komunale më të mëdha rajonale (private apo publike) shërbejnë tashmë thuajse gjysmën e popullatës. Siç thuhet edhe në paragrafët në vijim, pritet që kjo pjesë të vijojë të rritet, duke marrë në konsideratë shtytjen aktuale për të rajonalizuar ofruesit më të vegjël të shërbimeve në nivelin e bashkisë apo fshatit, që aktualisht shërbejnë akoma rreth një të tretën e popullatës. Pavarësisht disa rasteve të bujshme të kohëve të fundit lidhur me rimarrjen në pronësi të bashkisë, siç ishte rasti i Budapestit, kompanitë komunale të menaxhuara privatisht vazhdojnë të shërbejnë rreth 10% të popullatës së rajonit, më së shumti në qytete të mëdha (Bukuresht, Sofje) dhe në vende të caktuara (Republika Çeke, Sllovakia).

35. **Në rajon ka më shumë se 10.000 ofrues formalë shërbimesh dhe ata kanë një llojshmëri të madhe për sa i përket madhësisë së popullatës që shërbejnë brenda vendeve, por vetëm 700 prej tyre shërbejnë më shumë se gjysmën e popullatës së lidhur në rrjet.** Austria ka numrin më të madh të ndërmarrjeve të vogla që shërbejnë mesatarisht rreth 1.400 klientë, ndjekur nga Republika Çeke ku ndërmarrjet e ujit shërbejnë mesatarisht pak më shumë se 4.000 klientë. Vogëlsia e ndërmarrjeve është e pritshme duke patur parasysh numrin e madh të ofruesve të shërbimeve (dhe bashkive; shih Kapitullin II, Seksioni C) në sektorët austriakë dhe çekë të ujit. Në të kundërt, Sllovakia ku vetëm 17 kompani uji ofrojnë shërbime për më shumë se 5 milion persona, kanë ndërmarrjet komunale më të mëdha. Prosesi i riorganizimit të sektorit të ujit në Hungari dhe në Kosovë gjatë viteve të fundit gjithashtu solli si rezultat disa kompani të mëdha që shërbejnë mesatarisht rreth 200.000 persona, ndërsa në Bullgari decentralizimi nuk u krye asnjëherë plotësisht dhe madhësia e kompanive mbetet relativisht më e madhe duke shërbyer rreth 130.000 persona. Madhësia mesatare e ndërmarrjeve komunale në vendet e tjera shkon nga 20.000 deri në 50.000 klientë të shërbyer.

7 Në këtë raport dhe në të gjithë rajonin e Danubit, termi “furnizim publik” përdoret për të treguar ofrimin e shërbimeve publike nga një ndërmarrje komunale formale që ofron shërbime, në të kundërt me informale, që janë kooperativa të administruara në nivel vendor ose vetë shërbimi. Përdorimi i termit publik nuk i referohet pronësisë së ofruesit të shërbimeve komunale dhe as menaxhimit të tyre, që mund të jenë publike ose private.




**FIGURA 18: OFRUESIT E SHËRBIMIT TË UJIT DHE POPULLATA E SHËRBYER NË ÇDO VEND**



BURIMI: PËRLOGGARTIJE E AUTORËVE NGA MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS.

**FIGURA 19: NUMRI DHE MASA MESATARE E KOMPANIVE KOMUNALE TË UJIT NË RAJONIN E DANUBIT**



BURIMI: PËRLOGGARTIJE E AUTORËVE NGA MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS.  
SHËNIM: MADHËSIA E RRETHIT PËRFAQËSON MADHËSINË MESATARE TË NËRMARRJES. VENDET E THEKSUARA ME JESHILE KANË PËRFUNDUAR NJË VEPRIMTARI TË GRUPIMIT TË NDRËMARRJEVE; VENDET E THEKSUARA ME PORTOKALLI JANË NË FAZË GRUMBULLIMI, DHE VENDET ME VJOLLÇË PO DISKUTOJNË NJË GRUMBULLIM TË TILLË.

36. **Nuk është çudi që ofruesit privatë shërbejnë mesatarisht bazën më të madhe konsumatore, ndjekur nga kompanitë rajonale, kompanitë vendore dhe ofruesit e vegjël formalë.** Siç tregon edhe Tabela 1, kompanitë e pakta komunale të menaxhuara privatisht në rajon priren të jenë më të mëdhatë dhe shërbejnë rreth 175.000 klientë. Më shumë se 600 kompanitë rajonale, që janë ato që shërbejnë më shumë se një njësi vendore, shërbejnë mesatarisht 70.000 klientë dhe kryesojnë në vende si Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia. Më shumë se 3.000 kompani vendore shërbejnë mesatarisht 12.000 klientë dhe këto kompani gjenden më së shumti në Austri, Bosnje Hercegovinë, Maqedoni, Moldavi dhe në Malin e Zi. Së fundmi ka rreth 7.000 ofrues të vegjël formalë që gjenden pothuajse vetëm në Austri, në Republikën Çeke dhe në Ukrainë. Këto shërbejnë mesatarisht rreth 800 klientë.

**TABELA 1: LLOJI, NUMRI DHE MADHËSIA MESATARE E KOMPANIVE KOMUNALE NË RAJONIN E DANUBIT**

Lloji i ofruesit publik të shërbimeve	Numri	Madhësia mesatare	Pjesa e tregut
Ofrues private	79	175,518	10%
Ofrues rajonale	625	71,366	33%
Ofrues vendore	3043	12,108	27%
Ofrues të vegjël formalë	6830	751	4%
Shuma/mesatare	10577	9,496	74%



BURIMIPËRLLLOGARITJE E AUTORËVE BAZUAR NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS.

#### Rajonalizimi i ndërmarrjeve komunale në Kosovë, 2002-2007

Arsyeja kryesore për rajonalizimin e ndërmarrjeve komunale në Kosovë ishte që kompanitë e vogla dhe të fragmentarizuara bashkiake të transformoheshin në organizata biznesi që arrinin të mbanin veten e tyre dhe që kishin një orientim të qartë për nga klienti, si dhe për të krijuar mjedis mbështetës për arritjen e synimeve sociale dhe ekonomike të popullatës kosovare. Reforma e sektorit të shërbimeve komunale u krye në kontekstin e axhendës së integrimit në BE të autoriteteve kosovare, që nënkuptonte harmonizimin e kuadrit përkatës së BE-së dhe futjen e parimeve dhe praktikave të kujdesshme të menaxhimit, si menaxhimi i baseneve lumore, menaxhimi i integruar i burimeve ujore, e të tjera si këto. Përpara reformës në sektor, kishte 35 kompani bashkiake që ofronin shërbime uji dhe mbledhje ujërash të ndotura së bashku me shërbime të tjera bashkiake. Procesi i reformës u krye në tre faza:



Konsolidimi i ofruesve të shërbimeve pati gjithashtu një efekt pozitiv në performancë. Treguesit kyç të performancës kanë qenë në përmirësim që prej atij momenti. Për shembull, raporti i faturimit dhe mbledhjes së pagesave dhe niveli matjeve janë rritur në mënyrë të qëndrueshme, duke lejuar matje më të mirë të konsumit të ujit, duke krijuar kështu më shumë të ardhura. Niveli i plotësimit me staf dhe raporti i veprimtarisë kanë mbetur stabilë dhe kanë patur përmirësime modeste. Ama, NRW ka patur luhatje gjatë të njëjtës periudhë, duke treguar përfitimë të kufizuara në lidhje me efikasitetin.






37. **Në përpjekje për të përfituar nga ekonomitë e shkallës, për të krijuar subvencione përmes tarifave, dhe për të lehtësuar thithjen e fondeve të BE-së, disa vende po promovojnë ose po bëjnë të detyrueshëm grumbullimin e ofruesve të vegjël në kompani komunale rajonale.** Vende si Kosova dhe Rumania kishin nisur reforma të tilla në mesin e viteve 2000, ndërsa vende të tjera, si Kroacia apo Hungaria i kanë nisur ato më vonë. Këto reforma vendosin, ndër të tjera, një kërkesë për madhësi minimale, duke krijuar kështu nevojën kompanive që nuk e plotësojnë kriterin të shkrihen me kompani të tjera ose të marrin nën vete bashki më të vogla, dhe duke kufizuar aksesin për fonde shtetërore apo të BE-së për ofruesit e shërbimeve komunale që përputhen me këtë. Në Kroaci dhe në Rumani procesi i rajonalizimit është në vazhdim, me pritshmërinë që përfundimi do të jetë një numër më i vogël ofruesish më të mëdhenj rajonalë. Një sërë vendesh të tjera në rajon, përfshirë Shqipërinë, Moldavinë dhe Ukrainën, e kanë identifikuar konsolidimin e shërbimeve të ujit si një përparësi të sektorit, por ama nuk kanë ndërmarrë akoma një axhendë rajonalizimi në nivel kombëtar (Figura 19). Një diskutim më i detajuar i rezultateve të proceseve të grumbullimit është dhënë në Seksionin C të Kapitullit V.

38. **Administrimi i shërbimeve të ujërave të ndotura shpesh ofrohet nga të njëjta kompani shërbimesh komunale, përveç disa vendeve ku ato administrohen nga kompani të veçanta në qytete të mëdha.** Arsyet historike i kanë çuar qytetet e mëdha në zonën Austro-Hungareze (Austri, Hungari) drejt kompanive të ndryshme për ujin dhe ujërat e ndotura. Faktikisht në Austri, nga rreth 6.000 kompani komunale, vetëm 150 ofrojnë shërbime të integruara. Kjo ndarje historike ka inkurajuar modele qeverisjeje disi më novatore në krahun e ujërave të ndotura: administrimi i ujërave të ndotura në Budapest menaxhohet nga një kompani private. Megjithëse shërbimi i ujësjellësit është rikthyer nën administrimin e bashkisë; impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Zagreb operohet sipas një skeme Ndërto-Opero-Transfero (BOT); në Austri, janë krijuar distrikte me qëllim të veçantë (Gemeindeverband) nga bashkitë përreth për të ndarë investimin dhe kostot e operimit të ambienteve të administrimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Por në shumicën tjetër të rajonit, shërbimet e ujërave të ndotura janë të menaxhuara nga kompanitë e ujësjellësit.

39. **Në disa vende, kompanitë komunale bashkiake ofrojnë më shumë se sa shërbime uji dhe ujërash të ndotura.** Për shembull, në Slloveni lloji i kompanisë komunale varet nga madhësia e saj. Kompanitë më të mëdha kanë prirjen të ofrojnë vetëm shërbime uji dhe ujërash të ndotura, ndërsa kompanitë e vogla mund të përfshijnë edhe shërbime gazi, ngrohjeje të distriktit, dhe administrimin e mbetjeve të ngurta, ndër shërbimet e tjera bashkiake. Maqedonia është i vetmi vend në rajon ku kompanitë komunale më të përhapura janë ato shumë sektoriale. Kompanitë komunale maqedonase u ofrojnë normalisht klientëve të tyre të gjitha shërbimet komunale. Kështu ishte edhe në Kroaci deri vonë, derisa një ligj i ri i drejtoi bashkitë të ndajnë shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura nga ndërmarrjet e tjera komunale.

**FIGURA 20: NIVELI I CENTRALIZIMIT TË PRONËSISË SË KOMPANIVE KOMUNALE DHE OFRIMIT TË SHËRBIMIT**



SHËNIM: REPUBLIKA ÇEKE NUK ËSHTË PËRFSHIRË SEPSE SHUMICA E KOMPANIVE JANË PRIVATE

40. **Shumica e ofruesve të shërbimeve në rajon janë të kontrolluar nga qeverisja vendore dhe i janë nënshtruar një procesi kthimi në korporatë.** Si rrjedhojë e një përpjekjeje të gjerë decentralizimi në vitet 90, në thuajse të gjitha vendet, qeverisjet vendore janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike dhe kanë në pronësi ofruesit e shërbimeve. Ka përjashtime të kufizuara në Bullgari, Hungari dhe Kosovë (Figura 20). Pas shqyrtimit të rreth 12 kompanive publike mirë performuese, stafi i Bankës Botërore identifikoi tipare të përbashkëta në këto kompani (shihni kutinë). Nga pikëpamja ligjore, të paktën, qeverisja e kompanive komunale në shumë vende të rajonit është në përputhje me tiparin e parë të autonomisë së jashtme; statusi ligjor, llogaritë dhe stafi i kompanive komunale publike janë ndarë nga juridiksioni kontrollues që mban pronësi të vetme apo mazhoritare të aksioneve të kompanisë. Në shumicën e kompanive, ministratë

### **Karakteristikat e kompanive komunale me performancë të mirë**

#### **Autonomia e Jashtme**

- ▶ Megjithëse ndërmarrjet komunale nuk kanë autoritet të plotë për vendosjen e tarifave të tyre, ato kanë mundësinë të bëjnë propozime që janë në përputhje me kërkesat e tyre të përgjithshme për të ardhura.
- ▶ Rregullat e prokurimit publik, Megjithëse janë konsideruar si ndërhyrëse, janë ndjekur pa ndikim me rëndësi në performancë.
- ▶ Megjithëse shumica e drejtuesve të kompanive komunale nuk kanë kontroll të plotë mbi përcaktimin e pagave për stafin, ata kanë mundësinë të punësojnë dhe të mbajnë staf të kualifikuar.
- ▶ Shumica e kompanive komunale publike mbështeten tek qeveria për burime investimesh.
- ▶ Anëtarët e këshillit drejtues zakonisht janë të emëruar nga qeveria për të përfaqësuar interesat e pronarëve.

#### **Llogaridhënia e Jashtme**

- ▶ Të gjitha kompanitë komunale i nënshtrohen synimeve të mirë përcaktuara të performancës.
- ▶ Kontratat e performancës janë instrumente të dobishme për ndarjen e informacionit por kanë kufizime në lidhje me zbatimin e performancës.
- ▶ Përfshirja e audituesve të jashtëm për të përmirësuar përgjegjësitë e të besuarve me financat është pothuajse e zbatuar nga të gjithë.
- ▶ Shumica e kompanive komunale publike kanë nevojë për autorizim për të siguruar financim të jashtëm.
- ▶ Grupet e jashtme mund të përfaqësohen në organet këshilluese apo ato që mbikëqyrin drejtuesit në kompanitë komunale.
- ▶ Marrëveshjet e pavarura rregullatore janë përjashtimi nga rregulli, sepse shumica e kompanive janë të rregulluara nga pronarët e tyre.

#### **Llogaridhënie e Brendshme për Rezultate**

- ▶ Drejtuesit e lartë i raportojnë sistematikisht këshillave drejtues mbi performancën.
- ▶ Sistemet e bazuar në shtysa për drejtuesit e lartë janë të zakonshëm.
- ▶ Anëtarët e stafit gjithashtu marrin vlerësime dhe penalizime për arritjen ose jo të synimeve të mirë përcaktuara të performancës.
- ▶ Shumica e kompanive komunale janë përqendruar në trajnime për përmirësimin e aftësive të stafit.

#### **Drejtimi për nga Tregu**

- ▶ Kompanitë komunale kontraktojnë shumicën e funksioneve jo bazë dhe mbajnë vetëm ato bazë.
- ▶ Megjithëse ushtrimet e arritjeve të etapave po bëhen të zakonshëm, nuk ka përcaktime të qarta për përdorimin e të dhënave të mbledhura për përmirësimin e performancës.
- ▶ Shumica e kompanive komunale nuk përfshihen në testime tregu.

#### **Drejtimi për nga Klienti**

- ▶ Kompanitë komunale publike të ujit kanë krijuar sistemet e tyre të faturimit dhe vjeljes që tejkalojnë në mënyrën më të mirë kufizimet e hasura nga grupe të ndryshme klientësh.
- ▶ Kompanitë komunale publike anketojnë në mënyrë aktive klientët e tyre për të mësuar opinionet dhe pikëpamjet e tyre.
- ▶ Klientët kanë mundësinë të shprehin parapëlqimet e tyre në lidhje me mundësitë për shërbim.
- ▶ Klientët informohen rreth ndryshimeve në shërbim dhe ndërprerjeve.
- ▶ Kompanitë ka krijuar mekanizma efikas ankesash.

#### **Kultura e Korporatës**

- ▶ Deklaratat e mirë hartuara të misionit ofrojnë një tregues të brendshëm për kulturën e mirë të korporatës.
- ▶ Performanca është bazë për rritjen e pagës në shumicën e kompanive komunale.
- ▶ Kompanitë ofrojnë mundësi të mira karriere për stafin e tyre dhe si kanë lëvizshmëri të ulët personeli.
- ▶ Kompanitë e ujit kanë programe trajnime për stafin e tyre si pjesë e marrëveshjeve vjetore të performancës.
- ▶ Anëtarët e stafit informohen rreth vendimeve të drejtuesve kur ata duhet të marrin vesh për to.

BURIMI: BAIETTI, KINGDOM DHE VAN GINNEKEN 2006.



apo bashkitë aksionare emërojnë këshillin drejtues, with the exception of FYR Macedonia, where nongovernmental representatives can also be members of the board. Utility management is appointed either by the board of directors or directly by the government. In some cases, the relationship between the utility and the government is formalized in a performance agreement (Tabela 2). In practice though, the spirit of an arm's-length relationship between corporatized utility companies and their controlling jurisdiction is not always respected, and local governments and mayors often maintain tight control over managerial and staffing decisions in their utilities. The characteristics of external accountability, market orientation, customer orientation, and corporate culture, are far less often observed.

**TABELA 2: QEVERISJA E KOMPANIVE KOMUNALE NË VENDET E RAJONIT**

Vendi	Lloji i kompanisë	Juridiksioni kontrollues	Lloji kryesor i ofruesit	Pronari i asetëve	Këshill / organ drejtues për kompanitë komunale	Emërimi i drejtuesve	Marrëveshje performance
Shqipëria	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Shoqëri anonime	Vetë kompania komunale	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Këshilli i Kompanisë Komunale	Jo
Austria	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Ndërmarrje në pronësi të bashkisë	Vetë kompania komunale	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Këshilli i Kompanisë Komunale	Ndonjëherë
Bosnja dhe Hercegovina	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Kompani komunale publike	Vetë kompania komunale	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Ndonjëherë
Bullgaria	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje kombëtare dhe vendore	Ndërmarrje shtetërore	Vetë kompania komunale <sup>8</sup>	Jo, kontrolluar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Po
Kroacia	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Kompani komunale publike	Vetë kompania komunale	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Po, me ligj
Republika Çeke	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Kompani private	Juridiksioni kontrollues	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Këshilli i Kompanisë Komunale	Po, me ligj
Hungaria	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje kombëtare dhe vendore	Ndërmarrje në pronësi të bashkisë	Juridiksioni kontrollues	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Po, me ligj
Kosova	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Kombëtare	Kompani rajonale uji	Juridiksioni kontrollues	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Këshilli i Kompanisë Komunale	Po, me ligj
Maqedonia	Shërbime Bashkiake	Qeverisje Vendore	Ndërmarrje publike bashkiake	E Paqartë	Po, këshill me pjesëmarrjen e juridiksionit jo kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Ndonjëherë
Moldavia	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Ndërmarrje publike bashkiake	Juridiksioni kontrollues	Jo, kontrolluar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Ndonjëherë
Mali i Zi	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Ndërmarrje publike bashkiake	Juridiksioni kontrollues	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Këshilli i Kompanisë Komunale	Jo
Rumania	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Operator rajonal	Juridiksioni kontrollues	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Po
Serbia	Në Varësi të Madhësisë	Qeverisje Vendore	Ndërmarrje shtetërore	Qeveria Kombëtare	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Këshilli i Kompanisë Komunale	Jo
Slovakia	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Shoqëri anonime	Juridiksioni kontrollues	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Këshilli i Kompanisë Komunale	Po
Slovenia	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Ndërmarrje publike bashkiake	Juridiksioni kontrollues	Po, këshill emëruar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Ndonjëherë
Ukraina	Ujësullës dhe Kanalizime	Qeverisje Vendore	Ndërmarrje komunitare	Juridiksioni kontrollues	Jo, kontrolluar nga juridiksioni kontrollues	Juridiksioni Kontrollues	Jo

BURIMI: Mbledhja e të dhënave SOS

<sup>8</sup> Kjo do të ndryshojë. Në vitin 2009 ndryshimet në Ligjin për Ujin kërkojnë së e gjitha asetet e infrastrukturës EËS të bëhen prona publik shtetërore ose publike bashkiake (në varësi të tipareve të tyre territoriale dhe funksionale).

**41. Shumica e vendeve në rajon nuk patën angazhim të rëndësishëm privat në ofrimin e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura.** Në fund të viteve 90 dhe në fillimin e viteve 2000, disa vende eksperimentuan me Partneritetin Publik Privat (PPP) për qytetet e tyre të mëdha, duke ofruar kështu kontrata koncesioni për qytete si Bukureshti, Budapesti dhe Sofja, si edhe për një pjesë të madhe të popullatës në Republikën Çeke dhe në Sllovakia. Një kontratë menaxhimi u provua edhe në Gjakovë-Rahovec në Kosovë. Ukraina ka hartuar një sërë skemash të Partneritetit Publik Privat për t'u veçuar, si marrëveshja e dhënies në përdorim afatgjatë midis qytetit të Odesës dhe kompanisë private Infoxvodokanal, si dhe një koncesion të madh midis Luhansk Oblast dhe operatorit të madh privat rus Rosvodokanal. Aktualisht ama, pak vende vijojnë të kërkojnë në mënyrë aktive modelin tradicional të koncesionit, siç mund të jetë edhe rasti i Budapestit ku shërbimet janë rikthyer nën administrimin e bashkisë. Megjithatë, po dalin në pah një sërë modelesh PPP për menaxhimin e ambienteve të veçanta (BOT-të në Zagreb, Serbi dhe Kosovë) si dhe për dhënien e shërbimeve të kontraktuara, ndonjëherë bazuar në performancë .

**TABELA 3: PANORAMË E SHOQATAVE TË UJIT NË RAJON DHE SHËRBIMEVE QË OFROJNË**

Vendi	Emri <sup>9</sup>	Fushëveprimi	Viti i krijimit	Personel me kohë të plotë	Shërbimet e ofruara					
					Trajnime	Asistencë teknike	Shkëmbim njohurish	Lobim dhe advokim	Marrëdhënie me publikun	Hartim standardesh
Shqipëria	SHUKALB	Ujësllës dhe kanalizime	2000	5	✓		✓	✓	✓	
Austria	ÖVGW	Ujësllës	1881	15	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	ÖWAV	Kanalizime	1909	8	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Bosnje Hercegovina	VRS	Republika Srpska	2001	3	✓	✓	✓	✓	✓	
	UPKP	FBiH / shërbime komunale	1999	1	✓	✓	✓	✓	✓	
Bullgaria	BWA	Ujësllës dhe kanalizime	2001	5			✓	✓	✓	
Kroacia	GVIK	Ujësllës dhe kanalizime	1972	–	✓	✓	✓	✓		
Republika Çeke	SOVAK	Ujësllës dhe kanalizime	1989	5	✓	✓	✓	✓	✓	
Hungaria	MAVIZ	Ujësllës dhe kanalizime	1990	10	✓		✓	✓	✓	
Kosova	SHUKOS	Ujësllës dhe kanalizime	2001	3	✓		✓	✓		
Maqedonia	ADKOM	Shërbime bashkiake	2004	2	✓		✓	✓	✓	
Moldavia	AMAC	Ujësllës dhe kanalizime	2000	10	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Mali i Zi	UVCG	Ujësllës dhe kanalizime	1999	1	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Rumania	ARA	Ujësllës dhe kanalizime	1995	25	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Serbia	WSAS	Ujësllës dhe kanalizime	2011	–	✓	✓	✓		✓	✓
	UTVSI	Profesionistë Uji	1960	5	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Sllovakia	AVS	Ujësllës dhe kanalizime	2004	2	✓	✓	✓	✓	✓	
Sllovenia	CCIS	Dhomë Tregtie	1851	2			✓	✓	✓	
Ukraina	UWA	Ujësllës dhe kanalizime	1995	9	✓	✓	✓	✓	✓	✓

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS.

<sup>9</sup> SHUKALB: Shoqëria e Ujësllës Kanalizimeve e Shqipërisë, ÖVGW: Shoqata Austriake e Gazit dhe Ujit; ÖWAV: Shoqata Austriake e Ujit dhe Administrimit të Ujërave të Ndotura; VRS: Shoqata e Ujit e Republika Srpska; UPKP: Shoqata e Punëdhënësve të Kompanive Komunale; BWA: Shoqata Bullgare e Ujit; GVIK: Shoqata e Ujësllës Kanalizimeve; SOVAK: Shoqata e Ujësllës Kanalizimeve të Republikës Çeke; MAVIZ: Shoqata e Hungareze e Shërbimit Komunal të Ujit; SHUKOS: Shoqata e Ujësllës Kanalizimeve të Kosovës; ADKOM: Shoqata e Ofruesve të Shërbimeve Komunale e Maqedonisë; AMAC: Shoqata Kombëtare Moldave e Shërbimeve Komunale të Ujit dhe Sanitare; UVCG: Shoqata e Ujit të Malit të Zi; ARA: Shoqata e Ujit e Rumanisë; WSAS: Shoqata e Ujit dhe Kanalizimeve e Serbisë; UTVSI: Shoqata për Teknologji Ujore dhe Inxhinieri Sanitare; AVS: Shoqata e Kompanive të Ujit; CCIS: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Sllovenisë; UWA: Shoqata Ukrainase e Shërbimeve Komunale të Ujit.



42. **Çdo vend në rajon ka një shoqatë kompanish komunale dhe ndonjëherë edhe më shumë se një.** Ka shoqata të fuqishme të ujit në shumicën e vendeve të BE-së, të drejtuara për shembull nga OVGW në Austri, MAVIZ në Hungari, dhe ARA në Rumani. Në shumicën e vendeve të ish Jugosllavisë, krijimi i këtyre shoqatave është më i vonët dhe kapacitetet e tyre njerëzore dhe financiare janë më të kufizuara. Veprimtaritë e shkëmbimit të njohurive si konferenca, tryeza pune, dhe buletine informativë, janë shërbimet më të njohura të ofruara nga shoqatat për anëtarët e tyre, të ndjekur nga puna e shoqatave në drejtim të lobimit dhe advokimit. Shtatë shoqata në rajon hartojnë dhe përcaktojnë standarde teknike dhe udhëzime si pjesë të shërbimeve që ofrojnë. (Tabela 3).

43. **Në zonat rurale, shërbimet e ujit zakonisht janë të organizuara përmes kompanive komunale në afërsi të zonës, organizatave të bazuara në komunitet, apo vetë-shërbimit.** Në përgjithësi, vetë-shërbimi dhe sistemet e operuara në komunitet përbëjnë rreth 26% të popullatës. Nuk dihet shumë rreth ofruesve informalë të shërbimeve, që zakonisht janë përtej mbulimit të politikave dhe rregullimit dhe si të tillë krijojnë sfida të veçanta për sektorin si rrjedhojë e përmasave të vogla, kapacitetit të kufizuar teknik dhe financiar, dhe numri të madh të tyre. Shumë vende në rajon shohin grumbullimin apo integrimin e këtyre ofruesve të vegjël në kompani rajonale si mundësinë më të arritshme për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve. Megjithatë, zgjidhje të tilla mund të nënkuptojnë kosto të konsiderueshme shtesë për kompanitë komunale publike, dhe vende që tradicionalisht janë përballur me situata të tilla, si Austria, kanë hartuar mekanizma alternativë për t'i ofruar mbështetje këtyre ofrues shërbimesh, siç tregon edhe përvoja e Upper Austria Water (shihni Kutinë).

#### Upper Austria Water, një shoqatë kooperativash rurale

Themeluar në vitin 1946, Upper Austria Water është një shoqatë autonome, e vetë mbështetur, jo fitimprurëse prej më shumë se 1.700 kooperativash të vendosura në Shtetin Federal të Austrisë së Sipërme. Drejtuar nga një Këshill prej shtatë drejtorësh, ajo menaxhon veprimtarinë e lidhur me ujin, sidomos në zonat rurale dhe ka në ngarkim instalimet e decentralizuara në shkallë të vogël të ujësjellësve dhe kanalizimeve dhe instalimet e mbrojtjes nga përmblytjet dhe ato të vaditjes.

Kooperativat ujore synojnë të sigurojnë ujë të pijshëm të mjaftueshëm, me cilësi të lartë dhe me efikasitet në kosto përmes ndërtimit dhe operimit të instalimeve autonome. Përfshirja personale dhe shërbimi honorar i anëtarëve e bëjnë këtë furnizim kolektiv uji me cilësi të kontrolluar një metodë ekonomike furnizimi. Shoqata u ofron anëtarëve mbështetje për çështje teknike, ligjore, financiare dhe organizative. Ajo ofron shërbime operative dhe mirëmbajtjeje (asistencë teknike, furnizim në rast urgjence, pajisje teknike të lëvizshme), programe të përbashkëta (për blerjen e matësve dhe analizat e ujit, për shembull), dhe shërbime matjeje (si identifikim rrjedhjesh, vendndodhje tubacioni dhe valvulash, sasi rrjedhjeje dhe presion, dhe testime shtresash ujëmbajtëse). Ajo gjithashtu propozon seanca edukimi dhe trajnimi dhe kryen veprimtari rrjetëzimi dhe ofron mundësi shkëmbimi informacioni për anëtarët e saj. Për më shumë informacion, shihni <http://www.ooewasser.at/de/english.html>.

Shteti Federal i Austrisë së Sipërme më shumë se 1.700 kooperativa ujore



## B. Politikë Bërja

44. **Përgjegjësitë e politikë bërjes në sektorin e shërbimeve të ujit mbeten përgjegjësi e autoriteteve të qeverisë qendrore, por zakonisht ato ndahen midis ministrive të ndryshme, duke krijuar ndonjëherë sfida koordinimi.** Përcaktimi i strategjive dhe politikave të shërbimeve të ujit në rajon mbetet përgjegjësi e qeverisë qendrore dhe ministrive të ndryshme përkatëse në thuajse të gjitha vendet e rajonit (i vetmi përjashtim është Bosnje Hercegovina – Federata e Entitetit të Bosnje Hercegovinës, ku politikat e shërbimeve të ujit janë përgjegjësi e autoriteteve rajonale). Tradita e një qeverie të fuqishme qendrore është akoma e pranishme në disa vende (Ukraina), ndërsa të tjera po kalojnë një periudhë decentralizimi të zgjeruar (Bosnje Hercegovina). Përgjegjësia politikë bërëse për ofrimin e shërbimeve të ujit, zakonisht ndahet midis ministrive të ndryshme të qeverisë dhe ndjek në përgjithësi një model të ngjashëm ku (a) administrimi i burimeve ujore është më së shumti përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë (por në disa vende edhe i Ministrisë së Mjedisit), (b) çështjet e ndërmarrjeve të ujit dhe zhvillimi i infrastrukturës janë përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë ose Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (apo ministrive të tjera që merren me vetë qeverisjeve vendore), (c) standardet e trajtimit të ujërave të ndotura më së shumti janë përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit, dhe (d) standardet e ujit të pijshëm janë më së shumti përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë. Shumimi i ministrive të lidhura me shërbimet e ujit krijon ndonjëherë ngatërresa dhe çon në një pronësi të munguar të axhendës së reformimit të shërbimeve komunale. Për të lehtësuar këtë sfidë, disa vende i janë kthyer krijimit të organeve bashkërenduese (Këshilli Ndër-Ministror për Ujin në Kosovë dhe Këshilli Kombëtar i Ujit në Shqipëri, për shembull). Në raste të tjera, shoqatat e ujit (Rumani) ose autoriteti rregullator (Hungari) kanë ndërmarrë role aktive bashkërendimi dhe advokimi në lidhje me politikat. Në vetëm disa vende, (si Austria, Kroacia dhe Sllovenia) të gjitha aspektet e ofrimit të shërbimit të ujit janë të përqendruara në një ministri të vetme (zakonisht Ministria e Bujqësisë), por edhe në këto raste, Ministria e Mjedisit dhe ajo e Shëndetësisë kanë përgjegjësi të konsiderueshme në lidhje me monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

### Direktiva e Kuadrit të Ujit

Direktiva e Kuadrit të Ujit (WFD, Direktiva 2000/60/EC) ka bërë pjesë të legjislacionit të BE-së një objektiv të ri për mbrojtjen e ekosistemeve ujore në mënyrë më gjithëpërfshirëse, ndërkohë që merret në konsideratë përdorimi i ujit për jetën dhe për zhvillimin njerëzor. WDF-ja ka paraqitur një sërë parimesh kyçe në menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore, përfshirë një proces planifikimi të integruar në nivelin e baseneve lumore, vlerësim gjithëpërfshirës të ndikimeve, analizë ekonomike të masave të propozuara ose të mara dhe objektiva përkatës politikash. Instrumenti kyç për zbatimin e WDF-së janë Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore dhe Programet e Masave shoqëruar për të përmirësuar gjendjen e ujit. Direktiva synon të arrijë një gjendje të mirë të ujit në të gjithë ujërat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë. Për sa i përket ujërave sipërfaqësore, përkufizimi i "i mirë" bazohet në një koncept të ri të "cilësisë ekologjike", që merr parasysh biologjinë, kiminë dhe tiparet e tyre fizike. WDF-ja parashikon një sërë afatesh kohore brenda të cilëve Shtetet Anëtare duhet të përmbushin detyrime të caktuara. Për më tepër, WDF-ja paraqet edhe kërkesën për rikuperim kostoje në lidhje me shërbimet e ujit, si edhe informim dhe këshillim me publikun në lidhje me administrimin e ujërave.

45. **Megjithëse direktivat e ujit të BE-së nuk mandatojnë kuadro të veçantë qeverisjeje apo rregullatorë për shërbimet e ujit, ato nënkuptojnë ndryshime sektoriale në rajon, jo vetëm në shtetet anëtare, por edhe në vendet aspirante për anëtarësim.** Direktivat e BE-së për ujin (kryesisht WDF-ja, Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane [UWWTD], dhe Direktiva e Ujit të Pijshëm [DWD] – shih kutitë), prekin më së shumti mbrojtjen e burimeve ujore, mjedisin dhe shëndetin njerëzor, si dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Në të kundërt me direktivat në sektorë të tjerë, ato nuk mandatojnë shprehimisht kuadro të veçantë qeverisjeje apo rregullatorë për ofrimin e shërbimeve të ujit, dhe faktikisht ndër shtetet anëtare të BE-së në rajonin e Danubit e më gjerë, mund të shihet një shumëllojshmëri strukturash organizative. Ndikimi i tyre i drejtpërdrejtë kryesor në shërbimet e ujit vjen përmes përcaktimit të kërkesave për cilësinë e ujit të pijshëm, mbledhjen e ujërave të ndotura dhe kërkesat e trajtimit (pjesë e acquis të BE-së), si dhe kërkesat e përgjithshme për rikuperimin e kostove në përputhje me parimin 'ndotësi pagan'. Megjithatë, disa palë interesi në rajon kanë nxjerrë rekomandime të mëtejshme të nënkuptuara ose të perceptuara politikash, si nevoja për të konsoliduar shërbimet e ujit për të lehtësuar thithjen e fondeve të BE-së dhe zhvillimin e paketave të investimit efikase në kosto; apo kërkesën për një kuadër më të fortë rregullator për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e rikuperimit të kostos. Sidoqoftë, të gjitha vendet anëtare të BE-së kanë përfunduar harmonizimin formal të direktivave përkatëse të ujit të BE-së dhe vendet kandidatë apo mundësisht kandidatë janë në procesin e harmonizimit të politikave të tyre të ujit me kërkesat e acquis të BE-së dhe direktivat përkatëse të BE-së.

46. **Afatet e përputhshmërisë me direktivat e BE-së për secilin shtet të ri të BE-së përcaktohen në Traktatet e Anëtarësimi dhe vendosen në bazë të përmasave të grumbullimit, përqindjes së grumbullimit të përgjithshëm apo individual dhe**



**ndjeshmërinë e ujërave pritëse.** Ndërkohë që disa shtete të BE-së në rajon kanë arritur përputhshmëri të plotë me direktivat afatet e tranzicionit për disa kategori nuk kanë skaduar akoma për Kroacinë, Hungarinë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë (shihni Kapitullin IV, Seksioni C për një panoramë të shkallës aktuale të përputhshmërisë). Vihet re se disa nga vendet e mundshme kandidatë kanë nisur përfshirjen e direktivave të BE-së në sistemet e tyre kombëtare, përpara se të marrin formalisht statusin e vendit kandidat, duke treguar angazhim të hershëm ndaj qëllimeve të direktivave të BE-së.

**47. Pjesa më e madhe e vendeve në rajon kanë përgatitur strategjitë e ujit që përcaktojnë qëllimet strategjike të sektorit.** Përgatitja e strategjive të shëndosha për sektorin e ujit shihet si gur themeli për zhvillimin e sektorit në shumicën e vendeve të rajonit, dhe dokumente të tillë janë përgatitur dhe miratuar rishtazi në 12 vende të rajonit (Shqipëri, Austri, Bosnje Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republikë Çeke, Maqedoni, Malin e Zi, Rumani, Sllovakia, Slloveni dhe Serbi), ndërsa dy vende të tjera (Kosova dhe Moldavia) kanë përgatitur projekt strategji. Vetëm dy vende (Hungaria dhe Ukraina) nuk kanë një strategji të veçantë për sektorin e ujit, por i mbulojnë çështjet e lidhura me ujin përmes një sërë strategjish sektoriale apo programesh qeveritare. Strategjitë e miratuara kombëtare të ujit zakonisht ofrojnë qëllime strategjike, dhe përcaktojnë burimet dhe veprimet e nevojshme për të arritur synimet sektoriale. Sektori i ujësjellësit dhe shërbimeve sanitare është kryesisht i përqendruar në (a) furnizim më të madh me ujë dhe mbulim më të gjerë me shërbime sanitare, (b) mbrojtje të përmirësuar të ujërave nga ndotja në burim dhe (c) arritjen e rikuperimit të kostos dhe qëndrueshmërisë së veprimtarisë brenda 10 deri në 25 vite. Në vendet e BE-së dhe në vendet kandidatë, të gjitha strategjitë e hartuara rishtazi kanë një dimension të fuqishëm përputhshmërie me BE-në dhe qëllimet që janë në linjë me harmonizimin e direktivave të ujit të BE-së (duke synuar përputhshmëri të plotë deri në fund të periudhës së tranzicionit të rënë dakord individualisht). I vetmi përjashtim është Austria, që është në përputhje me direktivat e BE-së. Kështu që përqendrimi i saj ka kaluar tek mirëmbajtja dhe përshtatja me ndryshimet klimaterike si niveli tjetër i sfidave në sektorin e ujit.

#### Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane

Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane (UWWTD, Direktiva 91/271/EEC) është një direktivë e drejtuar për nga kontrolli i shkarkimeve dhe një nga instrumentet madhore të politikave ujore në Evropë. Qëllimi i saj është të mbrojë mjedisin ujor nga efektet negative të shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane nga zonat e vendbanimeve dhe të ujërave të ndotura industriale nga sektori i agro-ushqimit. Direktiva zbatohet për grumbullime me më shumë se të barasvlerëshmen e 2.000 banorëve (p.e.), dhe kërkon mbledhjen e duhur të kanalizimeve dhe rregullon shkarkimin e ujërave të ndotura duke specifikuar llojin minimal të trajtimit që duhet kryer dhe duke vendosur kufijtë tavan të vlerave të shkarkimit për ndotësit madhorë (ngarkesa organike dhe ushqyes). Direktiva kërkon largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në grumbullime me p.e. më shumë se 2.000 dhe trajtim më të avancuar në grumbullime me p.e. më të madhe se 10.000 në zona të ndjeshme. Konsiderohet gjerësisht si legjislacioni më i shtrenjtë i acquis.

#### Direktiva e Ujit të Pijshëm

Direktiva e Ujit të Pijshëm (DWD, Direktiva 98/83/EC) lidhet me cilësinë e ujit të caktuar për konsum njerëzor dhe përcakton standardet thelbësore të cilësisë së ujit të pijshëm në nivelin e BE-së. Qëllimi i saj është të mbrojë shëndetin njerëzor nga efektet negative të kontaminimit të ujit për konsum njerëzor duke siguruar që uji të jetë i plotë dhe i pastër. Direktiva i aplikohet kryesisht sistemeve që ofrojnë ujë të pijshëm për më shumë se 50 persona ose 10m<sup>3</sup>/ditë.

**48. Edhe në vendet me minoritet të konsiderueshëm Rom, pak e perceptojnë këtë si një çështje të ofrimit të shërbimit të ujit dhe pak kanë skema të veçanta për ofrimin e shërbimit për grupe të tilla.** Ndërkohë që një numër vendesh në rajon, përfshirë Bullgarinë, Rumaninë dhe Sllovakinë, kanë përqendrim të mëdha me popullatë Rome (shihni Kapitullin II, Seksioni B), vetëm në Maqedoni dhe Bosnje Hercegovinë disa nga kompanitë komunale kanë një qasje të veçantë për grupet e marginalizuara (përbërë më së shumti nga ofrimi pa pagesë i sasië bazë uji ose ulje në tarifën e ujit). Të gjitha vendet e tjera kanë deklaruar se ato kanë të njëjtën qasje për të gjithë klientët e tyre pavarësisht etnisë apo statusit të tyre shoqëror. Çështja e pozicionit të grupeve të marginalizuara zakonisht përkufizohet në strategjitë kombëtare (në disa raste edhe në legjislacion) për grupe të tilla, por ndihma për popullatat në kushte të vështira shoqërore dhe ekonomike zakonisht ofrohet si kombinim i mbështetjes shtetërore dhe bashkiake, me disa raste të pakta që përfshijnë subvencione të drejtpërdrejta për ujin ose për shërbime të tjera bashkiake (shihni Kapitullin VI, Seksioni D për më shumë detaje).

**49. Gjinia nuk shihet si një çështje në sektorin e shërbimeve të ujit, megjithë përfaqësimin e ulët të grave në stafin e kompanive të ujit.** Mungesa e ekuilibrit gjinor nuk shihet si çështje në sektorin e ujit në asnjë nga 16 vendet e rajonit (mbledhja e të dhënave SoS), dhe si e tillë nuk mbulohet në strategjitë ekzistuese të sektorit. Megjithatë, opinionet e ekspertëve konfirmojnë gjithashtu se ka mungesë të përgjithshme ekuilibri gjinor në stafin e kompanive të ujit, veçanërisht në nivelin e vendimmarrjes / menaxhimit. Nën përfaqësimi i grave në stafin e kompanive shpjegohet zakonisht nga ekspertët si rrjedhojë e kërkesave të larta fizike të punës, Megjithëse kjo nuk shpjegon nën përfaqësimin e grave në nivelin drejtues.

## C. Menaxhimi i Burimeve

### 50. Menaxhimi i burimeve ujore kryhet më së shumti përmes një qasjeje të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore.

Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore në vendet e BE-së dhe futja e qasjes së Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (IWRM) për menaxhimin e burimeve ujore dhe mbrojtjen nga përmblytjet mbizotërojnë në të gjithë rajonin dhe kjo është në linjë me kërkesat e WDF-së. Hartimi dhe zbatimi i këtyre planeve janë përgjithësisht përgjegjësi e ministrisë së linjës që është përgjegjëse për administrimin e ujërave (që në të shumtën e rasteve është Ministria e Bujqësisë, por në disa vende edhe Ministria e Mjedisit). Disa vende si Kroacia, Bosnje Hercegovina, Hungaria dhe Serbia kanë krijuar agjenci shtetërore kombëtare të ujit me përgjegjësi të konsiderueshme në lidhje me administrimin e burimeve ujore. Siç u përmend në Kapitullin II, Seksioni D, këto plane më pas harmonizohen me Planin e Menaxhimit të Basenit të Lumit Danub në koordinim me ICPDR.

**TABELA 4: TARI FAT E BURIMEVE UJORE**

Vendi	Tarifa e nxjerrjes së ujit	Shuma në vit e mbledhur nga tarifa e nxjerrjes (Euro)	Tarifa e lejes për shkarkimin e ujërave të ndotura	Shuma e mbledhur në vit nga tarifa e shkarkimit të ujit	Tarifat e mbledhura i paguhen	Totali i tarifave mbledhur në vit (Euro për person për vit)
Shqipëria	Po, por nuk tariforet sistematikisht	230,000	Jo	n.a.	Buxheti i shtetit	0.08
Austria	Po	Nuk tarifohet	Po	Nuk tarifohet	Nuk mundësohet	n.a.
Bosnje Hercegovina	Po	5,400,000	Po	15,800,000	Buxheti i shtetit	5.58
Bullgaria	Po, por nuk tariforet sistematikisht	9,300,000	Po	2,000,000	Buxheti i shtetit	1.55
Republika Çeke	Po	147,000,000	Po	7,500,000	Fondi i përcaktuar i ujit	14.71
Kroacia	Po	40,000,000	Po	29,000,000	Fondi i përcaktuar i ujit	16.05
Hungaria	Po	43,000,000	Po	10,000,000	Buxheti i shtetit	5.35
Kosova	Po, por nuk tariforet sistematikisht	190,000	Po, por nuk tariforet sistematikisht	190,000	Buxheti i shtetit	0.21
Maqedonia	Po, por nuk tariforet sistematikisht	1,500,000	Po, por nuk tariforet sistematikisht	15,000	Buxheti i shtetit	0.77
Moldavia	Po	Tariforet së bashku me tarifën e ujërave të ndotura	Po	150,000	Fondi i përcaktuar i ujit	0.04
Mali i Zi	Po, por nuk tariforet sistematikisht	550,000	Po, por nuk tariforet sistematikisht	210,000	Buxheti i shtetit	1.45
Rumania	Po	Nuk ka të dhëna	Po	Nuk ka të dhëna	Buxheti i shtetit	Nuk ka të dhëna
Serbia	Po	37,000,000	Po	Nuk ka të dhëna*	Buxheti i shtetit	5.21
Sllovakia	Po	37,000,000	Po	7,000,000	Fondi i përcaktuar i ujit	8.15
Sllovenia	Po, por nuk tariforet sistematikisht	Nuk ka të dhëna	Po	Nuk ka të dhëna	Buxheti i shtetit	Nuk ka të dhëna
Ukraina	Po	Nuk ka të dhëna	Po	Nuk ka të dhëna	Buxheti i shtetit	Nuk ka të dhëna

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS. SHËNIM\*VLERA E TARI FËS SË NXJERRJES PËRFSHIN GJITHASHTU TARI FËN E SHKARKIMIT, QË NUK OFORHET VEÇMAS.





51. **Megjithëse është e ligjshme, përdorimi faktik i tarifave të nxjerrjes së ujit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura, zakonisht nuk është një instrument efikas për rregullimin e burimeve.** Koncepti i licencave të nxjerrjes së ujit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura ekziston në të gjitha vendet e rajonit, por disa vende nuk vendosin tarifa nxjerrjeje, ndërsa të tjerët nuk i zbatojnë ato plotësisht. Fondet e mbledhura nga tarifa të tilla në shumicën e rasteve janë të ardhura për buxhetin e shtetit (me përjashtim të Kroacisë, Republikës Çeke, Moldavisë dhe Sllovakisë, ku ato kanalizohen në një fond të përcaktuar për ujin), nga ku shpërndahen në përputhje me nevojat e qeverisë. Shumat e mbledhura fillojnë nga ajo më simbolike si në Shqipëri deri në relativisht të konsiderueshme si në Kroaci dhe në Republikën Çeke, por vijojnë të jenë të ulëta në nivelin rajonal (mesatarja rajonale është vetëm 4 Euro për person për vit) dhe nuk i kalon 20 Euro për person për vit në asnjë vend të rajonit (Tabela 4).


#### Agjencitë kombëtare të ujit

Vetëm katër vende (Bosnje Hercegovina, Kroacia, Moldavia, dhe Serbia) kanë agjenci të pavarura shtetërore të ujit me një nivel të caktuar përgjegjësie për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe atyre sanitare dhe vetëm në Kroaci kjo agjenci (Ujërat Kroate) ka përgjegjësi thelbësore dhe një buxhet të përshtatshëm për të gjitha aspektet e sektorit të ujit. Buxheti i Ujërat Kroate (310 milion Euro ose 70 Euro për frymë për vitin 2014) gjenerohet kryesisht nga tarifatat e ndryshme të mbledhura nga të gjithë përdoruesit e ujit në Kroaci, dhe agjencia ka pak ose aspak mbështetje nga buxheti i shtetit.

## D. Rregullimi

52. **Gjatë 15 viteve të fundit vendet në rajonin e Danubit kanë qenë pjesë e një prirjeje drejt një rregullimi më të pavarur të ofrimit të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, veçanërisht në vendet me kompani më të mëdha rajonale.** Nga 15 vendet e përfshira në raport, 9 prej tyre kanë autoritete të pavarura rregullatore që mbikëqyrin sektorin e shërbimeve të ujit: Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Kosova, Moldavia, Rumania, Sllovakia, dhe Ukraina. Nga këto agjenci rregullatore vetëm Autoriteti Rregullator i Ujit në Shqipëri ka nisur funksionimin përpara vitit 2000. Të tjerët u krijuan ose ndërmorën funksionet e tyre rregullatore mbi shërbimet e ujit në 15 vitet e fundit (Figura 21), shpesh paralelisht ose si parakusht për përpjekjet e ristrukturimit apo riorganizimit të sektorit të shërbimeve komunale (Kroacia, Kosova, Rumania). Për më tepër, po kryhen studime të vazhdueshme dhe diskutime për të vlerësuar formalizimin e mundshëm të kuadrove rregullatore në tre vende të tjera (Bosnje Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi).

FIGURA 21: KOHA E KRIJIMIT TË AGJENCIVE RREGULLATORE TË THEMELUARA NË RAJONIN E DANUBIT



SOURCE: AUTHORS' ELABORATION FROM SOS DATA COLLECTION.

53. **Nga nëntë autoritetet e pavarura rregullatore në rajon, vetëm tre janë specifike për sektorin e ujit: Shqipëria, Kroacia dhe Kosova.** Gjashtë autoritetet e tjera janë shumë sektoriale, dhe rregullojnë gjithashtu edhe energjinë elektrike, ngrohjen e distrikteve dhe sektorët e gazit, ndër të tjera. Një nga argumentet në favor të rregullatorëve shumë sektorialë në vend të një rregullatori të përkushtuar ka të bëjë me mundësinë e transferimit të njohurive dhe përvojës së rregullatorit nga një sektor në tjetrin. Për më tepër, një model shumë sektorial, të paktën në teori, mundëson pavarësi më të madhe të rregullatorit duke mos lejuar që një sektor i vetëm të mbizotërojë programin dhe ta bëjë agjencinë të varur financiarisht nga një sektor i vetëm apo nga një kompani e madhe komunale. Por në praktikë mund të mos jetë kështu. Gjatë një tryeze pune të organizuar nga Programi i Ujit të Danubit, dy rregullatorë shumë sektorialë thanë se sektori i ujit shpesh zë përparësi më të pakta rregullatore se sa sektori i energjisë elektrike në agjencitë e tyre, duke sjellë ndonjëherë vendimmarrje të vonuar për sa i përket sektorit të ujit.

**54. Të gjitha autoritetet rregullatore në rajon luajnë rol formal në përcaktimin dhe miratimin e tarifave, shpeshherë përkrah autoriteteve të qeverisjes vendore.** Nga të gjithë rregullatorët, vetëm ai hungarez ka një rol këshillues në procesin e përcaktimit të tarifave (vendimi formal merret nga ministria). Rregullatorët e tjerë kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë në përcaktimin e tarifave, ose duke i përcaktuar ato formalisht ose duke shqyrtuar dhe miratuar tarifën e propozuar, shpesh pasi ato janë miratuar më parë nga këshillat e qeverisjes vendore. Në vendet që nuk kanë një rregullator ekonomik të përkushtuar, funksionet rregullatore si përcaktimi i tarifave dhe monitorimi i cilësisë së shërbimit ndërmerren përgjithësisht nga qeverisjet vendore, ndonjëherë me përfshirjen e mekanizmave të kontrollit të qeverisë qendrore (Maqedonia, Serbia).

**55. Metodologjitë e përcaktimit të tarifave ndryshojnë në vende të ndryshme, por tavani i të ardhurave është i përdorur gjerësisht.** Katër vende në rajon, Maqedonia, Kosova, Rumania dhe Ukraina, përdorin qasjen e shkallës së kthimit të investimit. Hungaria, Mali i Zi dhe Serbia nuk kanë një metodologji të hartuar për përcaktimin e tarifave. Megjithatë, praktikisht, duke qenë se kompanitë komunale në rajon janë më së shumti në pronësi të qeverisjes vendore, që i japin më shumë përparësi tarifave të ulëta se sa fitimeve të mëdha, përcaktimi i tarifave nuk është një instrument efikas rregullator, siç do të ishte në një kontekst privat të shtyrë nga fitimi.

**TABELA 5: PRAKTIKAT E RREGULLIMIT EKONOMIK NË VENDET E RAJONIT TË DANUBIT**

Vendi	Metodologjia e përcaktimit të tarifave	Baza për përcaktimin e tarifës	Procesi i përcaktimit të tarifës	Tarifa të vendosura në nivelet e përcaktuara nga rregullimi	Sigurimi i niveleve të tarifës së rregulluar	Shpeshitë minimale e shqyrtimit të tarifave
Shqipëria	Po, në përdorim	Tavani i të ardhurave	Tarifa të përcaktuara nga rregullatori	Goxha sistematikisht	Jo, kërkesat për shqyrtim tarife vijnë nga ndërmarrjet komunale	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale
Austria	Po, në përdorim	Tavani i të ardhurave	Kompanitë përcaktojnë tarifën në këshillim me autoritetet vendore	Goxha sistematikisht	Po, përmes gjobave ose tërheqje fondesh	Po, përmes shpeshitë së përcaktuar të shqyrtimit të tarifave dhe indeksimit
Bosnje Hercegovina	Jo	Nuk mundësohet	Kompanitë përcaktojnë tarifën në këshillim me autoritetet vendore	Vetëm kur autoritetet vendore dhe drejtuesit e kompanive arrijnë marrëveshje	Po, rregullatori mund të përcaktojë tarifën njëanshmërisht	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale
Bullgaria	Po, në përdorim	Tavani i çmimit	Tarifa të përcaktuara nga rregullatori	Jo shpesh	Rregullatori miraton nivelin maksimal të tarifave. Kompania mund të kërkojë më pak	Po, nëpërmjet indeksimit automatik
Kroacia	Po, në përdorim	Tavani i çmimit	Rregullatori shqyrton dhe miraton tarifën	Goxha sistematikisht	Po, rregullatori mund të përcaktojë tarifën njëanshmërisht	Po, përmes shpeshitë së përcaktuar të shqyrtimit të tarifave
Republika Çeke	Po, në përdorim	Tavani i të ardhurave	Kompanitë përcaktojnë tarifën në këshillim me autoritetet vendore	Goxha sistematikisht	Po, rregullatori mund të përcaktojë tarifën njëanshmërisht	Po, përmes shpeshitë së përcaktuar të shqyrtimit të tarifave
Hungaria	Jo, por në hartim e sipër	Nuk mundësohet	Rregullatori i rekomandon tarifën ministrisë kombëtare	Rrallë, por përcaktim i vjetër tarifash pritet pasi të miratohet rregullimi i tarifave	Po, përmes gjobave dhe tërheqje fondesh	Jo aktualisht, por mundet pasi të miratohet rregullimi i tarifave
Kosova	Po, në përdorim	Shkalla e kthimit të investimit	Rregullatori shqyrton dhe miraton tarifën	Goxha sistematikisht	Po, rregullatori mund të përcaktojë tarifën njëanshmërisht	Po, përmes shpeshitë së përcaktuar të shqyrtimit të tarifave
Maqedonia	Po, por nuk aplikohet akoma sistematikisht	Shkalla e kthimit të investimit	Kompanitë përcaktojnë tarifën në këshillim me autoritetet vendore	Vetëm kur autoritetet vendore dhe drejtuesit e kompanive arrijnë marrëveshje	Jo nëse është paraqitur shqyrtim tarifash	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale
Moldavia	Po, në përdorim	Tavani i të ardhurave	Rregullatori shqyrton dhe miraton tarifën	Vetëm kur autoritetet vendore dhe drejtuesit e kompanive arrijnë marrëveshje	Jo nëse është paraqitur shqyrtim tarifash	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale
Mali i Zi	Jo	Nuk mundësohet	Kompanitë përcaktojnë tarifën në këshillim me autoritetet vendore	Vetëm kur autoritetet vendore dhe drejtuesit e kompanive arrijnë marrëveshje	Jo nëse është paraqitur shqyrtim tarifash	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale



Vendi	Metodologjia e përcaktimit të tarifave	Baza për përcaktimin e tarifës	Procesi i përcaktimit të tarifës	Tarifa të vendosura në nivelet e përcaktuara nga rregullimi	Sigurimi i niveleve të tarifës së rregulluar	Shpeshtia minimale e shqyrtimit të tarifave
Rumania	Po, në përdorim	Shkalla e kthimit të investimit	Tarifa të përcaktuara nga rregullatori	Goxha sistematikisht	Po	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale
Serbia	Jo	Nuk mundësohet	Kompanitë përcaktojnë tarifën në këshillim me autoritetet vendore	Vetëm kur autoritetet vendore dhe drejtuesit e kompanive arrijnë marrëveshje	Po, përmes gjobave dhe tërheqje fondesh	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale
Slovakia	Po, në përdorim	Tavani i çmimit	Rregullatori shqyrton dhe miraton tarifën	Goxha sistematikisht	Po, rregullatori mund të përcaktojë tarifën njëanshmërisht	Po, përmes shpeshtisë së përcaktuar të shqyrtimit të tarifave
Slovenia	Po, në përdorim	Tavani i të ardhurave	Kompanitë përcaktojnë tarifën në këshillim me autoritetet vendore	Goxha sistematikisht	Nuk ka informacion	Po, përmes shpeshtisë së përcaktuar të shqyrtimit të tarifave
Ukraina	Po, në përdorim	Shkalla e kthimit të investimit	Tarifa të përcaktuara nga rregullatori	Rrallë	Po, rregullatori mund të përcaktojë tarifën njëanshmërisht	Jo, kërkesat për shqyrtim tarifash vijnë nga ndërmarrjet komunale

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

**56. Agjencitë rregulatore në rajon ndryshojnë shumë në lidhje me pavarësinë, qeverisjen dhe burimet financiare dhe njerëzore.** Megjithëse të gjitha agjencitë konsiderohen të pavarura, në rreth gjysmën e rasteve ato varen nga buxheti i shtetit për veprimtarinë e tyre, dhe drejtuesit e tyre emërohen nga ekzekutivi dhe jo nga parlamenti. Për më tepër, numri i përgjithshëm i personelit dhe niveli i buxhetimit ndryshojnë konsiderueshëm, megjithëse mund të vihen re disa modele. Agjencitë rregulatore që më së shumti rregullojnë kompanitë komunale bashkiake kanë prirjen të kenë rreth një person në staf për çdo tre ose katër kompani të rregulluara, ndërsa agjencitë që rregullojnë operatorët e mëdhenj rajonalë, (Hungaria, Kosova, Rumania) prirjen të kenë rreth dy persona në staf për çdo kompani komunale. Kroacia, ku kuadri rregullor është akoma në fillimet e tij, përbën përjashtim, me vetëm një teknik në staf për të gjithë vendin (Tabela 6).

**TABELA 6: TIPARET KRYESORE TË AGJENCIVE RREGULLATORE NË RAJONIN E DANUBIT**

	Shqipëria	Bullgaria	Kroacia	Hungaria	Kosova	Moldavia	Rumania	Slovakia	Ukraina
Emri <sup>10</sup>	ERRU	EWRC <sup>11</sup>	Këshilli për shërbime uji	HEA	WWRO	ANRE	ANRSC	URSO	NEURC
Bazuar në?	Ligji për rregullatorin	Ligji për rregullimin e ujit	Ligji i ujit	Ligji i ujit, ligji për statusin ligjor	Ligji për rregullatorin	Ligji i ujit	Ligji i ujit	Ligji për rregullatorin	Dekreti dhe ligji
Rregullon tarifa?	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Licencon operatorët?	Po	Jo	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Trajton ankesat e klientëve?	Jo	Po	Po	Po	Po	Po	Jo	Jo	Po
Buxheti vjetor	€350,000	€2.0M	€160,000	€15 milion (përfshi gjithë sektorët)	€300,000	€1.5 milion			€2,175,000
Burimi i fondeve	Tarifa e rregullatorit	Tarifa e rregullatorit, gjoba përmes buxhetit të shtetit	Buxheti i shtetit	Tarifa e rregullatorit, gjoba, ngarkime të tjera	Tarifa e rregullatorit	Tarifa e rregullatorit	Buxheti i shtetit	Buxheti i shtetit	Buxheti i shtetit

<sup>10</sup> ERRU: Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura; EWRC: Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Ujit; HEA: Autoriteti Rregullator Hungarez i Energjisë dhe Kompanive Komunale Publike; WWRO: Zyra Rregulatore e Ujit dhe Ujërave të Ndotura; ANRE: Agjencia Kombëtare për Rregullimin e Energjisë; ANRSC: Autoriteti Rregullator i Shërbimeve Publike Vendore; URSO: Zyra Rregulatore e Industrive të Rrjetit; NEURC: Komisioni Kombëtar për Rregullimin e Energjisë Shtetërore dhe Kompanitë Komunale Publike.

<sup>11</sup> EWRC është në proces rristrukturimi, sipas ligjit për Sektorin e Energjisë të miratuar në mars të vitit 2015; informacioni në tabelë i referohet strukturës së re qeverisëse, por përfshin stafin dhe buxhetin aktual.

	Shqipëria	Bullgaria	Kroacia	Hungaria	Kosova	Moldavia	Rumania	Sllovakia	Ukraina
Fushëveprimi	SHUK	Shumë sektorial	SHUK	Shumë sektorial	SHUK	Shumë sektorial	Të gjitha shërbimet vendore	Shumë sektorial	Shumë sektorial
Kompani uji të rregulluara	58	64	157	41	7	40	42	14	147
Stafi	5 komisionerë	128 gjithsej (2 + 15 punonjës për SHUK)	9 anëtarë (kohë e pjesshme) 1 teknik	65	11 teknikë	60 gjithsej (7 për SHUK)	96 gjithsej	6 gjithsej	Uji: 71 Gjithsej: 600
Emëruar nga?	Kryeministri bazuar në listë të shkurtër	Parlamenti	Parlamenti	Kryeministri	Parlamenti (me propozim qeverie)	Parlamenti		Presidenti	Presidenti
Mandati	2 x 5-vjet	2 x 5-vjet	1 x 5-vjet	2x7 vjet	1 x 4-vjet	6-vjet		6-vjet	2 x 6-vjet
I raporton?	Parlamentit dhe Kryeministrit	Parlamentit	Parlamentit	Parlamentit	Parlamentit	Parlamentit	Ministresë së zhvillimit rajonal	Parlamentit	Presidentit, Parlamentit

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

**57. Rregullimi i cilësisë së shërbimit është normalisht përgjegjësi e një ministrie apo agjencie shëndeti publik, ndërsa rregullimi mjedisor është përgjegjësi e një ministrie apo agjencie mjedisore në secilin vend.** Asnjë nga vendet e rajonit nuk i ka përqendruar të gjitha veprimtaritë rregullatore në një agjenci të vetme. Në fakt në një sërë rastesh agjencitë rregullatore janë krijuar mbi struktura ekzistuese, duke sjellë role plotësuese dhe me raste në konflikt me atë të qeverisjes vendore dhe ministrive të linjës.

## E. Monitorimi dhe Matja e Sektorit

**58. Informacioni i sektorit nuk është i konsoliduar në institucione të vetme në asnjë nga vendet e rajonit.** Seksioni B vuri në pah nivelin e lartë të shpërndarjes së përgjegjësive politike bërëse dhe mungesën e një ministrie të vetme linje në shumicën e rasteve. Logjikisht, kjo situatë pasqyron disponueshmërinë e informacionit të sektorit, që rrallëherë është i konsoliduar në nivelin e sektorit. Në shumicën e rasteve, informacioni i administrimit të burimeve ujore është i disponueshëm nga Ministrinë e Bujqësisë ose Mjedisit, informacioni mbi uji e pijshëm mundësohet nga Ministria e Mjedisit, informacioni mbi kompanitë komunale (kur ka të tillë) mundësohet nga autoriteti rregullator, dhe financimi i sektorit ndonjëherë mundësohet nga Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (investimet). Vendet e BE-së kanë një gjendje disi më të mirë, duke qenë se ato duhet të raportojnë në mënyrë të strukturuar në lidhje me ecurinë drejt përputhshmërisë me Direktivën e Kuadrit të Ujit dhe direktivat që rrjedhin prej saj, dhe kjo do të thotë se një pjesë e informacionit është e konsoliduar përmes përdorimit të standardeve ndërkombëtare, por dhe në këto raste ky informacion është tejet i kufizuar nga treguesit në shkallë vendi. Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore, një pjesë kyçe e WDF-së, shpesh nuk i kushtojnë vëmendje shërbimeve të ujit dhe të ujërave të ndotura përtej lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë me planet për sa i përket përdorimit të ujit, mundësisë për ndotje dhe nevojave për investim. Disa nga autoritetet rregullatore me më shumë përvojë në rajon, si autoriteti i Shqipërisë, kanë nisur të hartojnë edhe marrëveshje dypalëshe për shkëmbimin e informacionit me aktorë të tjerë si Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financës.

### Burimet rajonale të informacionit mbi sektorin: IBNET dhe DANUBIS.org

IBNET (Rrjeti Ndërkombëtar i Matjeve për Kompanitë e Ujit dhe Sanitare) (www.IB-Net.org) është baza më e madhe botërore e të dhënave me të dhëna performance mbi kompanitë e ujit dhe sanitare. Mbështetur nga Programi i Ujit dhe Shërbimeve Sanitare i Bankës Botërore, gjatë viteve ka mbledhur një pasuri me të dhëna nga kompani në rajonin e Danubit, që janë përdorur në Kapitullin V. Duke ngritur mbi këtë burim të çmuar Programi i Ujit i Danubit ka hapur DANUBIS.org, një depozitë në internet me burime për dhe mbi kompanitë e ujit dhe ato sanitare në rajonin e Danubit. DANUBIS.org punon në partneritet me palët kombëtare të interesit në shumicën e vendeve të rajonit dhe ka si qëllim të konsolidojë informacionin e disponueshëm nga burimet kombëtare, IBNET-i dhe nga ky raport.

**59. Shumica e vendeve në rajon kanë një mekanizëm për monitorimin e performancës së kompanive në sektor, por ky mekanizëm bëhet rrallë publik.** Tabela 7 jep një panoramë të sistemeve të institucionalizuara të informacionit për performancën e kompanive komunale dhe skema të tjera matjeje në të gjitha vendet e rajonit. Në të gjitha vendet me një agjenci rregullatore të ngritur, institucioni ka marrë drejtimin në lidhje me krijimin e të paktën një sistemi të kufizuar



informacioni për kompanitë komunale. Megjithatë, praktikat në lidhje me përpunimin e informacionit në një renditje formale nga rregullatori apo një vlerësim performance, dhe nëse këto bëhen publike apo jo, ndryshojnë. Vetëm dy vende, Shqipëria dhe Kosova, botojnë rregullisht një raport vjetor të matjeve nga rregullatori. Në vendet që nuk kanë një institucion të tillë, shoqatat e ujit kanë hartuar shpesh skema matjeje vullnetare për kompanitë komunale për të ndihmuar anëtarët e tyre të përmirësojnë performancën e tyre, dhe në disa raste për të arritur lobim më efikas për mbështetje më të madhe të sektorit.

**TABELA 7: SISTEME TË INSTITUCIONALIZUARA INFORMACIONI PËR PERFORMANCËN E KOMPANIVE DHE SKEMAT E MATJES NË RAJON**

Vendi	Propozuesi	Fushëveprimi <sup>12</sup>			Pjesëmarrja	Publike?	Mbulimi i Sistemit
		Vetëm informacion	Matje Rregullatore	Matje e Kompanive Komunale			
Shqipëria	Ministria e linjës/rregullatori	✓	✓		E detyruar	Po	Të gjitha kompanitë
Austria	Shoqata e Ujit			✓	Vullnetare	Në nivel grumbullimi	Disa kompani
Bosnje Hercegovina	Nuk mundësohet						
Bullgaria	Autoriteti Rregullator	✓			E detyruar	Jo drejtpërsëdrejti	Të gjitha kompanitë
Kroacia	Autoriteti Rregullator	✓			E detyruar	Jo	Shumica e kompanive, po zhvillohet
Republika Çeke	Nuk mundësohet						
Hungaria	Autoriteti Rregullator	✓			E detyruar	Nuk dihet	Në zhvillim e sipër
Kosova	Autoriteti Rregullator	✓	✓		E detyruar	Po	Të gjitha kompanitë
Maqedonia	Shoqata e Ujit	✓		✓	Vullnetare	Jo drejtpërsëdrejti	Disa kompani
Moldavia	Shoqata e Ujit	✓			Vullnetare	Po	Shumica e kompanive
Mali i Zi	Nuk mundësohet						
Rumania	Autoriteti Rregullator	✓			E detyruar	Në nivele grumbullimi	Të gjithë kompanitë
	Shoqata e Ujit	✓		✓	Vullnetare	Jo drejtpërsëdrejti	Shumë kompani
Serbia	Shoqata e Ujit	✓		✓	Vullnetare	Jo drejtpërsëdrejti	Disa kompani
Slovakia	Autoriteti Rregullator	✓			E detyruar	Në nivel grumbullimi	Të gjitha kompanitë
Slovenia	Nuk mundësohet						
Ukraina	Autoriteti Rregullator	✓			E detyruar	Në nivel grumbullimi	Vetëm kompanitë e mëdha

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

<sup>12</sup> Vetëm informacion: Sistem vetëm për ofrim informacioni; Matje Rregullatore: Matjet rregullatore u përqendruan në renditjen dhe vlerësimin e kompanive komunale; Matjet e Kompanive: matja e kompanive u përqendrua në identifikimin e mangësive në performancë dhe mundësitë për përmirësime.

## IV. AKSESI NË SHËRBIME

60. **Aksesi në shërbime uji dhe shërbime sanitare në rajonin e Danubit është i lartë krahasuar me pjesën tjetër të botës.** Largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura mbetet prapa aksesit përgjithësisht të lartë në ujë nga rrjeti dhe tualeteve private me shkarkim, veçanërisht në lidhje me standardet e BE-së me të cilat kërkojnë të përputhen shumica e vendeve të zonës ujëmbajtëse të Danubit. Megjithatë, kur përlogaritet aksesi i grupeve me të ardhura të ulëta dhe grupeve të minoritetit, apo në rajone nën-kombëtare, mangësitë në shërbim bëhen më të dukshme dhe duhet të trajtohen përmes politikave apo investimeve të mirë drejtuara.


61. Ky kapitull ofron një panoramë të gjendjes së aksesit në të gjitha vendet. Statistikat janë përlogaritur nga të dhënat e anketimit të familjeve dhe janë krahasuar me statistika të ngjashme të raportuara nga Programi i Përbashkët i Monitorimit, një bazë të dhënash administruar nga OBSH / UNICEF me statistika mbi aksesin në ujë dhe shërbime sanitare. Përveç anketimeve kombëtare të familjeve, Anketimi i BE-së mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (EU-SILC), u përdor për rastet kur të dhënat e anketimit të buxhetit kombëtar nuk ishin të disponueshme.

62. Vlerësimi i statistikave të dhëna në këtë seksion nga anketimet origjinale, kombëtare apo EU-SILC qofshin, ofron një mundësi për të përlogaritur aksesin e grupeve me të ardhura, etni dhe në rajone të ndryshme, që nuk është e mundur në mënyra të tjera. Shënimi Metodologjik A, në fund të këtij dokumenti rendit anketimet e ndryshme, variablat që japin informacion mbi të ardhurat, dhe pyetjet e bëra gjatë anketimeve për të vlerësuar aksesin në shërbime.

### A. Uji

63. **Mbulimi i familjeve me ujë nga rrjeti ka vijuar të jetë i lartë në vendet në zonën ujëmbajtëse të Danubit që prej fillimit të mijëvjeçarit.** Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet candidate kanë përjetuar një rritje të vogël, por jo të konsiderueshme, në mbulimin me shërbim, që i kundërvihet një rënieje të vogël, por të konsiderueshme, në vendet jashtë BE-së, përfshirë Moldavinë dhe Ukrainën<sup>13</sup>. Figura 22 gjithashtu pasqyron hendekun këmbëngulës që zgjerohet pak e nga pak midis vendeve të BE-së dhe vendeve candidate dhe kolegëve të tyre më pak të integruar në BE në lindje.

FIGURA 22: MBULIMI ME UJË NGA RRJETI 2000-12



BURIMI: OBSH/UNICEF 2012, DUKE PËRJASHTUAR KOSOVËN

64. **Mesatarisht, bazuar në statistikat e anketimit të familjeve, 83% e popullatës në vendet në zonën ujëmbajtëse të Danubit kanë akses në ujë nga rrjeti në banesat e tyre.** Megjithatë, jo të gjitha familjet e marrin furnizimin e tyre me ujë nga kompanitë komunale publike, duke qenë se mbulimi mesatar nga rrjetet formale publike raportohet të jetë vetëm


<sup>13</sup> Kjo analizë e prirjeve bazohet në të dhënat e mbledhura nga OBSH/UNICEF në vitin 2012. Aksesi mesatar në ujë nga rrjeti i popullatës në vendet në zonën ujëmbajtëse të Danubit, përjashtuar Kosovën, ishte 75% në vitin 2012, që është disi më i ulët se sa statistika mesatare prej 83% vlerësuar nga anketimet më të fundit të familjeve, kryesisht sepse shifrat e OBSH/UNICEF nuk janë përditësuar pas bërjes publike të raundit më të fundit të anketimeve të familjeve.



74%<sup>14</sup> Ndryshimi prej rreth 10% i është atribuar me kujdes ofruesve alternativë të ujit, që mund të jenë sisteme të vogla komunitare që mbizotërojnë në zonat rurale me dendësi të ulët popullore, ose lidhje të improvizuara të instaluar nga familja dhe që janë të panjohura për kompanitë komunale. Siç tregon edhe Figura 23, hendeku më i gjerë midis kompanive komunale publike dhe ofrimit alternativ gjendet në Bosnje Hercegovinë dhe Kosovë, me 28 dhe 29% përkatësisht.

**65. Ndryshimet hapësinore në akses brenda vendeve shpjegojnë përse disa vende janë prapa.** Shumica e vendeve të BE-se kanë një akses në ujën e rrjetit prej thuhetse 100% pavarësisht vendndodhjes (shih Figurën 23 djathtas), dhe vendet më të varfra gjithashtu, si Bosnje Hercegovina dhe Kosova, kanë një hendek të ngushtë midis aksesit të banorëve ruralë me ata urbanë, Megjithatë kjo mund të jetë arritur përmes mbështetjes më të madhe në ofrues se sa në kompani komunale publike. Ama, aksesit në ujë rrjeti nga ana e banorëve ruralë është gjysmë ose më pak se gjysmë se mbulimi i zonave urbane në Moldavi, Rumani dhe Ukrainë, që janë edhe vendet me aksesin më të ulët mesatar në ujë nga rrjeti.

**FIGURA 23: PËRQINDJA E POPULLATËS ME UJË RRJETI SIPAS VENDNDODHJES DHE LLOJIT TË OFRIMIT**



*BURIMET: AKSESI HAPËSINOR DHE MESATAR JANË PËRLLORARITUR NGA ANKETIMET E NDRYSHME TË FAMILJEVE (2010-2012); FURNIZIMI NGA RRJETI PUBLIK ËSHTË MARRË NGA BURIMET TË NDRYSHME TË PËRMBLEDHURA PËRMES MBLEDHJES SË TË DHËNAVE SOS DHE RAPORTUAR NË SHTOJCËN STATISTIKORE SIPAS VENDEVE*


**66. Rreth 22.5 milion njerëz, ose 17% e popullatës së rajonit, nuk kanë furnizim me ujë nga rrjeti në banesat e tyre.** Gjysma e popullatës pa ujë nga rrjeti gjendet në Ukrainë (12.4 milion) dhe një çerek tjetër gjendet në Rumani (5.8 milion), më së shumti në zona rurale, por ka edhe popullata të mëdha pa furnizim me ujë nga rrjeti në zona urbane. Në përgjithësi, mungesa e aksesit në ujë rrjeti është kryesisht fenomen i zonave rurale ose vendbanimeve me densitet të ulët popullore, ku zakonisht mungon ekonomia e shkallës për të ofruar shërbimet e rrjetit përmes infrastrukturës moderne me efikasitet në kosto (Figura 24). Megjithatë, është e rëndësishme të kihet parasysh që Programi i Përbashkët i Monitorimit raporton se thuhetse të gjithë individët (99%, përjashtuar Kosovën) kanë akses në burime ujore të përmirësuara, përfshirë pusët e mbrojtura, burimet dhe zgjidhje të tjera në terren, për të plotësuar kërkesat e tyre për furnizim me ujë (OBSh / UNICEF 2012), kështu që sfida në vendet evropiane dhe në fqinjët e tyre lidhet më shumë me standardet e shërbimit se sa me nevojat bazë.

**67. Aksesit në ujë nga rrjeti në segmente të varfra të popullatës mund të shpjegohet vetëm disi nga ndryshimet në pasuri në një vend.** Vendet më të pasura dhe më të pjekura të BE-së (Austria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Sllovakia dhe Sllovenia) kanë arritur me sukses të përfshijnë segmentet më të varfrave të popullatës (pra, 40%-shin e poshtëm dhe ata që jetojnë me më pak se 2-50 USD në ditë PPP për frymë), siç tregohet në Figurën 25. Ama, disa nga vendet më të varfra, duke vënë në pah Kosovën me PBB-në e dytë nga fundi për frymë ndër vendet e Danubit (8.700 USD PPP në vitin 2013), arriti gjithashtu të sigurojë akses të lartë për 40 përqindëshin e poshtëm (93%) dhe për më të varfrit (84%). Në të kundërt, PBB-ja e Rumanisë është pak më e lartë krahasuar me Bullgarinë (18.600 USD kundër 15.900 USD PPP), por ama aksesit në ujë nga rrjeti është më i ulët në Rumani (71% kundër 98% në Bullgari), dhe akoma më i ulët për

<sup>14</sup> Kjo statistikë raportohet nga çdo vend dhe përbën ofrimin e "ditur" të ujit nga rrjeti nga kompanitë komunale publike. Gjithashtu përfshihet edhe mbulimi i familjeve që ndajnë një linjë uji, dhe për këtë arsye furnizimi publik me ujë mund të kalojë furnizimin nga rrjeti marrë nga familjet në banesat e tyre, siç raportohet në anketimet e familjeve.

40 përqindëshin e poshtëm (54% kundër 95%) dhe ata që jetojnë me më pak se 2.50 USD në ditë PPP (32% kundër 75%).


**68. Krahasuar me fqinjët e tyre jo Romë, Romët kanë përgjithësisht akses më të ulët në shërbime uji dhe shërbime**  
**FIGURA 24: VENDNDODHJA E POPULLATËS PA UJË RRJETI NË BANESË**



BURIMET: PËRLLLOGARITUR NGA NKETIME TË NDRYSHME FAMILJESH (2010-2012); SHKALLA E URBANIZIMIT ËSHTË MARRË NGA BANKA BOTËRORE 2015.

**sanitare në shumicën e vendeve të zonës ujëmbajtëse të Danubit.** Informaliteti dhe distanca e vendbanimeve Rome, diskriminimi, pagesat e pakryera të faturave të shërbimeve dhe mungesa e burimeve financiare për të paguar tarifat e instalimit ndërveprojnë në mënyra të ndryshme në secilën vendndodhje dhe kështu shpjegojnë aksesin e kufizuar. Rezultatet nga një anketim i vendbanimeve më të mëdha Rome në Bullgari, Republikë Çeke, Hungari, Rumania dhe Sllovakia, tregojnë ndryshime të konsiderueshme në aksesin në shërbime të përmirësuara uji dhe shërbime sanitare nga Romët krahasuar me fqinjët e tyre jo Romë (shih Figurën 25). Ndërkohë që kosto vlerësimi nuk pasqyrojnë statistikën në nivel vendi,<sup>15</sup> ato janë të rëndësishme sepse krahasojnë familjet që jetojnë në të njëjtën lagje (duke shqyrtuar kështu largësinë), por për persona që vijnë nga sfonde të ndryshme etnike.

**FIGURA 25: AKSESI NË UJË RRJETI – POPULLATA E PËRGJITHSHME, 40 PËRQINDSHI I POSHTËM DHE MË TË VARFRIT**




BURIMET: PËRLLLOGARITJE TË AUTORËVE NGA ANKETIME TË NDRYSHME FAMILJESH (2010-2012) DHE NDARË SIPAS NJË AKSESI MESATAR. SHËNIM: BOSNJE HERCEGOVINA, MAQEDONIA DHE SERBIA BAZUAR NË GRUPIME ANKETASH ME SHUMË TREGUES PA RAPORTIME MBI VARFËRINË EKSTREME

<sup>15</sup> Statistikat kombëtare sipas etnisë janë raportuar vetëm për Rumaninë, dhe ato tregojnë aksesin në ujë nga rrjeti në familje për popullatën Rome prej 47% krahasuar me mesataren kombëtare prej 71%. Aksesin e përmirësuar në burime uji pritet të rritet konsiderueshëm, sepse statistikën përfshijnë shërbime uji nga rrjeti të ndara midis konsumatorëve dhe burime të tjera ujore që konsiderohen si të sigurta për konsum.





**FIGURA 26: AKSESI I ROMËVE DHE FQINJËVE TË TYRE JO ROMË NË SHËRBIME UJI DHE SHËRBIME SANITARE**




BURIMI: PËRSHTATUR NGA BANKA BOTËRORE 2014, 154.

## B. Shërbimet Sanitare dhe Kanalizimet

69. **Thuajse 80% e popullatës së vendeve në zonën ujëmbajtëse të Danubit raportojnë se përdorin një tualet me shkarkim në banesat e tyre, por ama vetëm 66% janë të lidhur me rrjetin publik të kanalizimeve.** Megjithëse është bërë progres në rajon që prej vitit 2000 për rritjen e mbulimit të popullatës me lidhje me sistemet e kanalizimeve, ndryshimet shihen më së shumti në vendet e BE-së dhe në vendet kandidatë (Figura 27). Në Moldavi dhe Ukrainë, aksesin në kanalizime publike ishte i lartë që prej 15 viteve më parë për shkak të rëndësisë kushtuar largimit të ujërave të ndotura në Ish Bashkimin Sovjetik, por nuk ka ecuri të mëtejshme që prej atij momenti.

**FIGURA 27: MBULIMI ME KANALIZIME, 2000-12**




BURIMI: VLERËSIM I AUTORËVE NGA MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

70. **Ndryshimi më i madh midis aksesit në tualete me shkarkim dhe kanalizimeve publike është në Bosnje Hercegovinë, Kroaci dhe Mal të Zi** (shih Figurën 28). Krahasimet midis aksesit në tualete me shkarkim dhe kanalizime duhet të ndërmerren duke patur parasysh problemin se statistikat për aksesin në tualete me shkarkim janë marrë nga të dhënat e anketimit të familjeve dhe përfshijnë vetëm ato familje me një tualet privat në banesat e tyre, dhe statistikat për aksesin në kanalizime publike janë raportuar nga autoritetet kombëtare dhe përfshijnë familjet që ndajnë një tualet, ndërsa përjashtojnë ato që kanë mënyra të tjera të sigurta për largimin e mbetjeve, si gropat septike.

71. **Akoma më shumë se furnizimi me ujë rrjeti, mungesa e aksesit në tualete private është më së shumti dërrmuese në zonat rurale apo zonat me densitet të ulët popullate.** Moldavia ka mbulimin më të ulët të raportuar me tualete private të popullatës rurale (7%), por Bullgaria, Rumania dhe Ukraina gjithashtu raportojnë statistika rurale poshtë ose fare pak


**FIGURA 28: PËRQINDJA E POPULLATËS ME TUALETE PRIVATE ME SHKARKIM DHE LIDHJE ME KANALIZIMET, SIPAS VENDNDODHJES**



BURIMET: AKSES HAPËSINOR DHE MESATAR ËSHTË PËRLLOGARITUR NGA ANKETIMET E NDRYSHME TË FAMILJEVE; AKSESI NË KANALIZIME VJEN NGA MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

mbi 40%. Nga pikëpamja e shifrave absolute, shumica e popullatës pa akses në tualete private është e vendosur në zona rurale; vetëm në Kroaci dhe Kosovë ata pa akses janë të shpërndarë thuajse barabar, siç tregohet në Figurën 29. Nga pikëpamja e thjeshtë shifrave, Moldavia dhe Ukraina rurale së bashku përbëjnë pak më shumë se gjysmën e popullatës që nuk kanë akses në tualete private midis vendeve të zonës ujëmbajtëse të Danubit (51 përqind). Duke shtuar Rumaninë, thuajse 80% e numrit të përgjithshëm të banorëve pa akses në tualete private mund të gjenden në këto tre vende. Gjithashtu, popullata rurale e Bullgarisë është gjerësisht e pambuluar, duke kontribuar me më shumë se 5% të përqindjes të përgjithshme të atyre të pa mbuluar me tualete private në vendet e zonës ujëmbajtëse të Danubit.

**FIGURA 29: VENDNDODHJA E POPULLATËS PA AKSES NË TUALETE PRIVATE ME SHKARKIM**




BURIMET: PËRLLOGARITUR NGA ANKETIME TË NDRYSHME FAMILJES (2010-2012); SHKALLA E URBANIZIMIT ËSHTË MARRË NGA BANKA BOTËRORE 2015

**72. Më pak se 20% e të varfërve dhe më pak se gjysma e 40 përqindëshit të poshtëm kanë akses në tualete private në Bullgari, Moldavi dhe Ruman.** Aksesit i ulët, mesatarisht dhe për segmentet më të varfra të popullatës, është veçanërisht mbresëlënëse në Bullgari që kishte performancë më të mirë në lidhje me ujin e rrjetit dhe është shumë më e urbanizuar se dy vendet e tjera (73% krahasuar me 45% në Moldavi dhe 54% në Ruman) (Figura 30). Aksesit i ulët nga të varfrit në Bullgari pasqyrohet gjithashtu në aksesin e ulët në shërbime të përmirësuara sanitare nga Romët, treguar në Figurën 26 më lart.



**FIGURA 30: AKSESI NË TUALETE PRIVATE ME SHKARKIM – POPULLATA E PËRGJITHSHME, 40 PËRQINDSHI I POSHTËM, DHE MË TË VARFRIT**



BURIMET: LLOGARITJET E AUTORËVE NGA ANKETIMET E NDRYSHME TË FAMILJEVE (2010-2012) DHE NDARË SIPAS AKSESIT MESATAR. SHËNIM: BOSNJE HERCEGOVINA, MAQEDONIA DHE SERBIA BAZOHEN NË GRUPIMET E ANKETIMEVE ME SHUMË TREGUES, DHE NUK KA RAPORTIME PËR VARFËRINË EKSTREME

## C. Trajtimi i Ujërave të Ndotura

### 73. Mbulimi me trajtim të ujërave të ndotura ka arritur përmirësime të konsiderueshme gjatë 15 viteve të fundit

(veçanërisht në vendet anëtare të BE-së), por mbeten akoma më pak i zhvilluar i ofrimit të shërbimit të ujit. Në fillimin e procesit të zgjerimit të BE-së në rajon, trajtimi i ujërave të ndotura ishte shumë më i pazhvilluar se aspektet e tjera të ofrimit të shërbimit të ujit dhe në vitin 2000 rreth 35% e të gjithë popullatës në rajon ishte e lidhur me një nivel trajtimi (Figura 32). Situata është përmirësuar gradualisht pas zgjerimit të BE-së në rajon dhe investimeve të mëdha që janë bërë në vendet anëtare të BE-së, por rajoni është akoma shumë prapa pjesëve të tjera të Evropës në fushën e trajtimit të ujërave të ndotura.

### 74. Ka ndryshime të mëdha në nivelin e ofrimit të trajtimit të ujërave të ndotura në rajon, dhe ndërkohë që është bërë progres, rajoni në përgjithësi është akoma prapa pjesëve të tjera të Evropës.


Aktualisht, 45% e të gjithë popullatës së rajonit është e lidhur me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, por ka ndryshime në përqindjen e popullatës në vende të veçanta që janë të lidhura me trajtimin e ujërave të ndotura duke shkuar nga 97% në Austri deri në 2% në Kosovë (Figura 31). Pjesa e popullatës me trajtim të ujërave të ndotura është rritur në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vendet e rajonit gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Megjithatë, ka një ndryshim të konsiderueshëm midis mbulimit në vendet e BE-së dhe atyre që nuk janë pjesë e BE-së (Figura 32), që tregon ndikimin e madh të investimeve të fondit strukturor të BE-së në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të ndotura. Në të njëjtën kohë, të dhënat tregojnë gjithashtu edhe progres të kufizuar në vendet e Ballkanit që nuk kanë nisur akoma procesin e anëtarësimit (Bosnje Hercegovina, Maqedonia, Kosova dhe Serbia). Niveli fillestar relativisht i lartë i trajtimit të ujërave të ndotura në vendet jashtë BE-së (Moldavia dhe Ukraina) mund të shpjegohet nga niveli më i lartë i vëmendjes ndaj trajtimit të ujërave të ndotura në ish Bashkimin Sovjetik, krahasuar me ish Jugosllavinë.

### 75. Me gjithë progresin e arritur, rajoni i basenit të Danubit është akoma goxha prapa pjesëve të tjera të BE-së, veçanërisht në lidhje me trajtimin tretësor. Thuajse 20 vjet pas miratimit të Direktivës UWWT, trajtimi i ujërave të ndotura është i lartë në BE15, me 97% të

#### Kërkesa për largimin e ushqyesve në basenin e Danubit

Nëse ujërat pritëse janë ujëra veçanërisht të ndjeshme, si ato që tashmë vuajnë nga eutrofikimi, kërkohet reduktim më i fuqishëm i ushqyesve (fosfor dhe azot) nga shkarkimet e ujërave të ndotura (i ashtuquajturit trajtimi tretësor i ujërave të ndotura). Si rrjedhojë e nevojës për të mbrojtur deltën e Danubit dhe ujërat bregdetare të Detit të Zi nga eutrofikimi, duhet të një pjesë e konsiderueshme e popullatës së basenit të Danubit të ketë trajtim të nivelit tretësor. Afatet për përputhshmërinë me Direktivën UWWT ndryshojnë dhe për BE15-ën (Shtetet origjinale Anëtare të BE-së) data ishte 31 dhjetor 2005. Për Shtetet e reja Anëtare në Evropën Qendrore dhe Lindore, janë përcaktuar periudha tranzicion me faza në Traktatet individuale të Anëtarësimit. Megjithatë, në parim, këto periudha tranzicioni nuk shkojnë përtej vitit 2015 (përveç se në Rumani, ku grumbullimet me më pak se 10.000 p.e. duhet të jenë në përputhje me direktivën në fund të vitit 2018; dhe në Kroaci, që si një vend i ri anëtar ka afate midis vitit 2018 dhe 2023).


**FIGURA 31: MBULIMI ME TRAJTIM TË UJËRAVE TË NDOTURA NË RAJON, 2012**



BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

popullatës në vendet e Evropës Qendrore dhe 84% të popullatës në vendet e Evropës Veriore të lidhur me një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, krahasuar me vetëm 67% të popullatës në vendet e BE-së në Evropën Lindore. Për shkak të përqendrimit të madh për largimin e ushqyesve nga ujërat e ndotura, trajtimi tretësor i ujërave të ndotura ka përjetuar një rritje të konsiderueshme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit në të gjithë BE-në. Aktualisht, rreth 50% e popullatës në vendet e reja anëtare të Evropës Lindore kanë një nivel tretësor trajtimi, që është akoma shumë më e ulët se mesatarja e BE-së, por që përbën një rritje prej 30% krahasuar me periudhën para 10 vitesh. Ka ndryshime të mëdha në mbulimin me trajtim tretësor në rajon, ku rreth 90% e popullatës në Austri, 60% në Republikën Çeke dhe 20% në Sllovakia (Mbledhja e të Dhënave SoS dhe EEA 2015) janë të lidhur me trajtimin tretësor, ndërsa ky lloj trajtimi nuk ekziston në pjesën jugore të rajonit (përfshirë Bosnje Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë).

**FIGURA 32: KRAHASIM I MBULIMIT ME TRAJTIM UJËRASH TË NDOTURA MIDIS VENDEVE ANËTARE TË BE-SË, VENDEVE KANDIDATE DHE VENDEVE JASHTË BE-SË**



BURIMI: PËRLOGARITJE E AUTORËVE BAZUAR NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS.

**76. Vendet e BE-së janë angazhuar për të qenë në përputhje me synimet e largimit të ujërave të ndotura dhe kanë përpara tyre afate për të arritur përputhshmëri të plotë.** Direktivat e BE-së, siç u tha, kërkojnë largim të ujërave të ndotura për të gjitha vendbanimet me popullatë mbi 2.000 banorë, Megjithatë kërkesat për trajtimin e kanalizimeve ndryshojnë në varësi të vendbanimit dhe ndjeshmërinë e zonës. Ndër vendet e BE-së në zonën ujëmbajtëse të Danubit, shkalla e përputhshmërisë së Bullgarisë dhe Sllovenisë për sa i përket largimit të ujërave të ndotura janë vetëm 15 dhe 32 përqind, përkatësisht, ndërsa Rumania është akoma në "tranzicion" dhe do të duhet të ndër marrë përpjekje të konsiderueshme për të përmbushur afatet e ardhshme të përputhshmërisë (EC 2013, 2, Shtojcë). Si Bullgaria ashtu edhe




Slovenia pritet të përmbushin përputhshmërinë me largimin e ujërave të ndotura në vendbanime me popullatë mbi 2.000 vetë deri në vitin 2015 (mbledhja e të dhënave SoS). Kroacia ka akoma një periudhë faljeje, por duhet të nisë punën për mbylljen e hendekut, duke qenë se vetëm 44 përqind e banorëve të saj janë të lidhura me një sistem publik kanalizimi.

### Standardet teknike në rajonin e Danubit

Kërkesat teknike për projektimin dhe ndërtimin e strukturave të ujësjellësve dhe sanitare në të gjitha vendet e rajonit përcaktohen nga legjislacioni kombëtarë (shpesh përbërë nga ligji për ndërtimin dhe shoqëruar me aktet nënligjore), dhe standardet teknike ekzistuese kombëtare, ndërsa ato vende që janë anëtare të BE-së janë në përputhje me kërkesat e projektimit dhe të ndërtimit të BE-së. Shumë vende në rajon, janë mbështetur historikisht në standardet gjermane DIN (Deutsches Institut für Normung) (Kroacia, Sllovenia), ose ato të ish Jugosllavisë JUS (Jugoslovenski Standard) (Bosnje Hercegovina, Serbia), ndërsa vende të tjera përdorin standardet teknike të hartuara në vend me prirjen për t'i përshtatur gradualisht me ato që përdoren në vendet e BE-së. Standardet teknike dhe të ndërtimit të epokës ish sovjetike (që janë të shëndosha nga pikëpamja teknike, por që shpesh nuk trajtojnë ekonominë e veprimtarisë) përdoren akoma në vendet që kanë qenë pjesë e ish Bashkimit Sovjetik (Moldavia dhe Ukraina). Në shtetet e krijuara rishtazi si Kosova, zhvillimi i standardeve teknike dhe normave të furnizimit me ujë dhe për ujërat e ndotura është një proces në vazhdim, por qëllimi është hartimi i standardeve të bazuara në kërkesat e BE-së, ndërkohë që në periudhën tranzitore ata po përdorin kryesisht standardet DIN si norma teknike të gatshme dhe gjerësisht të respektuara.

**FIGURA 33: SHKALLA E PËRPUTHSHMËRISË ME KËRKESAT E DIREKTIVËS SË UJËRAVE TË NDOTURA URBANE: LARGIMI, TRAJTIMI DHE TRAJTIMI MË I RREPTË**



BURIMI: KE 2013, 2, ANNEX.

### Standardet e shërbimit dhe zgjidhjet me efikasitet kostoje nën direktivat e BE-së

As Direktiva e Ujit të Pijshëm (DWD) dhe as Direktiva e Trajtitit të Ujërave të Ndotura Urbane (UWWTD) përfshijnë standarde apo kërkesa specifike shërbimi në nivelin e familjes. Megjithatë, në të gjithë Evropën, uji nga rrjeti dhe tualetet me shkarkim në banesa që shkojnë përtej përkufizimit të JMP-së mbi shërbimet e përmirësuara, përfaqësojnë nivelin më të pranuar të shërbimit. Si DWD-ja ashtu edhe UWWTD-ja vendosin standarde cilësie, dhe në rastin e UWWTD-së krijohen edhe standarde largimi, që ngre çështjen e trajtimit të këtyre kërkesave me efikasitet kostoje, veçanërisht në rastet kur nuk ka infrastrukturë publike të ngritur.

UWWTD-ja krijon si standard sistemet tradicionale të largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për grumbullimet me të shumë se 2.000 popullatë barasvlerëse, por gjithashtu ofron mundësinë e sistemeve individuale ose të tjera të përshtatshme, për ato raste kur një sistem i centralizuar nuk do të sillte përfitime mjedisore, sepse do të kishte kosto të larta. Megjithatë, në raste të tilla, këto sisteme duhet të arrijnë të njëjtin nivel të mbrojtjes mjedisore, që në çështje gjyqësore (Çështja C-119/2002 Komisioni kundër Greqisë) ka marrë konfirmim se ka kuptimin se shkarkimet në tokë duhet të trajtohen në të njëjtin nivel me shkarkimet në trupa ujorë, duke kufizuar kështu përdorimin e kësaj klauzole. Udhëzimet e kohëve të fundit të Komisionit kufizojnë përdorimin e sistemeve të tilla në 2% të një grumbullimi të caktuar. Për më tepër, në vendbanime të vogla, sistemet qendrore me kosto të ulët, si pellgjet me ujëra të ndotura dhe sistemet e ndërtuara moçalore, janë mundësi të gjera të trajtimit të ujërave të ndotura që operohen thjeshtë, që kanë kërkesa të ulëta energjetike dhe që mund të përmbushin kërkesat e Direktivës së Trajtitit të Ujërave të Ndotura Urbane të BE-së për më pak se 10.000 popullatë barasvlerëse, edhe në zonat e ndjeshme. Për më tepër, koncepteve moderne të administrimit të ujërave të ndotura në vend, të decentralizuara, apo gjysmë të decentralizuara që përdoren në disa nga vendet më të zhvilluara Evropiane (Gjermania, Holanda, Suedia) i është kushtuar vëmendje gjithmonë e më e madhe kohët e fundit, veçanërisht në zonat rurale dhe gjysmë urbane. Këto koncepte përfshijnë largimin, trajtimin dhe heqjen apo ripërdorimin e ujërave të ndotura nga komunitetet e vogla (nga banesat e veçanta tek pjesë të komunitetit ekzistues) duke përdorur impiante shumë të vogla sanitare/të trajtimit të ujërave të ndotura, të projektuara dhe ndërtuara në vend dhe që janë më fleksibël, më të qëndrueshme dhe me efikasitet më të madh kostoje. (WECF 2010)

## V. PERFORMANCA E SHËRBIMEVE

77. Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, në lidhje me cilësinë dhe efikasitetin e tyre, ndryshon shumë në rajon, por në përgjithësi është poshtë praktikave të mira ndërkombëtare. Megjithatë, në 20 vitet e fundit, janë vënë re prirje pozitive në një sërë dimensionesh që tregojnë se kompanitë komunale në rajon po drejtohen ngadalë për nga standardet ndërkombëtare. Performanca e përgjithshme e kompanive komunale duket gjerësisht e shtyrë nga zhvillimi i vetë vendit, dhe përgjithësisht shtetet anëtare të BE-së udhëheqin në këtë drejtim. Megjithatë, një analizë më e thelluar hedh dritë mbi shtytsat e performancës së kompanive komunale.

78. Ky kapitull mbulon shërbimet e ofruara nga kompanitë komunale formale ("furnizimi publik"), që përfaqësojnë rreth tre të katërtat e popullatës në rajon (shih Kapitullin IV). Fatkeqësisht, ka pak informacion të disponueshëm rreth performancës, cilësisë apo edhe kostove të ofruesve informale (sisteme komunitare apo fshatare dhe familjen me vetë furnizimi), që përfaqësojnë një të katërtën e popullatës. Në të ardhmen do të duhet punë e mëtejshme për të kuptuar funksionimin e këtyre shërbimeve. Megjithatë, kur është e mundur dhe e kuptimtë, shifrat e këtij kapitulli përfshijnë mesataren proporcionale<sup>16</sup> për shtetet anëtare të BE-së (blu), vendet kandidatë (jeshile), dhe vendet jashtë BE-së (e kuqe), si dhe praktikatat e mira (me jeshile dhe të marra si 90 përqindëshi i sipërm i kompanive komunale me performancën më të mirë në rajon).

79. Shumica e informacionit në këtë kapitull është marrë nga dy burime. Njëri është një përpjekje vend më vend kryer në kuadrin e këtij vlerësimi për të mbledhur të dhëna të disponueshme për publikun në nivel vendi mbi performancën (referuar si mbledhja e të dhënave SoS, dhe referuar veçmas në tabelat e vendeve në fund të këtij dokument), ndërsa burimi tjetër është grupi i madh i të dhënave mundësuar nga baza e të dhënave e Rrjetit Ndërkombëtar të Matjeve (IBNET) / DANUBIS, që mbulon më shumë se 450 kompani komunale dhe ka kryer më shumë se 3.400 observime në periudhën 1995-2013. Të dy burimet kanë sfida të mundshme në lidhje me të dhënat. Të dhënat në nivel vendi zakonisht nuk ofrojnë të dhëna për periudha të gjata dhe paraqesin një mesatare dhe jo të gjithë spektrin e të dhënave. Për më tepër, cilësia e të dhënave ndryshon konsiderueshëm dhe të dhënat janë të kufizuara në ato vende që nuk kanë një agjenci të pavarur rregullatore që mbledh të dhëna mbi performancën e kompanive komunale. Për më tepër, të dhënat e IBNET / DANUBIS nuk i përfshijnë sistematikisht të gjitha kompanitë komunale (mbulimi më i lartë në Shqipëri, Bullgari, Republikë Çeke, Kosovë dhe Moldavi). Për këto arsye prirjet dhe mesataret mund të mos jenë plotësisht përfaqësuese të sektorit në përgjithësi. Së fundmi, siç u diskutua edhe në seksionin e fundit, mesataret në nivel vendi maskojnë një gjendje të madhe heterogjene midis kompanive në të njëjtin vend. Burimet dhe vlerat e sakta të treguesve dhe të dhënave të paraqitura në tekst janë renditur në tabelat e plota në fund të këtij dokumenti, dhe qasja metodologjike për analizën e këtij kapitulli është dhënë gjithashtu me detaje në fund të këtij dokumenti.

### A. Cilësia e Shërbimit dhe Praktikatat me Klientët

80. **Në shumë nga vendet e rajonit, shërbimi i ujit është përgjithësisht i pandërprerë, dhe uji i pijshëm përmbush standardet kombëtare të cilësisë.** Megjithatë, ka përjashtime dhe përjashtimi më i dukshëm është Shqipëria, ku shumë nga shoqëritë ujësjellëse nuk ofrojnë furnizim të pandërprerë, si dhe Moldavia, ku cilësia e ujit të pijshëm është një sfidë e vazhdueshme. Aty ku janë në funksion, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, gjithashtu përmbushin përgjithësisht kërkesat e dokumentit të licencimit, përveç Shqipërisë dhe Moldavisë përsëri, dhe Kosovës dhe Malit të Zi, ku trajtimi i ujërave të ndotura ka nisur të përdoret gjerësisht vetëm kohët e fundit. Tabela 8 dhe Figura 34 japin një panoramë të situatës në vende të ndryshme për të cilat ka informacion.

81. **Kënaqësia e klientëve është më e lartë aty ku cilësia e shërbimit është më e lartë, dhe kjo nuk është për t'u habitur.** Sipas një anketimi të vitit 2013 nga Gallup, kënaqësia me shërbimet e ujit dhe ato sanitare në shumicën e vendeve të rajonit të Danubit është më e ulët se sa mesatarja e vendeve të BE-së, ku vendet e BE-së janë në pozicion më të mirë se vendet kandidatë për në BE dhe vendet jashtë BE-së (Figura 35). Pa u habitur, mbase kënaqësia e klientëve është e lidhur ngushtë me performancën e përgjithshme të shërbimit matur nga Indeksi i Performancës së Kompanive të Ujit (Shih Seksionin C të këtij kapitulli për më shumë detaje).


82. **Mekanizmat e mbrojtjes së konsumatorit janë të zhvilluara pak në rajon, veçanërisht në vendet me agjenci rregullatore.** Në thuajse gjysmën e vendeve të rajonit, ligji përcakton se kompanitë komunale duhet të kenë një mekanizëm të brendshëm për trajtimin e ankesave të klientëve; megjithatë, shumë pak kompani për shembull

<sup>16</sup> Zakonisht mesataret merren proporcionalisht me popullatën e vendit.



ndërmarrin vullnetarisht sondazhe mbi kënaqësinë e konsumatorit, me përjashtim të kompanive të menaxhuara nga sektori privat në Bullgari dhe në Republikën Çeke. Ato vende që nuk kanë agjenci të pavarura rregullore përgjithësisht nuk ofrojnë një mekanizëm institucional të jashtëm për të trajtuar ankesat apo për të vlerësuar kënaqësinë e konsumatorëve. Ndër ato vende me një rregullator të pavarur të krijuar, pothuajse të gjitha ofrojnë një mekanizëm formal për ankesat e konsumatorëve përmes rregullatorit, por pak prej tyre kanë praktika më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e konsumatorit. Faktikisht, vetëm Shqipëria, ku rregullatori është themeluar pothuajse 20 vite më parë, raporton se përdor instrumente të tilla si dëgjesat publike për vendosjen e tarifave, si dhe nënshkrimin e kontratave formale të marrëveshjeve për shërbim midis shoqërive dhe klientëve të tyre (Tabela 9).

**FIGURA 34: VAZHDIMËSIA E SHËRBIMIT NË VENDET E RAJONIT TË DANUBIT**



BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

**TABELA 8: VAZHDIMËSIA E SHËRBIMIT NË VENDET E RAJONIT TË DANUBIT**

Vendi	Shërbimi i pandërprerë i ujit			A është cilësia e ujit në përputhje?	A është trajtimi i ujërave të ndotura në përputhje?
	A është shërbimi i pandërprerë?	Vlera[lorë/ditë]	Viti		
Shqipëria	Në disa qytete	12	2013	Në shumë qytete	Në disa qytete
Austria	Po	24	2013	Po	Po
Bosnje Hercegovina					
Bullgaria	Po			Po	Në shumicën e qyteteve
Kroacia	Po	24	2013	Po	Në shumicën e qyteteve
Republika Çeke	Po	24	2013	Po	Po
Hungaria	Po	24	2013	Po	Po
Kosova	Në shumë qytete	22	2013	Në shumicën e qyteteve	Jo
Maqedonia	Po	24	2013	Po	Në disa qytete
Moldavia	Në shumë qytete	21	2012	Në disa qytete	Në disa qytete
Mali i Zi	Në shumë qytete	24	2010	Në shumicën e qyteteve	Jo
Rumania	Po			Po	Po
Serbia	Në shumë qytete			Po	Po
Slovakia	Po	24	2013	Po	Po
Slovenia		24	2013		
Ukraina	Në shumë qytete	17	2012	Në shumë qytete	Në shumë qytete
<b>Mesatarja Rajonale</b>		<b>20</b>			

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

### Standardet e cilësisë së ujit të pijshëm

Kërkesat për ujin e pijshëm pasqyrojnë kërkesat e harmonizuara nga direktivat përkatëse të BE-së (Direktiva 98/83/EC mbi cilësinë e ujit për qëllim konsumi njerëzor), and stadnardet e CEN (Komiteti Evropian i Normalizimi) janë të harmonizuara në legjislacionin kombëtar të të gjitha vendeve të BE-së, ndërsa vendet që aspirojnë të bëhen vende anëtare të BE-së, janë duke harmonizuar normat dhe kërkesat e tyre kombëtare me kërkesat e BE-së (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi). Përjashtimet e vetme janë Moldavia dhe Ukraina, ku kërkesat kombëtare të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura, përcaktohen nga legjislacioni kombëtar i bazuar në standardet e vjetra të Bashkimit Sovjetik.

### Standardet e cilësisë për trajtimin e ujërave të ndotura

Kërkesat për trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura siç parashikohet nga kërkesat përkatëse të BE-së (Direktiva 86/280/EC, 86/278/EC dhe 91/271/EC) në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura urbane (UËËTD) jaën përfshirë në legjislacionin kombëtar në të gjitha vendet anëtare të BE-së. Disa vende, si Austria, kanë miratuar standarde kombëtare që janë më të larta se sa kërkesat e BE-së apo OBSH-së. Si pjesë e procesit të anëtarësimit, vendet e veçanta të BE-së kanë negociuar standardet e kërkuara të trajtimit të ujërave të ndotura dhe periudhat e tranzicionit për të arritur përputhje, duke shtyrë kështu zbatimin e standardeve të rena dakord. Vendet candidate për në BE kanë standarde derdhëse që janë të krahasueshme me kërkesat e BE-së, por përgjithësisht nuk kanë përcaktuar zonat e ndjeshme dhe kërkesat përkatëse për trajtimin e ujërave të ndotura. Moldavia dhe Ukraina janë duke përdorur akoma gjerësisht standardet e trajtimit të ish Bashkimit Sovjetik, që në terma nominale nuk janë poshtë kërkesave të BE-së.

TABELA 9: PRAKTIKAT RAJONALE TË MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Vendi	Brenda shoqërisë			Përtej shoqërisë	
	Sondazhe klientësh nga shoqëria	Mekanizmi i ankesave të klientëve	OJF për mbrojtjen e konsumatorit	Autoriteti për ankesat e klientit	Sondazhe të jashtme konsumatorësh
Shqipëria	Ndonjëherë	Shpesh	Jo	Rregullatori	Nga rregullatori
Austria	Ndonjëherë	Shpesh	Jo	Jo	Nga shoqata kombëtare
Bosnje Hercegovina	Ndonjëherë	Me ligj	Jo	Jo	Jo
Bullgaria	Rrallë	Rrallë	Jo	Rregullatori	Sipas rastit
Kroacia	Ndonjëherë	Me ligj	Jo		Sipas rastit
Republika Çeke	Ndonjëherë	Me ligj	Jo	Ministria	
Hungaria	Shpesh	Me ligj	Jo	Agjencia e mbrojtjes së konsumatorit	
Kosova	Me ligj	Me ligj	Jo	Komitetet e konsumatorëve	Nga rregullatori
Maqedonia	Jo	Me ligj	Po		Sipas rastit
Moldavia	Ndonjëherë	Jo	Po	Rregullatori	Jo
Mali i Zi	Jo	Shpesh	Jo	Jo	Jo
Rumania	Shpesh	Me ligj	Jo	Rregullatori	Nga shoqata kombëtare
Serbia	Ndonjëherë	Shpesh	Jo	Jo	Jo
Slllovakia	Ndonjëherë	Me ligj	Jo	Rregullatori	Jo
Sllovenia	Ndonjëherë	Shpesh	Jo	Jo	Jo
Ukraina	Ndonjëherë	Me ligj	Jo	Rregullatori	Sipas rastit

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS


83. **Niveli i matjes për konsumatorët, një instrument i rëndësishëm për administrimin e kërkesave, është rritur gradualisht deri në pothuajse një mbulim të plotë në shumë vende.** (Figura 36). Megjithëse matja e konsumit individual të çdo konsumatori nuk ishte një praktikë e konsoliduar tregtare në shumicën e vendeve në fillimin e viteve '90, tashmë është konsoliduar si një përbërës i rëndësishëm për administrimin efikas të kërkesës dhe një mënyrë e drejtë për shpërndarjen e kostos midis konsumatorëve. Aktualisht, në ato vende ku ka informacion të disponueshëm, vetëm Shqipëria dhe disi më pak Ukraina nuk kanë nivele matjeje mbi 80%, dhe në të dy vendet po bëhen përpjekje për të rritur përqindjen e lidhjeve me matësa. Një sfidë e veçantë në disa vende të rajonit është fakti se matësit, kur janë të instaluar,





vendosen për objektin dhe jo në nivel apartamenti, kështu që shkalla e vendosjes së matësve është e mbivlerësuar, sepse nuk matet nëse të gjithë përdoruesit e fundmë kanë matësa, por matet me faktin se sa faturime bëhen në bazë të leximit të matësit, edhe nëse më pas duhet të ndahet për apartamentet në bazë të sipërfaqes ose numrit të banorëve.


**FIGURA 35: KËNAQËSIA E KLIENTIT ME CILËSINË E UJIT NË VITIN 2013 DHE KRAHASUAR ME PERFORMANCËN E SHËRBIMIT<sup>17</sup>**



BURIMET: GALLUP 2013; DETAJIMI I AUTORËVE BAZUAR NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS

**84. Në të kundërt, konsumi individual ka ndjekur një prirje të vazhdueshme rënëse.** Për shkak të rritjes së matjes individuale, rritjes së tarifave dhe rënies së aktivitetit të industrisë në të gjithë rajonin, konsumi i përgjithshëm i ujit për person ka rënë gjatë 10 viteve të fundit dhe është duke u stabilizuar në kuotën e rreth midis 100 litrave për frymë për ditë dhe 120 litra për frymë për ditë që është edhe standardi në të gjithë BE-në, me përjashtime të konsiderueshme sidomos mes vendeve të ish Jugosllavisë, si Bosnje Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia (Figura 36 dhe Figura 37), ku tarifat janë nga më të ulëtat (shih Kapitullin VI). Ndërkohë që tarifat rriten dhe matësit në nivel apartamenti përdoren më gjerësisht, mund të pritet që konsumi individual të vijojë të ulet në ato vende ku është akoma relativisht i lartë.


**FIGURA 36: EVOLUIMI PARALEL I LIDHJEVE TË MATURA DHE KONSUMI PËR FRYMË NË KOMPANITË KAMPION NGA VENDET E PËRZGJEDHURA NË RAJON**



BURIMI: TË DHËNA NGA IBNET / DANUBIS.ORG

<sup>17</sup> Shih Seksionin C to këtij kapitulli për më shumë detaje.

FIGURA 37: KONSUMI BANIMI UJIT NË VENDET E RAJONIT



BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

## B. Efikasiteti

85. **Me gjithë përmirësimin dhe bashkimin e përgjithshëm, efikasiteti i kompanive komunale në shumicën e vendeve është poshtë standardeve ndërkombëtare.** Performanca e kompanive në valën e parë të vendeve anëtare të BE-së (Republika Çeke, Hungaria, Sllovakia, dhe Sllovenia) ishte disi më e ulët se sa standardet ndërkombëtare në momentin e tyre të anëtarësimit, dhe ndërkohë këto vende i arritën më së shumti standardet. Megjithatë, performanca e kompanive në pjesën tjetër të vendeve është akoma konsiderueshëm prapa praktikave të tilla Me gjithë përmirësimet e shënuara në disa nga treguesit kyç klasikë të performancës që përdoren për të matur praktikën e mira, si niveli i ujit pa të ardhura dhe efikasiteti i plotësimit me staf. Në përgjithësi, kompanitë komunale të rajonit janë në rrugë pozitive drejt efikasitetit më të mirë, por janë gjithashtu në një rrugë me ndryshime të konsiderueshme midis dhe brenda vetë vendeve.


### Uji pa të ardhura

Uji pa të ardhura është një mënyrë matjeje e aftësisë së kompanive komunale për të kthyer materialin e tyre parësor në të ardhura. NRW-ja përbëhet kryesisht nga uji që rrjedh nga sistemi përpara se të arrijë konsumatorin e fundmë (humbje teknike apo fizike), dhe nga uji i konsumuar pa u faturuar siç duhet, për shembull, nga lidhje të jashtëligjshme apo matje e pasaktë e konsumit (humbje tregtare apo në dukje). Ndërsa e para rrit koston e prodhimit pa qenë nevoja (sepse duhet të prodhohet më shumë ujë nga çfarë është e nevojshme), kjo e fundit ka të bëjë me të ardhura të pa mbledhura. Uji pa të ardhura normalisht përllorëtarit bazuar në krijimin e një ekuilibri midis të ujit që hyn dhe del në sistem. Në vitin 2000, forcat e punës për humbjen e ujit dhe treguesit e performancës së Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit hartuan një qasje si standard ndërkombëtar të "praktikës më të mirë" për llogaritjen e ekuilibrit të ujit. (shih, për shembull, Farley dhe Trow 2003).

86. **Uji pa të ardhura (NRW) ka qenë dhe mbetet një sfidë e rëndësishme.** Megjithëse struktura e NRW-së në rajon nuk është e përcaktuar mirë për shkak të mungesës së matjes dhe ekuilibrit të ujit në shumë kompani (shih kutinë), në përgjithësi NRW është shumë më lart nivelit të praktikave të mira, me përjashtim të vendeve në pjesën perëndimore të zonës ujëmbajtëse (Figura 38). Ndërkohë që nuk është e thënë që NRW të minimizohet me çdo mjet (ka një nivel NRW efikas nga pikëpamja ekonomike, që varet nga kostoja e uljes së mëtejshme të NRW dhe nga kostoja e mundësisë së ujit të prodhuar dhe faturuar), nivelet aktuale janë shumë më lart se ato të kompanive dhe nivele të zhvillimit të ngjashme në rajone të tjera. Për më tepër, një shqyrtim i zhvillimit të NRW gjatë 10 viteve të fundit tregon se nuk ka një prirje të qartë rajonale. Kompanitë në Bullgari dhe Maqedoni tregojnë rritje të NRW, Bosnje Hercegovina, Moldavia, dhe Rumania tregojnë rënie, dhe shumica e vendeve të tjera kanë mbetur të qëndrueshme në nivele të tyre të larta. Heterogjenia e disa prej të dhënave mund të vijë nga matja më e mirë e



**FIGURA 38: UJI I SHPËRDORUAR NË VENDET E RAJONIT**




BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

NRW-së sot se sa përpara 15 viteve për shkak të përdorimit të gjerë të matjeve sistematike në anën e prodhimit dhe shpërndarjes.

87. **Efikasiteti i energjisë është një çështje e rëndësishme, por gjithashtu më pak e studiuar në rajon.** Megjithatë informacioni rajonal nuk është i disponueshëm sistematikisht, provat nga një kampionim i kufizuar kompanish, duket se tregojnë se kostot energjetike për metër kub ujë të prodhuar janë rritur në vitet e fundit (Figura 39), duke treguar më tej nevojën për t'u përqendruar në masa të efikasitetit të energjisë. Faktikisht, një studim i ndërmarrë në kuadrin e Programit të Ujit të Danubit për më shumë se 30 impiante trajtimi, stacionesh pompimi dhe sistemesh hidraulike në kompanitë e Bosnje Hercegovinës, Malit të Zi, Rumanisë, Serbisë dhe Ukrainës, arriti në përfundim se kishte mundësi kursimi energjie prej mesatarisht 35% dhe vlerat ishin më të larta në vende me trashëgimi investimesh të kufizuara për mirëmbajtje, si Ukraina (50%). Shumica e investimeve që nevojiten për të materializuar këto mundësi energji kursyese do të kthenin investimin në vetëm dy ose tre vjet, por fondet për financimin e këtyre përpjekjeve nuk gjenden lehtë.<sup>18</sup>

**FIGURA 39: EVOLUIMI I KOSTOVE TË ENERGJISË PËR M3 PRODHUAR NË KOMPANITË KAMPION NË RAJON**




BURIMI: TË DHËNA NGA IBNET / DANUBIS.ORG

<sup>18</sup> Burimi: Dokumentet e brendshme të Programit të Ujit të Danubit.

88. **Kompanitë në rajon zakonisht kanë staf në nivele më të larta se ato të praktikave të mira rajonale.** Punësimi i tepërt i stafit është një çështje tradicionale e shumë kompanive komunale publike në rajon. Megjithatë, prirjet në rajon tregojnë përmirësime të vazhdueshme në produktivitetin e stafit (Figura 40), veçanërisht në ato vende ku nivelet fillestare të punësimit të stafit ishin konsiderueshëm mbi praktikën ndërkombëtare. Me gjithë këtë, në disa prej vendeve numri i personelit për 1.000 persona të shërbyer është akoma mbi praktikën e mira ndërkombëtare të 1 punonjësi për 1.000 persona të shërbyer,<sup>19</sup> megjithëse spektri i shërbimeve të ofruara, shpesh është më i vogël se në vende të tjera (mbulim i kufizuar me kanalizime dhe trajtim të ujërave të ndotura).


**FIGURA 40: EVOLUIMI I EFIKASITETIT TË PLOTËSIMIT ME STAF ME KALIMIN E KOHËS NË RAJON (UJI DHE UJËRAT E NDOTURA)**



BURIMI: TË DHËNA NGA IBNET / DANUBIS.ORG

89. **Efikasiteti tregtar i kompanive komunale përgjithësisht është i shëndoshë, por ndryshon shumë nëpër rajon.** Raporti i mbledhjes së pagesave, pra aftësia e një kompanie për të mbledhur të ardhurat e faturuara nga baza konsumatore, shpesh përdoret si një tregues i rëndësishëm i praktikave të shëndosha tregtare. Performanca e rajonit në këtë pikëpamje është e mirë, me raporte mesatare të mbledhjes rreth 90% në shumë vende, por me disa përjashtime të rëndësishme në Bullgari, Kosovë dhe Malin e Zi, për shembull (Figura 41). Vetëdija për të paguar është veçanërisht e lartë në vendet e pjesës perëndimore të zonës ujëmbajtëse, siç është edhe në vendet e ish Bashkimit Sovjetik. Shkalla e mbledhjes së pagesave në zonën qendrore dhe jugore të zonës ujëmbajtëse është më e ulët.

**FIGURA 41: RAPORTI I MBLEDHJES (TË ARDHURAT NË PARA / TË ARDHURAT E FATURUARA) NË VENDET E RAJONIT**



BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

19 Numri i personave të shërbyer për lidhje ndryshon gjerësisht në rajon, sepse kompanitë në disa vende ia faturon konsumin e ujit shoqatave të pronarëve të ndërtesave që përfaqësojnë qindra konsumatorë fundorë. Si rrjedhojë, efikasiteti i punësimit të stafit këtu matet për popullatën e shërbyer.



## C. Shtysat dhe Prirjet e Performancës së Përgjithshme


### 90. Për të plotësuar analizën përshkuese të performancës së sektorit të paraqitur në kapitujt e mëparshëm, u përgatit edhe një analizë ekonometrike e prirjeve dhe shtysave të performancës së kompanive.

Kjo analizë mundëson analizimin e të dhënave më nga afër dhe nxjerr përfundime që janë të bazuara në statistika. Për këtë qëllim, u përdor grupi i plotë i të dhënave IBNET i disponueshëm për vendet e rajonit. Për më tepër, u përcaktua një indeks i performancës së grupuar, Indeksi i Performancës së Kompanive të Ujit (WUPI) (shih kutinë), për të matur performancën e përgjithshme të kompanive komunale (në lidhje me mbulimin me shërbim, cilësinë e shërbimit dhe administrimin), bazuar në parametra të ndryshëm. Grupi të dhënave IBNET, patjetër që nuk është përfaqësues në të gjitha vendet (Shqipëria, Republika Çeke, Kosova dhe Moldavia janë vendet më të kompletuara, ndërsa Austria, dhe Sllovenia nuk janë fare në sistem, kurse të dhënat për Bosnje Hercegovinën, Kroacinë dhe Ukrainën janë seriozisht të vjetra, ndërsa të dhënat e Malit të Zi janë shumë të pjesshme), dhe gjithashtu nxjerr në pah ndryshime të mëdha brenda vetë vendeve (Figura 42). Megjithatë, përmes përdorimit të metodave statistikore, mund të konfirmohet besueshmëria e rezultateve të paraqitura, dhe paragrafët në vijim japin vetëm përfundimet që janë kontrolluar më së miri. Mund të merren më shumë detaje rreth analizës në fjalë nga një dokument mbështetës i SoS, Klient 2012, i mundësuar përmes faqes SoS.danubis.org.

### Indeksi i Performancës së Kompanive të Ujit

WUPI është një indeks i thjeshtë që mat sa afër është veprimtaria e një kompanie me praktikën e mira të pranuar. Indeksi bazohet në 10 pika të pranuar gjerësisht si tregues kyç performance në industri dhe që mundësohen nga grupi i të dhënave IBNET për shumicën e kompanive në rajon. Këto pika mund të grupohen në tre kategori, mbulim (ujë, kanalizime dhe trajtim të ujërave të ndotura); cilësi (shërbim i pandërprerë, dhe bllokim kanalizimesh) dhe administrim (matje, NRW, produktiviteti i stafit, shkalla e mbledhjes së pagesave, dhe rikuperi i kostove të veprimtarisë). Për çdo pikë përlogaritet një notë nga 1 në 10 duke matur përputhshmërinë e një kompanie të caktuar me praktikën e mira rajonale. Shuma e të gjitha notave jep WUPI-n ku 100 (praktika më e mirë në çdo pikë) është nota më e mirë. Për më shumë shihni Shënimin Metodologjik në fund të raportit.

FIGURA 42: KARAKTERISTIKAT DHE PËRFAQËSIMET E KAMPIONIT IBNET PËR LLOGARITJET WUPI




BURIMI: PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA IBNET / DANUBIS.ORG DATA. 20

### 91. Mbase nuk është e çuditshme që performanca e kompanive ndryshon shumë brenda vendit, por përgjithësisht rritet me nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit. Figura 43 tregon se në cilën të pestë bie performanca e çdo vendi. Për shembull, 100% e kompanive në Republikën Çeke ishin ndër<sup>20</sup> përqindëshin e atyre

20 Madhësia e tregut bazohet në popullatën e shërbyer nga shërbime publike, siç është përftuar nga mbledhja e të dhënave SoS. Austria dhe Sllovenia nuk janë fare të pranishme në bazën e të dhënave IBNET, ndërsa për Shqipërinë dhe Kosovën, të dhënat tregojnë se kompanitë mbi raportojnë numrin e popullatës në juridiksionin e tyre, duke qenë se shumtorja e pjesëve të kombinuara të tregut ishte më e madhe se 100% e popullatës në vend.

që performuan më mirë në rajon në vitin 2013. Nuk është për t'u habitur që kompanitë në vendet që ishin ndër të parat që u anëtarësuan në BE (Republika Çeke, Hungaria, Sllovenia) kanë gjithashtu performancë veçanërisht të mirë, ndërsa vendet që janë më larg anëtarësimit në BE kanë një pjesë më të madhe kompanish që përballen me sfida. Gjithashtu, në shumë vende performanca e kompanive është relativisht homogjene, por në disa vende si Shqipëria, Bullgaria dhe Serbia ka më shumë pabarazi të performancës. Kjo është e një rëndësie të veçantë, sepse tregon se në këto vende mjedisi mundësues është i tillë që krijon mundësi performancë në nivele të larta, por ama që shumë kompani nuk i arrijnë këto nivele.

**FIGURA 43: PROPORCIONI I FITIMIT ME TREGUESIN E PERFORMANCËS SË PËRDORIMIT TË UJIT NË SECILIN SEGMENT PËRQINDJEJE PREJ 20%**




BURIMI: PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA IBNET / DANUBIS.ORG DATA

92. **Performanca e përgjithshme e kompanive të ujit është përmirësuar gjatë 10 viteve të fundit.** Paragrafët dhe kapitujt e mëparshëm kanë treguar tashmë prirjet pozitive në rajon, veçanërisht në lidhje me mbulimin me shërbime kanalizimesh dhe trajtimi ujërash të ndotura, si dhe efikasitetin e kompanive. Këto prirje mund të konfirmohen nga një analizë e kombinuar e Indeksit të Performancës së Kompanive të Ujit. Figura 44, për shembull, tregon pjesën e kompanive në kampionin e përgjithshëm që bien në secilën të pestë (20 përqindësia) të performancës gjatë viteve 2000-2007, për të cilat kampioni është relativisht i qëndrueshëm në lidhje me pjesëmarrjen e vendeve. Pjesa e atyre që kanë patur performancën më të keqe ra gjatë kësaj periudhe nga 10% në 5% të kampionit, ndërsa pjesa e atyre me performancën më të mirë u rrit nga 28% në 40%. Mund të shihet një prirje e ngjashme për WUPI-n mesatar të kampionit, që u rrit nga 67 në 73 gjatë të njëjtës periudhë. Prirja konfirmohet më tej në kampionin e përgjithshëm, ku WUPI i kompanive për vitin e fundit që ato janë përfshirë në bazë të dhënash është 3.7 pikë më lart se viti i parë kur ato janë përfshirë (Klien 2015).


93. **Kompanitë e rajonit tregojnë gjithashtu një prirje kthese drejt praktikave më të mira.** Analiza tregon se kompanitë që nisin me një pikëzim më të ulët tregojnë përmirësime më të mira se sa kompanitë që kanë një pikëzim më të lartë që në fillim, duke treguar kështu një kthesë të performancës së përgjithshme të kompanive në rajon drejt praktikave më të mira (Figura 45). Analiza e detajuar tregon gjithashtu se shumica e kompanive kanë performancë relativisht të njëtrajtshme në fusha të ndryshme, që do të thotë se kompanitë që tregojnë nivele më të larta të mbulimit me shërbim apo cilësisë, piren të tregojnë gjithashtu tregues më të mirë administrues, për shembull.



**FIGURA 44:** PROPORCIONI I FITIMIT ME TREGUESIN E PERFORMANCËS SË PËRDORIMIT TË UJIT NË SECILIN SEGMENT PERFORMANCE PËRQINDJEJE PREJ 20% ME KALIMIN E KOHËS<sup>21</sup>



BURIMI: PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA IBNET / DANUBIS ORG DATA




**FIGURA 45:** KONVERGJENCA E FITIMEVE TË ULËTA DHE TË LARTA ME KALIMIN E KOHËS

BURIMI: PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA IBNET / DANUBIS ORG DATA

94. **Kompanitë që kanë performancë më të mirë gjithashtu kanë përgjithësisht tarifa më të larta.** Një kontroll i rastësishëm i performancës së kompanisë krahasuar me të ardhurat mesatare për lidhje (marrë në vend të tarifës mesatare) tregon një shpërndarje të madhe (Figura 46), ku shtetet e BE-së kanë performancë më të mirë dhe kompanitë në vendet që nuk janë në BE kanë të ardhura më të larta tarifore për lidhje (në terma PPP) se sa kompanive të vendet kandidate për në BE. Megjithatë, në përgjithësi, Figura 46 dhe analiza për të tregojnë se kompanitë që tregojnë performancë më të mirë kanë gjithashtu prirjen të kenë tarifa më të larta. Me fjalë të tjera, cilësia ka koston e saj, dhe veçanërisht tregohet se asnjë kompani me performancë të lartë nuk ofron në të njëjtën kohë tarifa të ulëta (pjesa e poshtme djathtas në figurë). Në të kundërt ama, ka shumë kompani me performancë të dobët me tarifa relativisht të larta, që duhet të ngrenë pyetje nga ata që kërkojnë përgjegjësi


21 Figura mbulon vetëm vitet 2000-2007, sepse është periudha me të dhëna më të qëndrueshme në IBNET/DANUBIS. Duke qenë se pas vitit 2007 nuk ka të dhëna për Hungarinë dhe Ukrainën, rezultatet në nivel rajonal në këtë pikë tregojnë pavijueshmëri.

**FIGURA 46:** PERFORMANCA E FITIMEVE NË RAJONIN E DANUBIT DHE LIDHJA E TYRE ME NIVELIN E TARIFËS



BURIMI: PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA IBNET / DANUBIS.ORG DATA.

**FIGURA 47:** PERFORMANCA MESATARE E FITIMIT NGA SASIA E PËRDORIMIT



BURIMI: PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA IBNET / DANUBIS.ORG DATA.





prej tyre<sup>22</sup>. Një shqyrtim më i detajuar i të dhënave tregon se kompanitë me mbulim më të madh me shërbim dhe me cilësi më të lartë (dy kategoritë e para të pikave të WUPI) prirën të kenë tarifa më të larta, ndërsa kompanitë me praktika më të mira administrative (kategoria e fundit e pikave të WUPI) prirën të kenë tarifa më të ulëta (Tabela 10). Por nuk është për t'u habitur se kursimet nga praktikatat e përmirësuara të administrimit nuk janë të mjaftueshme për të kompensuar të ardhurat më të larta të nevojshme për qëndrueshmërinë e shërbimeve më të mira dhe përmirësimi i përgjithshëm i 10 pikave në pikëzimin e WUPI lidhet me një rritje tarife prej 6.7 përqind (Tabela 10).

**95. Në nivel vendi, shtytsat për performancën e kompanive duket se janë jashtë vetë sektorit.** Një analizë sistematike ekonometrike e performancës së kompanive në lidhje me një sërë shtytsash të jashtme nxjerr në pah përfundime jo të njëtrajtshme. Shumica e ndryshimit në performancë në kampion mund të shpjegohet nga konteksti i vendit, që është më së shumti jashtë ndikimit të politikë bërësve të sektorit. Me fjalë të tjera, disa vende (Austria, për shembull) thjesht ofron kushte më të mira për suksesin e kompanive se sa vende të tjera. Ndryshimet më specifike në politika, si krijimi i një kuadri rregullator formal apo procesi i hyrjes dhe anëtarësimit në BE, nuk mund të dalin nga grupi i të dhënave dhe të tregojnë një ndikim të qartë afat shkurtër mbi performancën e kompanive. Megjithatë, kjo vjen më së shumti nga kufizime në lidhje me të dhënat e disponueshme dhe nuk mund të merret për bazë për rekomandime politikash. Gjithsesi, reforma të tilla kërkojnë shumë më tepër kohë për të treguar ndikimin se sa grupi i të dhënave në bazën e të dhënave.

**TABELA 10: NDIKIMI IRRITJES SË PERFORMANCËS MBI TARIFAT**

Rritje me 10 pikë në pikëzim për...	Sjell ndryshim tarife prej...
Pikëzimin e përgjithshëm WUPI	+ 6.7%
Mbulim me shërbim	+ 5.6%
Cilësi shërbimi	+ 2.2%
Efikasitet administrimi	- 2.2%

BURIMI: Mbledhja e të dhënave SOS

**96. Megjithatë, në nivelin e kompanive, vihen re disa shtytsa të qarta performance si madhësia dhe densiteti, por këto janë të vështira për të përkthyer në rekomandime konkrete për politika.** Modelet e drejtimit të kompanive kanë prirjen të jenë relativisht të ngjashme për shumicën e kompanive komunale brenda një vendi dhe brenda një spektri madhësie. Si rrjedhojë, grupi i të dhënave, nuk lejon përfundime mbi llojin e modelit të drejtimit që mund të sjellë rezultate më të mira. Analiza konfirmon ama, se sektori i ujit, si shumë të tjerë, është i lidhur me ekonomitë e shkallës dhe kompanitë që janë më të mëdha dhe / ose shërbejnë zona më të dendura kanë më shumë gjasa të kenë një performancë më të mirë dhe kosto më të ulëta se kolegët e tyre, nëse të gjitha gjërat e tjera janë të barabarta (Figura 47). Megjithatë, është e rëndësishme të merret parasysh fakti se këto përfitime nuk mund të arrihen lehtë nëpërmjet ndryshimit të politikave të sektorit. Densiteti apo madhësia e një qyteti janë jashtë ndikimit të politikë bërësve të sektorit dhe thjeshtë bashkimit të disa operatorëve në operatorë më të mëdhenj nuk sjell të njëjtat rezultate të qarta (shihni paragrafin më poshtë).

**97. Ndikimi i proceseve të rajonalizimit apo grumbullimit mbi performancën dhe koston e kompanive nuk është qartësisht pozitiv, dhe politikë bërësit duhet të hulumtojnë me kujdes rrethanat e veçanta të vendit të tyre përpara se të promovojnë procese të tilla.** Në përpjekje për të arritur ekonominë e shkallës dhe për të siguruar ofrues shërbimesh më profesionist dhe më të qëndrueshëm financiarisht, disa vende po i kthehen grumbullimit apo rajonalizimit të ofruesve të shërbimeve (shihni Seksionin A në Kapitullin III për më shumë detaje). Analiza e grupit të të dhënave, bazuar në qasjen rigoroze 'ndryshimi në ndryshime' (Klien 2015), nuk lejon nxjerrjen e përfundimeve të përgjithshme dhe çdo vend duhet të analizojë protë dhe kundrat e një procesi rajonalizimi. Në të kundërt të opinioneve të përgjithshme në lidhje me ndikimin pozitiv të proceseve të rajonalizimit apo grumbullimit mbi performancën dhe koston e përgjithshme, analiza ofron një sërë shembujsh kundërshtues, për shembull që:

- ▶ Kompanitë e grumbulluara kanë performancë mesatarisht vetëm pak më të mirë se kompani të ngjashme që nuk i janë nënshtruar procesit të grumbullimit. Ndikimi më pozitiv ndodh në performancën e administratës, ndërsa

<sup>22</sup> Rezultatet e veçanta për kompani të veçanta mund të merren nga DANUBIS.org duke përdorur raportin e performancës së kompanive komunale.

cilësia e shërbimit nuk ndikohet, ndërsa mbulimi ndikohet negativisht<sup>23</sup>. Ndikimi faktik i përgjithshëm varet nga tiparet e kompanive të bashkuara (madhësia, performanca) dhe nga procesi i bashkimit në vetvete (numri i kompanive të bashkuara, rritja e përgjithshme e përmasave).

- ▶ Proceset e grumbullimit që përfshijnë më pak kompani dhe që krijojnë zona shërbimi më të dendura ofrojnë përfitime pozitive, ndërsa grumbullimet me numër të madh kompanish dhe fitime të kufizuara në dendësi apo popullatë të shërbyer priren të kenë ndikime negative mbi performancën dhe kostot e përgjithshme.
- ▶ Kompanitë më të vogla që bashkohen apo grumbullohet kanë përfitime më të mëdha (sa i përket kostove dhe performancës) nga bashkimi se sa kompanitë e mëdha, çka tregon se ekonomitë e shkallës nuk janë lineare dhe se kompanitë e mëdha nuk mund të presin të përmirësojnë performancën e tyre më tej apo të ulin kostot duke u zmadhuar më tepër.
- ▶ Efektet e procesit të grumbullimit janë më të theksuara në vitet e para pas bashkimit dhe priren të zbehen me kalimin e kohës.

---

<sup>23</sup> Kjo ka gjasa, sepse sistemet e tjera të grumbulluara kanë nivele më të ulëta mbulimi se sa kryesori.



## VI. FINANCIMI I SHËRBIMEVE

98. **Kostot në rritje kanë sjellë rritje të tarifave në të gjithë rajonin, deri në atë pikë sa shërbimet mund të bëhen të papërbalueshme për klientët me të ardhura të ulëta në disa vende, por ama rajoni është akoma larg realizimit të parimit të rikuperimit të kostos të Direktivës së Kuadrit të Ujit (WDF).** Vendet në rajon kanë ndërmarrë qasje të ndryshme ndaj financimit të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura. Qasja ndaj strukturës së kostos dhe çmimeve ndryshon gjithashtu gjerësisht nga vendi në vend. Megjithatë, e përbashkëta e shumicës së vendeve lidhet me rritjet mbi inflacionin si të kostove ashtu edhe tarifave, si dhe niveleve të konsiderueshme të subvencioneve për investime dhe disi më pak të kostove operative.

99. Ky kapitull përshkruan prirjet kryesore që lidhen me burimet e financimit dhe shpenzimet, rikuperimin e kostos dhe përbalueshmërinë e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura në të gjithë rajonin. Për sa i përket burimeve të financimit, kapitulli përdor kuadrin e OECD-së 'Tre T' (shih kutinë). Megjithatë, informacioni i qëndrueshëm mbi këta faktorë është i pakët dhe krahasimet janë të vështira. Si rrjedhojë, shifrat e paraqitura në këtë kapitull duhet të shihen si treguese të prirjeve të përgjithshme më shumë se sa informacione të sakta mbi financimin e sektorit në secilin vend. Për më tepër, shifrat ndjekin vetëm anën publike të ofrimit të shërbimit. Investimet private nga familjet apo komunitetet dhe tarifatat që i paguhen ofruesve informale vendorë, as nuk gjurmohen dhe as nuk përfshihen në panoramën e përgjithshme të financimit të sektorit.

### Kuadri Tre T i OECD-së


Në vitin 2009, nëpërmjet një kontributi në Forumin e pestë botëror të ujit, OECD-ja propozoi një kuadër të përgjithshëm mbi mënyrën e financimit të shërbimeve të ujit (OECD 2009). Ky kuadër që përdoret edhe në këtë raport, përcakton se "planifikimi efikas financiar për sektorin e ujit kërkon gjetjen e përzjerjes së saktë të të ardhurave nga të ashtuquajturat '3 T': tarifatat, tatimet dhe transfertat (përfshirë grantet zyrtare të asistencës së zhvillimit). Këto janë burimet e qenësishme të të ardhurave në sektor. [...] Burime të tjera financimi, si huatë (përfshirë huatë ODA nga donatorë dypalësh apo institucione financiare ndërkombëtare) bonot dhe investitorët private [...] duhet të ripaguhen përmes një kombinimi të 3 T-ve".

100. Shumica e informacionit të mbledhur vjen nga një përpjekje vend më vend ndërmarrë në kuadrin e këtij vlerësimi për të mbledhur të dhënat e disponueshme publike mbi financimin e sektorit (përmendur si mbledhja e të dhënave SoS), që më pas u përmbledh në një model të thjeshtuar të financimit të sektori për secilin vend. Për më tepër, pjesa mbi përbalueshmërinë ka marrë informacion nga anketimet e familjeve të përdorura në Kapitullin IV për të matur aksesin. Metodologjia dhe supozimet e nevojshme për këtë kapitull janë përshkruar shkurtimisht në Shënimet Metodologjike C (financimi i përgjithshëm i sektorit) dhe D (përlogaritjet e përbalueshmërisë), në fund të dokumentit.

## A. Burimet e Financimit: Tarifatat, Tatimet dhe Transfertat

101. **Niveli i financimit të sektorit nga tarifatat, tatimet dhe transfertat ndryshon shumë nga vendi në vend, dhe shtetet anëtare të BE-së paraqesin financime më të larta për frymë.** Disponueshmëria e të dhënave mbi financimin e sektorit është e paqëndrueshme në disa vende, por një analizë e të dhënave publike nga një llojshmëri burimesh kombëtare dhe ndërkombëtare flet për ndryshime të mëdha nga njëri vend në tjetrin, ku shtetet anëtare të BE-së paraqesin nivelet të më

FIGURA 48: SEKTORI FINANCIAR NDËRMJET VENDEVE TË RAJONIT PËR FRYMË DHE PËRQINDJA E PBB




BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS



larta të financimit për frymë, duke marrë në konsideratë të gjitha burimet (Figura 48). Shumica e vendeve janë gjithashtu në kufijtë e poshtëm të vlerës së pranuar përgjithësisht për financimin e përgjithshëm të sektorit prej 0.35 deri në 1-20 përqind të PBB-së (vendet me të ardhura të larta), 0.54 deri në 2.50 përqind të PBB-së (vendet me të ardhura mesatare), ose 0.70 deri në 5.30 përqind të PBB-së (vendet me të ardhura të ulëta) (OECD 2006).

**102. Struktura e financimit të shërbimeve në rajon ndryshon shumë nga vendi në vend, por investimet përgjithësisht mbështeten në fonde publike dhe transfertat të jashtme, ndërsa shpenzimet operative mbulojnë përgjithësisht nga të ardhurat tarifore të kompanive.** Pjesa e financimit të përgjithshëm të sektorit që vjen nga transfertat është zakonisht më e madhe për vendet e reja anëtare të BE-së për shkak të ndikimit të fuqishëm financiar të fondeve të BE-së, kurse nga ana tjetër, për shumë prej tyre, pjesa e financuar nga tarifat është relativisht e ulët. Kjo është një gjetje interesante nga pikëpamja e kërkesës së WDF-së për rikuperimin e kostos (Figura 49). Pjesa e financimit që vjen nga tatimet, qofshin investime të drejtpërdrejta apo subvencione për veprimtarinë, apo përmes rimbursimit të angazhimeve të institucioneve ndërkombëtare financiare dhe huave të tjera, është relativisht e qëndrueshme midis 10 dhe 20 përqind në të gjitha vendet, dhe kjo përbën rreth 0.1% të PBB-së. Në këtë rast përjashtimi i konsiderueshëm është Mali i Zi dhe diku më pak Shqipëria dhe Kosova. Në të kundërt nga rajonet e tjera, shpenzimet e sektorit të ujit nuk përbëjnë një barrë të konsiderueshme fiskale për shumicën e qeverive kombëtare, që mbështeten më shumë nga transfertat e rastit (në shumicën e rasteve nga BE-ja) dhe tarifat si instrumentet kryesore për rikuperimin e kostove në sektor. Kjo gjetje është në përputhje me rolin e fuqishëm të luajtur nga qeverisja vendore në ofrimin e shërbimeve, paraqitur në Kapitullin III, dhe tregon ndikimin e kufizuar që qeveritë kombëtare kanë mbi sektorin.

**FIGURA 49: PROPORCIONI I FINANCIMIT TË SEKTORIT NGA TARIFAT, TAKSAT DHE TRANSFERTAT NË VENDET E RAJONIT TË DANUBIT**



PËRPUNIMI NGA AUTORËT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS

**103. Me gjithë përfshirjen e gjerë të parimit të rikuperimit të kostos në legjislacionin kombëtar, vetëm dy vende, ai më i pasuri dhe ai më i varfri, mbështeten tek tarifat për të financuar rreth 90% të sektorit.** Siç tregohet në Tabelën 11, shumica dërrmuese e vendeve në rajon e kanë përfshirë parimin e rikuperimit të kostos në legjislacionin e tyre kombëtar. Megjithatë, në realitet gjërat janë ndryshe. Në Austri dhe Moldavi, mungesa e fondeve të BE-së dhe hapësira e kufizuar fiskale kanë sjellë një financim të sektorit nga tarifat në masën thuajse 90%. Në shumicën e vendeve të tjera, tatimet dhe transfertat përfaqësojnë midis 25 dhe 75 përqind të financimit të përgjithshëm të sektorit, që për sa kohë aksesi dhe konsumi janë relativisht të barabartë, do të thotë se subvencionet janë të shpërndara në mënyrë të barabartë ose se të ardhurat janë neutrale. Aja, kjo mbështetje financiare kthehet në një shpenzim publik regresiv kur aksesi në shërbime publike nuk është i barabartë, kështu që vetëm ata me shërbime publike po marrin përfitimet e atyre shpenzimeve publike. Duke qenë se familjet më të pasura përdorin zakonisht më shumë ujë (duke qenë se kanë më shumë elektroshtëpiake, si lavatriçe apo pjatararëse), edhe konsumi është rrallë i barabartë, dhe si rrjedhojë shpenzimet publike arrijnë në mënyrë jo të barabartë në familjet me konsum më të lartë. Në të kundërt kur shpenzimet publike janë të drejtuara të trajtojnë hendeqet ekzistuese në akses apo kufizimet e përballeshmërisë (të gjitha do të diskutohen në vijim), shpenzime të tilla mund të bëhen më progresive.

**104. Pak vende kanë hartuar mekanizma të përkushtuar për financimin e sektorit të ujit që ofrojnë financime të parashikueshme.** Në shumicën e vendeve, investimet bëhen nëpërmjet transfertave të jashtme ose hua nga institucionet ndërkombëtare financiare sipas rastit, të shlyera nga buxheti i shtetit apo i qeverisjes vendore. Ndërkohë që shumë vende




financojnë pjesërisht investimet e sektorëve të tyre nga buxhetet e tyre kombëtare, rreth një e treta e vendeve kanë një mekanizëm të përkushtuar për të financuar investimet (Tabela 11), që garanton financim më të parashikueshëm. Një shembull i tillë është Kroacia ku tarifat për të drejtat e nxjerrjes së ujit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura administrohen nga agjencia kombëtare e ujit dhe ku këto tarifa financojnë 70 milion Euro investime vjetore (shih Tabelën 4 në Kapitullin III për më shumë detaje). Megjithatë, edhe në vende me skema të tilla, vendimet për përdorimin e fondeve shpesh janë disi arbitrare dhe nuk lidhen domosdoshmërisht drejtpërsëdrejti me politikat dhe strategjitë e sektorit. Nuk është habi që në të gjitha vendet e BE-së dhe në vendet më të zhvilluara kandidate, fondet e BE-së (Fondet e Kohezionit, Fondet e Politikave Rajonale, Fondet e Instrumentit të Para Anëtarësimit [IPA]) përfaqësojnë financimin më të madh të huaj në sektor, ndërsa në vendet e tjera, institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët dypalësh vijnë të luajnë rolin kryesor.

**TABELA 11: TIPARET KRYESORE TË FINANCIMIT TË SEKTORIT NË RAJONIN E DANUBIT**

	Politikë të rikuperimit të kostos?	Mekanizëm për drejtimin e investimeve	Burimi kryesor kombëtar i financimit	Burimet kryesore ndërkombëtare të financimit
Shqipëria	Po	Bazuar në nevoja dhe performancë	Buxheti i shtetit	Fonde dypalëshe
Austria	Po	Bazuar në nevoja	Fond i përkushtuar (i bllokuar)	Nuk mundësohet
Bosnje Hercegovina	Jo		Fond i përkushtuar (i bllokuar)	Hua nga IFN
Bullgaria	Po	Sipas rastit	Fond i përkushtuar (i bllokuar)	Fonde nga BE
Kroacia	Po	Bazuar në nevoja	Fond i përkushtuar (i bllokuar)	Fonde nga BE
Republika Çeke	Po	Bazuar në performancë	Fond i përkushtuar (i bllokuar)	Fonde nga BE
Hungaria	Po	Bazuar në nevoja	Buxheti i shtetit	Fonde nga BE
Kosova	Po	Bazuar në nevoja	Buxheti i shtetit	Fonde dypalëshe
Maqedonia	Po	Bazuar në nevoja	Buxheti i shtetit	Hua IFN
Moldavia	Jo	Vjen i pari, merr i pari	Buxheti i shtetit	Grante / kredi IFN
Mali i Zi	Jo	Tjetër	Buxheti i shtetit	Fonde nga BE
Rumania	Po	Vjen i pari, merr i pari	Buxheti i shtetit	Fonde nga BE
Serbia	Jo	Bazuar në nevoja	Buxheti i shtetit	Nuk mundësohet
Sllovakia	Po		Buxheti i shtetit	Fonde nga BE
Sllovenia	Po	Sipas rastit	Fond i përkushtuar (i bllokuar)	Fonde nga BE
Ukraina	Po	Sipas rastit	Buxheti i shtetit	Hua IFN

BURIMI: MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS

**FIGURA 50: PRIRJET DHE BURIMET KRYESORE TË FINANCIMIT TË JASHTËM PËR INVESTIMET NË UJË DHE UJËRA TË NDOTURA**




24 Shkalla e thithjes së fondeve specifike për ujin nga BE supozohet se ndjek të njëjtën prirje si për thithjen e fondeve të përgjithshme nga BE në një vend të caktuar, Megjithëse prova të pakonfirmuara tregojnë se thithja e fondeve në sektorin e ujit është më e ulët se mesatarja.

**105. Aktualisht fondet e BE-së përbëjnë një pjesë të madhe të financimeve të huaja në rajon dhe kanë lënë prapa huadhënësit tradicionalë.** Megjithëse është e vështirë të përftohet një panoramë e saktë e përgjithshme e rrjedhës së investimeve në rajon, një analizë e të dhënave të OECD-së dhe BE-së tregon se investimet e përgjithshme të huaja janë rritur gjatë 15 viteve të fundit (Figura 50). Shumica e rritjes vjen si pasojë e fondeve të BE-së, që janë të disponueshme në 8 nga 15 vendet e rajonit dhe këto fonde nga lënë disi prapa në vlerë disa nga huadhënësit tradicionalë si institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët dypalësh, që po ofronin nivele të larta financimi veçanërisht në vendet e Ballkanit Perëndimor pas konflikteve të viteve '90, por që gradualisht janë larguar me rritjen në rëndësi të fondeve të BE-së dhe fondeve IPA. Një krahasim i informacionit publik të disponueshëm rreth fondeve të BE-së që shkojnë për sektorin dhe investimeve faktike tregon ama, se në shumicën e vendeve të BE-së fondet e BE-së përfaqësojnë vetëm një pjesë të kufizuar të investimeve të përgjithshme, që shkon nga rreth 10% në Republikën Çeke (ku sektori privat thith shumicën e nevojave) në 30% në Rumani, e deri në nivele shumë më të larta prej 50% në Bullgari.

## B. Shpenzimet e Shërbimeve: Kostot e Operimit dhe Investimeve

**106. Mesatarisht sektori drejton rreth gjysmën e të gjitha shpenzimeve drejt operimit dhe mirëmbajtjes (O&M) të infrastrukturës dhe gjysmën tjetër drejt rinovimit dhe zgjerimit të saj.** Figura 51 tregon pjesën e kostove të përgjithshme që shkojnë për O&M dhe për investime në vendet e rajonit. Ka ndryshime me rëndësi midis vendeve ku pjesa e kostove të përgjithshme që përdoret për investime ndryshon midis një të tretave dhe dy të tretave. Mbivendosja e niveleve të investimit (si përqindje e PBB-së) në të njëjtën figurë, tregon logjikisht se vendet që kanë shpenzime të larta për O&M janë gjithashtu vendet që shpenzojnë më pak për investime në përgjithësi, duke sjellë kështu shqetësime të mundshme në lidhje me qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimit. Në ato vende për të cilat ka të dhëna të disponueshme, investimet në ujërat e ndotura janë një përparësi, një pasqyrim ky i hendeqeve në nivelin e shërbimeve krahasuar me shërbimet e ujësjellësit (Kapitulli IV). Për më tepër, pjesa e konsiderueshme e burimeve të sektorit që shkon për investime tregon rëndësinë e administrimit dhe zhvillimit të kujdesshëm të aseteve dhe aplikimit të parimeve të efikasitetit jo vetëm për operimin e kompanive komunale të ujit, por edhe për planifikimin dhe zbatimin e projekteve të investimit. Në këtë pikëpamje, nivelet veçanërisht të ulëta të investimit (si përqindje e PBB-së) në vende si Moldavia, Serbia dhe Ukraina, dhe në shkallë më të vogël Hungaria, duhet të ngrenë shqetësime mbi faktin nëse asetet po administrohen dhe mirëmbahen siç duhet për periudhën afatgjatë, apo nëse tarifat po mbahen të ulëta artificialisht duke mbijetuar në sajë të aseteve, që në vetvete do të sjellë si përfundim një ulje të cilësisë së shërbimit.

**FIGURA 51: SHPËRNDARJA E SHPENZIMEVE TË PËRGJITHSHME QË SHKOJNË DREJT O&M DHE INVESTIMEVE**



PËRPUNIMI NGA AUTORËT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS.


**107. Investimet totale në ujë dhe ujëra të ndotura në rajon janë rreth 3.5 miliard USD në vit, konsiderueshëm më pak se vlerësimi prej 5.5 miliard USD përlogaritur nga qeveritë e rajonit si i nevojshëm për të arritur synimet e BE-së apo ato kombëtare.** Qeveritë ose financiarët e jashtëm në shumicën e vendeve kanë vlerësuar vlerat e nevojshme për të arritur synimet e secilit vend ose për të qenë në përputhshmëri me acquis e BE-së dhe shumatorja e vlerësimeve kombëtare ka vlerën e 5.5 miliard USD investime të nevojshme çdo vit. Nivelet faktike të investimit janë



rreth 55% e këtij niveli, duke lënë të hapur një hendek prej më shumë se 2 miliard USD në vit (Figura 52). Në përgjithësi, rreth 40% e nevojave për investime janë të drejtuara për nga shërbimet e ujësjellësit dhe për nga përputhshmëria me Direktivën e Ujit të Pijshëm, ndërsa 50% janë për administrimin e ujërave të ndotura dhe përputhshmërinë me Direktivën e Trajtimin të Ujërave të Ndotura Urbane (shih Seksionin B në Kapitullin III për më shumë detaje mbi të dy direktivat, dhe Kapitullin IV për një diskutim mbi hendeqet në infrastrukturë). Për më tepër, një shqyrtim vend më vend mbi projeksionin e nevojave për investime dhe investimet aktuale (Figura 52), tregon se:

- ▶ Shumica e vendeve parashikojnë nevoja më të larta për investime se nivelet e tyre aktuale të investimit, vetëm Republika Çeke ka nivele investimi përgjithësisht në të njëjtin nivel me projeksionet e saj.
- ▶ Vendet anëtare dhe kandidatë të BE-së parashikojnë nevoja më të larta investimesh se sa vendet që nuk janë anëtare të BE-së. Edhe Austria, ku aksesin në shërbime të ujërave të ndotura është i lartë tashmë, parashikon nevoja të konsiderueshme për investime, kryesisht si rrjedhojë e nevojës për të rinovuar asetet e ndërtuara gjatë valës së parë të investimeve në ujëra të ndotura, rreth 30 vjet më parë.
- ▶ Anëtarët më të vonshëm të BE-së si Bullgaria veçanërisht, kanë akoma vështirësi me thithjen e efikasë të fondeve të BE-së dhe pasqyrojnë hendeqe të konsiderueshme në financim.
- ▶ Shumica e vendeve jashtë BE-së kanë nivele shumë më të ulëta investimesh dhe përgjithësisht nuk i mbulojnë nevojat e tyre për momentin.

**FIGURA 52: KOSTOT E INVESTIMIT AKTUAL KRAHASUAR ME ATO TË NEVOJSHME PËR FRYMË NË VENDET E RAJONIT**




PËRPUNIMI NGA AUTORËT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS.

## C. Rikuperimi i Kostos: Prirjet e Kostove dhe Tarifave


108. **Kostot e ofrimit të shërbimeve ndryshojnë gjerësisht nga vendi në vend, por gjatë 20 viteve të fundit janë rritur konsiderueshëm, duke sjellë një rritje paralele të tarifave.** Kapitujt mbi aksesin në shërbime (Kapitulli IV) dhe performancën e përgjithshme të kompanive komunale (Kapitulli V) treguan si është përmirësuar performanca e përgjithshme e sektorit në lidhje me mbulimin dhe cilësinë e shërbimeve gjatë 20 viteve të fundit. Investimet e nevojshme, veçanërisht për zgjerimin e largimit dhe trajtimin të ujërave të ndotura, janë në të njëjtin nivel me rritjet e konsiderueshme të shpenzimeve operative. Figura 53 tregon evolucionin e kostove të operimit në një kampion të kompanive të ujit dhe të ujërave të ndotura, duke treguar rritje në shumë vende, veçanërisht shtete anëtare të BE-së, që shkojnë përtej 100% të PPP së pandryshueshme. Figura 54 tregon se si kompanive i është nevojitur të rrisin të ardhurat e tyre me ritëm pothuajse të njëjtë, kryesisht përmes rritjes së tarifave. Me gjithë uljen e konsumit, të ardhurat e para-lidhjeve u rritën çdo vit me më shumë se 10% (në terma realë) në kompanitë e shteteve të reja të BE-së, si

Republika Çeke dhe Rumania, dhe disi më pak Hungaria. Edhe në vendet jashtë BE-së si Kosova, Moldavia dhe Ukraina, rritjet e të ardhurave të kompanive ishin mesatarisht 5% në vit në terma realë në rastet që u vëzhguan për periudha të qëndrueshme kohe. Këto rritje të vazhdueshme mund të sjellin kufizime serioze të përballeshmërisë në mungesën e rritjes së qëndrueshme dhe me bazë të gjerë të ekonomisë, siç do të diskutohet në Seksionin D të këtij Kapitulli.

**FIGURA 53:** EVOLUIMI I KOSTOVE OPERATIVE PËR NJËSI UJI TË PIJSHËM DHE KANALIZIMESH NË OFRUESIT/VENDET E PËRZGJEDHURA




**FIGURA 54:** EVOLUIMI I FATURËS VJETORE PËR NJËSI UJI TË PIJSHËM DHE KANALIZIMESH NË OFRUESIT/VENDET E PËRZGJEDHURA



BURIMI: TË DHËNA NGA IBNET / DANUBIS.ORG

109. **Përgjithësisht si kostot O&M ashtu edhe tarifat rezidenciale ndjekin nivelin e zhvillimit ekonomik në vend dhe kostot dhe tarifat më të larta vërehen në vendet e BE-së.** Siç tregon edhe Figura 55, ka një marrëdhënie relativisht të ngushtë midis kostove O&M dhe niveleve të tarifave rezidenciale. Austria tregon qartë kostot dhe tarifat më të larta, ndjekur nga të gjitha vendet e BE-së, përveç Bullgarisë ku niveli i kostove dhe tarifave është konsiderueshëm më i ulët se ai në vendet e tjera të BE-së. Në të kundërt, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë nivele tarifash shumë më të ulëta se mesatarja rajonale, pavarësisht faktit se përballeshmëria përgjithësisht nuk është kufizim, siç do të diskutohet edhe në seksionin D të këtij Kapitulli.

**FIGURA 55:** KOSTOT O&M DHE TARIFAT REZIDENCIALE (UJI I PIJSHËM DHE UJËRAT E NDOTURA) NË VENDET E RAJONIT




PËRPUNIMI NGA AUTORËT BAZUAR NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS.





**110. Rikuperimi i plotë i kostos nga tarifat nuk duket të jetë përparësi në asnjë prej vendeve, dhe shumë kompani në rajon nuk mbulojnë as kostot e tyre të operimit nga të ardhurat e faturuara.** Për të mirëmbajtur cilësinë e shërbimit në periudhën afatgjatë, kompanitë duhet të jenë të afta të rikuperojnë kostot e tyre të operimit dhe të mirëmbajtjeve të rregullta, si dhe ato të nevojshme për administrimin dhe rinovimin e asetëve nga të ardhurat e tyre. Figura 56 paraqet mbulimin mesatar të kostove të operimit të kompanive në rajon, matur nga shitjet e faturuara neto duke hequr shpenzimet e operimit, përfshirë zhvlerësimin. Kompanitë duhet të kenë një mbulim të kostove të operimit mbi 1 për të qenë financiarisht të vetë qëndrueshme në lidhje me O&M. Siç tregon edhe figura, vetëm në pak vende kompanitë rikuperojnë të gjitha kostot e tyre të operimit nga të ardhurat e tyre. Ndërkohë që mesatarja për shtetet anëtare të BE-së është mbi 1, disa vende të BE-së si Bullgaria, Hungaria (ku ka kontroll të fortë të tarifave) dhe Rumania, që formalisht i nënshtrohen kërkesës së WDF-së së BE-së për rikuperimin e kostos, nuk duket se janë në përputhje të plotë. Situata e përgjithshme nuk është tepër pozitive, sidomos nëse merret në konsideratë që kompanitë në një sërë vendesh nuk arrijnë të mbledhin një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të faturuara (shih Figurën 41), dhe si rrjedhojë aftësia faktike e kompanive për të financuar vetveten është akoma më e vogël (shpesh nxirren dispozita për përjashtimin e llogarive hyrëse).

**FIGURA 56: MBULIMI I KOSTOS OPERATIVE NË VENDET E RAJONIT (TË ARDHURAT OPERATIVE TË FATURUARA/KOSTOT OPERATIVE)**



PËRPUNIMI NGA AUTORËT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS.


SHËNIM: VLERA DUKSHËM SHUMË E LARTË PËR KOSOVËN DUHET PARË DUKE PASUR PARASYSH SE KOSOVA KA NJË NGA RAPORTET MË TË ULËTA TË MBLEDHJES NË RAJON, DHE PRANDAJ TË ARDHURAT E MBLEDHURA JANË DUKSHËM POSHTË TË ARDHURAVE TË FATURUARA, QË PËRDOREN PËR TË LLOGARITUR KËTË TREGUES.

## D. Trajtimi i Përballeshmërisë

**111. Megjithëse tarifat janë rritur gjatë dekadës së fundit, nivelet aktuale janë akoma të përballeshme për konsumatorin mesatar.** Siç u nënvizua edhe në Seksionin C të këtij kapitulli, tarifat reale janë rritur me 5 deri në 10% në vit gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, por qartësisht po kështu janë rritur edhe të ardhurat e shpenzueshme të popullatës. Përlllogaritja e shpenzimeve të raportuara për ujë dhe ujëra të ndotura si pjesë e të ardhurave për grupe me të ardhura të ndryshme tregon se shpenzimi mesatar është goxha poshtë kufirit prej 5%,<sup>25</sup> dhe nivelet më të larta prej 4.4 dhe 4.2 përqind janë vënë re në Ukrainë dhe Rumani përkatësisht. Të dy vendet gjithashtu kanë pjesën më të madhe të familjeve që kanë shpenzime uji dhe ujërash të ndotura mbi 5% (28.8 përqind në Rumani dhe 32.5 përqind në Ukrainë).

<sup>25</sup> Institucione të ndryshme donatore kanë aplikuar kufij të ndryshëm për të vlerësuar kufizimet e përballeshmërisë së shërbimeve të ndryshme komunale, përfshirë ngrohjen me energji elektrike, uji dhe ujërat e ndotura. Një panoramë e shkëlqyer e këtyre kufijve jepet nga Fankhauser dhe Tepic 2005, 5. Për ujin dhe ujërat e ndotura, kufiri 3 deri në 5 përqind i të ardhurave të plota përdoret zakonisht për të vlerësuar kufizimet e përballeshmërisë.


**FIGURA 57: TARI FAT AKTUALE TË PËRBALLUESHMËRISË SË UJIT TË PIJSHËM DHE UJIT TË NDOTUR NGA GRUPET E NDRYSHME TË TË ARDHURAVE: MESATARJA (PANELI I MAJTË) DHE 40% I POSHTËM (PANELI I DJATHTË)**



BURIMI: PËRPUTIMI NGA AUTORËT NGA ANKETIME NË FAMILJE TË NDRYSHME.  
SHËNIM: SHPËRNDARJA PËR MAQEDONINË DHE MALIN E ZI PËRFSHIN VETËM SHPENZIMET PËR FURNIZIMIN E RAPORTUAR ME UJË.  
HHS=FAMILJET

**112. Vlerësimet e pjesës së shpenzimeve për 40 përqindëshin e poshtëm të popullatës tregojnë një rritje të lehtë, por kufizimet e përballueshmërisë janë mbizotëruese vetëm në Ukrainë.** Atje, më shumë se gjysma e familjeve ndër 40 përqindëshin e poshtëm përballen me një faturë uji dhe ujërash të ndotura më të lartë se 5% e të ardhurave të tyre, dhe personat në këtë grupim të ardhurash paguajnë mesatarisht 5.8% për shërbime uji dhe ujërash të ndotura. Përlogaritja e pjesës së shpenzimeve për të varfrit ekstremë (pra ata që jetojnë me më pak se 2.50 USD në ditë PPP) nxjerr se vetëm Rumania ka statistika të përdorshme (pra një kampion me madhësi të mjaftueshme), sipas të cilave më të varfrit paguajnë 54% të të ardhurave të tyre për shërbime uji dhe ujërash të ndotura. Jo të gjitha vendet kanë anketime familjare që raportojnë shpenzimet për ujë dhe ujëra të ndotura veçmas shpenzimeve të tjera për shërbime komunale apo qira, por ato që kanë anketime të tilla janë të raportuara këtu dhe në Figurën 57.

**FIGURA 58: KUFIZIMET E MUNDSHME TË PËRBALLUESHMËRISË PËR TË ARDHURAT MESATARE**




BURIMI: PËRPUTIMI NGA AUTORËT NGA ANKETIME NË FAMILJE TË NDRYSHME DUKE PËRDORUR SUPOZIME PËR KONSUMIN DHE TARI FËN MESATARE TË OFRUAR NGA MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS.  
SHËNIM: BULLGARIA RAPORTON NJË TARI FË TË KOMBINUAR PËR UJIN E PIJSHËM DHE UJIN E NDOTUR. RËNIET MË TË ULËT TË UKRAINËS PËR FAMILJET ME SHPENZIME TË MUNDSHME TË UJIT MBI 5 PËR QIND MUND TË SHRJEQOHEN NGA DIFERENCA NË KAMPIONE OSE KONSUMIN MË TË ULËT TË SUPOZUAR.



### 113. Kur supozohet se e gjithë popullata do të ishte e lidhur me ujë nga rrjeti dhe shërbime kanalizimesh me nivele minimale konsumi dhe tarifa mbizotëruese, kufizimet në përballeshmëri dalin në pah në Moldavi dhe në Rumani.

Duke përdorur statistika të raportuara nga vendet për tarifën mesatare dhe duke supozuar një konsum minimal por të mjaftueshëm prej 100 litrash për frymë në ditë,<sup>26</sup> shpenzimet për ujë dhe largimin e trajtimin e ujërave të ndotura u përllogaritën për çdo familje, duke marrë parasysh përmasat e familjes dhe të ardhurat sipas raportimit në anketimet e familjeve. Më tej u përllogarit pjesa e shpenzimeve të përllogaritura krahasuar me totalin e të ardhurave familjare, për të kuptuar nëse shpenzimet mesatare për ujësjellës kanalizime, sipas niveleve të të ardhurave të raportuara në anketimet familjare, do të kalonin kufijtë e rekomanduar. Sipas këtyre supozimeve, Moldavia dhe Rumania tregojnë shpenzime për shërbime uji dhe kanalizimesh më të larta se 4 apo 5 përqind e të ardhurave të qytetarit mesatar dhe afërsisht 7 dhe 8 përqind për popullatën në 40 përqindëshin e poshtëm të spektrit të të ardhurave. Për më tepër, 32% e familjeve në Moldavi dhe thuhetse 45% në Rumani do të kishin shpenzime mbi 5%, dhe 100% në Rumani dhe 80% në Moldavi që bëjnë pjesë në 40 përqindëshin e poshtëm të popullatës do të kishin shpenzime më të mëdha se 5% për ujë dhe ujëra të ndotura. Kjo nënkupton se lidhja e popullatave gjerësisht rurale në Moldavi dhe Rumani me ujë nga rrjeti dhe sisteme kanalizimesh, me nivelin aktual të tarifave, nuk do të ishte e përballeshme për segmente të gjera të popullatës. Megjithatë shpenzimet e kombinuara të ujit dhe ujërave të ndotura prej 2.3% të të ardhurave duken të përballeshme për qytetarin mesatar bullgar, thuhetse 50% e familjeve hasin shpenzime mbi 5%, që mund të shpjegohet nga një proporcion i konsiderueshëm me të ardhura të ulëta në shpërndarjen e të ardhurave të vendit (Figura 58 dhe Figura 59).

**FIGURA 59: KUFIZIMET E MUNDSHME TË PËRBALLUESHMERISË PËR 40% E POSHTËM**



BURIMI: PËRPUNIMI NGA AUTORËT NGA ANKETIME NË FAMILJE TË NDRYSHME DUKE PËRDORUR SUPOZIME PËR KONSUMIN DHE TARIFËN MESATARE TË OFRUAR NGA MBLEDHJA E TË DHËNAVE SOS. SHËNIM: BULLGARIA RAPORTON NJË TARIFË TË KOMBINUAR PËR UJIN E PIJSHËM DHE UJIN E NDOTUR.

### 114. Disa vende kanë përcaktuar kufij në nivele shumë më të ulëta se 5% për të identifikuar kufizimet e përballeshmërisë.

Për shembull, Bullgaria ka vendosur një kufi përballeshmërie për shpenzimet e ujit dhe të ujërave të ndotura në nivelin e 4% të të ardhurave mesatare të shpenzueshme të familjeve dhe nëse e gjithë popullata do të ishte e mbuluar sipas supozimeve të paraqitura, 40 përqindëshi i familjeve bullgare do ta preknin këtë kufi. Kroacia përdor 2.5% të të ardhurave mesatare familjare të shpenzueshme, dhe Republika Çeke ka caktuar 2% të të ardhurave mesatare neto familjare si kufi. Sipas këtyre skenarëve, Republika Çeke do ta kalonte pakëz kufirin për fituesin e të ardhurave mesatare dhe akoma më shumë për 40 përqindëshin e poshtëm, por ama konsumi aktual mesatar në Republikën Çeke është gjithashtu më i ulët (88 litra për frymë në ditë) krahasuar me atë që është supozuar si konsum bazë por i mjaftueshëm. Si Maqedonia ashtu edhe Mali i Zi përdorin 5% si kufi dhe nuk do të kishin kufizime në

26 Hoëard dhe Bartram 2003 dallojnë në Tabelën e tyre S1 skenarë me nivele të ndryshme shërbimi, me akses shumë të mirë që nis me konsum prej 100 litra për frymë në ditë.

përballueshmëri as për fituesin mesatar të të ardhurave dhe as për 40 përqindëshin e poshtëm. Bullgaria dhe Republika Çeke gjithashtu përcaktojnë çfarë përbën konsum minimal që përkatësisht është 90 dhe 80 litra për frymë në ditë.

**115. Vetëm Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Sllovenia dhe Ukraina raportojnë se kanë skema formale subvencionimi për të siguruar përballueshmërinë e atyre me të ardhura të ulëta.** Në Ukrainë, skema të ndryshme subvencionimi (familje me të ardhura të përgjithshme të ulëta dhe programet e strehimit dhe shërbimeve komunale) mundësohen për familjet dhe administrohen në nivel qendror të financuara nga buxheti qendror. Subvencionimi i Hungarisë administrohet në qendër, por ndryshe nga Ukraina, subvencionet janë për kompanitë komunale, që megjithëse veprojnë me efikasitet, përballen me kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve (si rrjedhojë e vendndodhjes, ekonomive të shkallës, apo faktorëve të tjerë), dhe subvencionet i kalojnë konsumatorit në formën e tarifave më të ulëta. Në Kroaci subvencionimi përmes tarifimit të grupeve të ndryshme konsumatore përdoret rëndom, kombinuar me identifikimin e familjeve me të ardhura të ulëta që u takon një tarifë më e ulët në shkallën e parë të një tarife që rritet shkallë më shkallë për të siguruar konsum minimal. Konsumi minimal me vlera të subvencionuara përdoret edhe për grupet me të ardhura të ulëta në Maqedoni dhe administrohet në nivel Bashkiak. Siç paraqitet në Seksionin A të këtij kapitulli, në praktikë qeveritë në shumë vendet të Danubit subvencionojnë shërbimet e tyre vendore të ujit dhe sanitare përmes kombinimit të tatimeve dhe transfertave nëse është e nevojshme, edhe pse këto marrëveshje mund të mos jenë të formale apo të kenë një synim.

#### **Performancae subvencionëve**

Zakonisht performanca e mirë e një skeme subvencionimi vlerësohet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- ▶ Mbulimi, në ç'skallë po preken të varfrit
- ▶ Pikësynimi, cila pjesë e subvencionit po i shkon të varfrit
- ▶ Përashikueshmëria e përfitimit për të varfrit
- ▶ Shkalla e çrregullimit të çmimit dhe efekte të tjera anësore nga subvencionimi
- ▶ Thjeshtësia në administrim.

*BURIMI: BANKA BOTËRORE 2000.*

**116. Performanca e skemave të subvencionëve varet në fund të fundit nga përqindja e subvencionit që përfitohet nga familjet që kanë nevojë për këtë subvencion.** Sipas përkufizimit, subvencionet e dhëna përmes ngarkimit të tarifave poshtë koston ose përmes transfertave nga qeverisja vendore në buxhetet e kompanive komunale, nuk janë me pikësynim të drejtpërdrejtë dhe pritet që një pjesë e madhe e subvencionit të shkojë në familje që nuk janë të varfra (të ashtuquajturit "gabime në përfshirje"). Programet me instrumente të testuara, shpesh të zbatuara në kombinim me përpjekje të tjera të mbrojtjes shoqërore, kanë më shumë shanse të arrijnë të varfrit, por vetëm kur kriteret për identifikimin e familjeve të varfra aplikohen me rigorozitet. Shembulli i ndihmesës për familje me të ardhura të ulëta në Ukrainë tregon se performanca e përcaktimit të pikësynimit të këtyre programeve me instrumente të testuara është relativisht e lartë, dhe 20 përqindëshi i poshtëm i fituesve të të ardhurave marrin 78% të subvencionit, por performanca e mbulimit është e ulët, duke qenë se programi nuk arrin 97% të familjeve më të varfra (të ashtuquajturit "gabime në përfshirje"). Në të kundërt, ndihmesa e Ukrainës për strehim dhe shërbime komunale nuk jepet vetëm bazuar në të ardhura, dhe performanca e pikësynimit është e varfër me vetëm 32% të subvencionit të përgjithshëm që arrin në familjet e varfra (Betliy, Movchan dhe Pugachov 2013).




## VII. PËRFUNDIME

117. **Gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur shërbime të qëndrueshme për të gjithë, vendet në rajonin e Danubit kanë arritur nivele shumë të ndryshme progresi, ku niveli i progresit përgjithësisht pasqyron nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit.** Në shumë mënyra, sektori sot është në pozicion më të mirë se sa 15 vite më parë, por qeveritë në rajon do të duhet të vijojnë të harmonizojnë politikat, institucionet dhe mekanizmat e tyre të financimit për të siguruar që mbulimi me shërbim, cilësia dhe efikasiteti i shërbimit të vijojnë të përmirësohen ndërkohë që administrojnë kufizimet e përballueshmërisë. Duhet vëmendje e veçantë për të mbështetur grupet e cënueshme, të varfrit, minoritetet dhe popullatën rurale që edhe ata të kenë akses në shërbime të përballueshme dhe cilësore. Në këtë këndvështrim, procesi i anëtarësimit në BE përbën një mundësi të jashtëzakonshme për të ndikuar drejtimin e sektorit, por kjo mundësi mund të shpërdoret lehtë nëse qeveritë përqendrohen në thithjen e fondeve të BE-së dhe vetëm në përputhshmëri, ose nëse ato nxisin reforma pa konsideruar me kujdes se si reformat trajtojnë sfidat e tyre të veçanta dhe axhendën më të gjerë të qëndrueshmërisë së shërbimeve.

118. **Raporti analizon kapacitetin e vendeve për të dhënë shërbime uji dhe të ujërave të ndotura për të gjithë në lidhje me të katër kategoritë kryesore: aksesin** në shërbime (Kapitulli IV), **cilësinë** e shërbimeve (Kapitulli V), **efikasitetin** i shërbimeve (Kapitulli V), dhe **financimin** i shërbimeve (Kapitulli VI). Në këtë kapitull përmblyllës këto kategori janë të përmbledhura në një vlerësim të përgjithshëm të qëndrueshmërisë së shërbimeve me qëllim nxjerrjen në pah të fushave me sfida të veçanta në secilin vend. Secila nga të katra kategoritë matet përmes tre treguesve të thjeshtë dhe objektivë, që marrin informacionin e tyre nga pjesa tjetër e këtij raporti (Figura 50). Për çdo tregues janë përcaktuar vlerat e praktikës më të mirë duke marrë në konsideratë kompanitë me performancën më të mirë në rajon. Vendet më afër atyre me performancën më të mirë, vlerësohen se kanë shërbime më të qëndrueshme uji<sup>27</sup>. Gjithashtu diskutohen sfidat kryesore të rajonit, ashtu si edhe mundësitë e paraqitura nga situata aktuale. Kapitulli gjithashtu nënvizon fushat me informacion të pamjaftueshëm dhe punën për të ardhmen.

**FIGURA 60: VLERËSIMI I PROGRESIT TË SEKTORIT NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË QËNDRUESHME PËR TË GJITHË**



BURIMI: VLERËSIM I AUTORËVE.

27 Një përshkrim më i plotë i metodologjisë së përdorur për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit është përfshirë në Shënimin Metodologjik E në fund të këtij dokumenti.

**119. Duke patur parasysh kufizimet e të dhënave dhe analizës, politikë bërësit dhe palët e interesit duhet t'i përdorin këto përfundime në dialogun e gjerë për të ekzaminuar në mënyrë më kritike se çfarë rekomandimesh specifike mund të nxirren në kontekstin e tyre të veçantë.** Megjithëse janë bërë të gjitha përpjekjet për të vërtetuar informacionin e paraqitur, një studim që përfshin 16 vende dhe qindra burime informacioni është sfidues në vetvete. Ka mangësi informacioni dhe vetëm periudha të kufizuara kohore, dhe cilësia e informacionit është shumë më e mirë në disa vende krahasuar me vende të tjera. Disa nga burimet e të dhënave mund të mos jenë plotësisht të krahasueshme. Ndërkohë që analiza në nivelin e familjeve është përfaqësuese në nivelin e vendit, të dhënat për kompanitë komunale nuk janë gjithmonë gjithëpërfshirëse. Mesataret kombëtare në disa raste maskojnë heterogjeninë brenda vendit. Për këtë arsye, raporti dhe përfundimet e tij kanë si qëllim të japin informacion për dialogun e politikave në çdo vend në lidhje me përparësitë dhe fushat e punës së mëtejshme, më tepër se sa të ofrojë rekomandime përfundimtare. Paralelisht, ky kapitull identifikon gjithashtu një sërë fushash ku nevojitet më shumë punë për të kuptuar situatën e sektorit dhe për të nxjerrë përfundime të shëndosha.

## A. Qëndrueshmëria e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Ndotura në Rajon

**120. Sektori i ujit është ndikuar fuqishëm nga drejtimi i përgjithshëm i rajonit gjatë 30 viteve të fundit, që prej periudhës socialiste, nëpër periudhën e tranzicionit, dhe në procesin e anëtarësimit në BE.** Ndërkohë që vendet në rajon janë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre, shumica ndajnë një drejtim të ngjashëm drejt integritimit evropian, drejtpërsëdrejti edhe jo drejtpërsëdrejti kushtëzon zhvillimin e shërbimeve të sektorit të ujit. Tabela 12 përmbledh përbërësit kryesorë të këtij evolucioni për sa i përket kontekstit të jashtëm dhe prirjeve kryesore të politikave dhe performancës së shërbimeve, që ndihmon me përcaktimin e një konteksti për përfundimin e përgjithshëm të paraqitur në këtë kapitull.

**TABELA 12: EVOLUCIONI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT**


	Periudha socialiste	Periudha përpara BE-së	Periudha e BE-së
<b>Konteksti i jashtëm</b>	Ekonomi socialiste, drejtuar nga shteti. Sistem politik me një parti.	Faza e hershme e ekonomisë kapitaliste e modelit perëndimor. Sistem politik demokratik shumë partiak.	Ekonomi më e zhvilluar, treg i hapur i BE-së. Sistem politik demokratik shumë partiak. Miratim dhe harmonizim i acquis të BE-së.
<b>Prirjet kryesore të politikave</b>	Ndërmarrje shtetërore / drejtuar nga shteti. Kompani më së shumti të centralizuara. Pa përfshirje nga sektori privat.	Më së shumti ndërmarrje në pronësi të bashkive, ofrim shërbimi i decentralizuar. Përfshirje e konsiderueshme e sektorit privat në disa vende dhe kryeqytete.	Më së shumti kompani bashkiake, me prirjen drejt rajonalizimit. Përfshirje e reduktuar e sektorit privat. Rregullatorë të pavarur të ofrimit të shërbimeve. Aplikimi i parimit të rikuperimit të koston.
<b>Prirjet kryesore të performancës së shërbimeve</b>	Shërbim me kosto të ulët pa theksuar efikasitetin e shërbimeve. Administrimi i ujërave të ndotura mbetet pas ujësjellësit. Prapambetje e mirëmbajtjes dhe investimeve.	Përmirësim i efikasitetit të shërbimeve dhe nivelit të ofrimit të shërbimeve. Rritje e niveleve të investimit financiar nga IFN dhe sektori privat. Rritje e koston së shërbimeve dhe tarifave.	Investimet në shkallë të gjerë financuar nga grantet e BE-së me theks tek ujërat e ndotura. Përmirësim i vazhdueshëm i nivelit të shërbimit dhe efikasitetit. Rritje e vazhdueshme e tarifave të ujit.

BURIMI: VLERËSIM I AUTORËVE.

**121. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së përgjithshme të shërbimeve tregon se ka një hendek të konsiderueshëm midis niveleve të BE-së dhe performancës së vendeve kandidatë dhe vendeve jashtë BE-së, që mund të kërkojë një qasje të ndryshme ndaj anëtarësimit të tyre.** Figura 61 tregon vlerësimet e vlerësimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve, kombinuar sipas grupeve të mëposhtme: vendet e BE-së, vendet kandidatë për anëtarë të BE-së dhe vendet jashtë BE-së, për secilën nga katër kategoritë dhe 12 treguesit e vlerësimit. Është bërë e qartë nga pjesa tjetër e raportit se në rajon ka një llojshmëri të madhe situatash, por figura, edhe një herë thekson hendeqet e rëndësishme midis vendeve të BE-së, vendeve kandidatë dhe vendeve jashtë BE-së. Këto hendeqe, jo vetëm në akses, por edhe në cilësi, efikasitet dhe financim shërbimesh duken të jenë shumë më të gjera se sa hendeqet e hasura nga vendet e reja anëtare të BE-së kur ato u anëtarësuan. Në kontekstin e një përpjekjeje të përgjithshme për anëtarësim në BE, vendim marrësit e të gjitha palëve duhet të marrin në konsideratë nëse kuadrot e kohës, financiare dhe legjislativë që kanë ndihmuar vendet e reja të BE-së



**FIGURA 61: VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SHËRBIMEVE NË RAJON (SA MË I LARTË, AQ MË MIRË)**




BURIMI: PËRPUNIMI NGA AUTORËT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS

122. **Përtej kuadrit të anëtarësimit në BE, vlerësimi tregon gjithashtu se pavarësisht lidhjes së ndërsjellë midis zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve, disa vende duket se kanë performancë më të mirë se sa kolegët e tyre.** Një pjesë e vlerësimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve për vendet e ndryshme krahasuar me nivelin e PBB-së për frymë (Figura 62) tregon një lidhje të qartë midis zhvillimit ekonomik dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve të ujit. Vendet e BE-së kryesojnë rajonin në qëndrueshmëri shërbimesh dhe zhvillim ekonomik me disa përjashtime interesante. Për shembull, Republika Çeke ka performancë shumë më të mirë se Sllovakia dhe Sllovenia me të njëjtin nivel të PBB-së për frymë; në të kundërt Rumania duket se ka sfida më të mëdha se vendet e tjera me të njëjtin nivel të zhvillimit ekonomik, kryesisht për shkak të pjesës shumë të madhe të popullatës rurale në vend. Vendet kandidate për në BE paraqesin nivele relativisht të ngjashme të qëndrueshmërisë së shërbimeve, por Kosova, për shembull, ka sektorin më të qëndrueshëm ndër to megjithëse ka PBB-në më të ulët për frymë, mbase për rrjedhojë të një kuadri të qartë dhe të stabilizuar të organizimit të sektorit (shih Kutinë në Kapitullin II). Së fundmi, Moldavia, vendi më pak i zhvilluar ekonomikisht në rajon, gjithashtu përballet edhe me mangësitë më të mëdha në arritjen e shërbimeve universale, efikase dhe të qëndrueshme.

123. **Megjithëse çdo vend është në një fazë të ndryshme, të gjitha vendet kanë fusha ku nevojiten përmirësime të mëtejshme.** Tabela 13 identifikon pikëzimin e përgjithshëm dhe rezultatin cilësor për secilën nga katër kategoritë e vlerësimit për çdo vend. Siç tregon edhe tabela, shumica e vendeve të BE-së punojnë mirë me sigurimin e aksesit në shërbime për të gjithë, dhe shumë vende në rajon ofrojnë cilësi të arsyeshme shërbimesh për ata që janë të lidhur me furnizimin publik. Axhenda e efikasitetit është tejet e rëndësishme për shumicën e vendeve të reja anëtare dhe për vendet jashtë BE-së. Financimi i shëndoshë i sektorit mbetet problematik në të gjithë rajonin, me disa përjashtime në vendet e hershme anëtare të BE-së.

FIGURA 62: VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SHËRBIMEVE KRAHASUAR ME PPB PËR FRYMË NË VENDET E RAJONIT



BURIMI: PËRPUKIMI NGA AUTORËT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS

TABELA 13: VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SHËRBIMEVE VEND PËR VEND

Kategoria e Qëndrueshmërisë	Shqipëria	Austria	Bullgaria	Bosnje dhe Herzegovina	Kroacia	Republika Çeke	Hungaria	Kosova	Maqedonia	Moldavia	Mali i Zi	Rumania	Serbia	Slovakia	Slovenia	Ukraina
Akresi	Yellow	Green	Yellow	Yellow	Green	Green	Green	Yellow	Yellow	Orange	Yellow	Yellow	Yellow	Green	Green	Yellow
Cilësia	Yellow	Green	Yellow	Yellow	Green	Green	Green	Yellow	Yellow	Orange	Yellow	Yellow	Yellow	Green	Green	Yellow
Efikasiteti	Yellow	Green	Yellow	Yellow	Green	Green	Green	Yellow	Yellow	Orange	Yellow	Yellow	Yellow	Green	Green	Yellow
Financimi	Orange	Green	Orange	Orange	Orange	Yellow	Orange	Orange	Orange	Orange	Orange	Orange	Orange	Orange	Yellow	Orange
Gjithsej	55	96	66	57	72	88	74	63	62	50	59	56	61	82	84	54

BURIMI: PËRLLQARTIJE E AUTORËVE BAZUAR NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS.

## B. Sfidat e Mbetura

124. **Duke qenë se rajoni po i kushton shumë rëndësi procesit të anëtarësimit në BE, duhet të trajtohen një sërë sfidash zhvillimore më të gjera për të ecur përpara me sukses, veçanërisht në shtetet e reja dhe të ardhshme anëtare.** Shqyrtimi tregon se si shtetet anëtare të BE-së, sidomos ato që janë anëtarësuar përpara vitit 2007, kanë përfituar nga një mjedis politikash përgjithësisht të stabilizuar dhe nga një vijueshmëri e qëndrueshme fondesh nga






BE-ja. Në veçanti aksesit në shërbime të ujërave të ndotura është rritur, performanca e kompanive të tyre komunale është përgjithësisht e barabartë me praktikat ndërkombëtare, dhe pavarësisht disa shqetësimeve në lidhje me përballeshmërinë, financimi i shërbimeve është gjithashtu i shëndoshë. Megjithatë, disa nga vendet anëtare të kohëve më të fundit dhe vendet kandidatë po përballen me një situatë krejtësisht ndryshe, dhe kanë mangësi të rëndësishme në shërbime bazë, sidomos për personat më të cenueshëm, janë duke u përqendruar më shumë tek thithja e investimeve se sa tek zgjidhjet me efikasitet në kosto, ofruesit e shërbimeve nuk janë shumë të përgatitur të ndërmarrin përgjegjësinë e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së aseteve të nevojshme, kanë shërbime të pa financuara, si dhe qeverisje të paplotë dhe të paqartë në sektor. Vëmendja e qeverive kuptohet që është e përqendruar në harmonizimin e legjislacionit të BE-së dhe zhvillimin e infrastrukturës së administrimit të ujërave të ndotura. Megjithatë, qeveritë duhet edhe të trajtojnë një sërë sfidash më të gjera, por me përkatësi në sektor, për t'u siguruar që të gjithë qytetarët përfitojnë plotësisht nga procesi i anëtarësimit në BE. Më poshtë jepet një përmbledhje e sfidave rajonale kyçe të identifikuar në këtë raport. Një diskutim më i plotë dhe i detajuar i sfidave të veçanta të secilit vend është përfshirë në Shënimet e Vendeve që shoqërojnë këtë raport rajonal dhe që janë të disponueshme edhe në faqen SoS.danubis.org.

- **Ndërkohë që ofrimi i shërbimeve mbetet përgjegjësi e qeverisjes vendore në shumicën e vendeve, reformat në politika që shoqërojnë procesin e anëtarësimit në BE, prirjen t'i nënshtrojnë këto shërbime ndaj mbikëqyrjes së shtuar rregullore dhe institucionale, duke krijuar kështu nevojën për mekanizma më të qartë llogaridhënie.** Pas valës fillestare të decentralizimit të fuqishëm dhe fuqizimit të qeverisjes vendore në vitet '90, reformat e lidhura drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me procesin e anëtarësimit në BE, po ritheksojnë gjithmonë e më shumë rolin e qeverive qendrore përmes krijimit të agjencive të reja rregullore kombëtare në më shumë se gjysmën e vendeve gjatë 15 viteve të fundit (kryesuar nga Shqipëria dhe Sllovakia) dhe përpjekjeve të ndryshme për të rajonalizuar apo grumbulluar ofruesit e shërbimeve (kryesuar nga Kosova dhe Rumania). Por në praktikë, zbatimi i këtyre reformave ka mbetur prapa. Rregullatorët e rinj shpesh kanë probleme me shtrirjen e ndikimit të tyre rregullator mbi një numër të madh ofruesish vendorë të shërbimeve publike dhe të arrijnë rezultate rregullore kuptimplota. Strategjitë e financimit të sektorit nuk janë ndërtuar bazuar në fillimin e zbatimit të parimit të rikuperimit të koston. Kompanitë komunale dhe administrata vijojnë të jenë gjerësisht të drejtuara nga interesat vendorë. Në shumë raste reformat nuk kanë sjellë akoma frytet e tyre, dhe puna analitike e ndërmarrë në kuadrin e shqyrtimit të Situatës së Sektorit tregon se ndikimi afatgjatë i këtyre politikave nuk është akoma i qartë. Ndërkohë që anëtarësimi në BE ofron një mundësi (ose justifikim) tundues për të përdorur modele rajonale, qeveritë do të bënin mirë të shqyrtonin arsyet reale që pengojnë aftësinë e institucioneve për plotësimin e mandatit të tyre dhe trajtimin e tyre duke përcaktuar përgjegjësi, llogaridhënie dhe kuadër shtysash të qartë për ofruesit e shërbimeve dhe qeverisjet vendore, përpara se të provojnë organizatat me shtrirje të gjerë.


**FIGURA 63: KU JANË KËTO TUALETE ME SHKARKUES OSE UJI NGA RRJETI NË RAJONIN E DANUBIT?**



BURIMI: PËRPUNIMI NGA AUTORËT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SOS

- ▶ **Ndërkohë që administrimi i ujërave të ndotura ka tërhequr shumicën e vëmendjes publike, ka 22.5 milion njerëz pa furnizim me ujë nga rrjeti dhe 28 milion pa tualete me shkarkim në rajonin e Danubit. Popullata rurale, të varfrit dhe minoritetet përfaqësohen me proporcion të zhdrejtë krahasuar me pjesën tjetër të popullatës në këto shifra** (Figura 63). Largimi dhe trajtimi i centralizuar i ujërave të ndotura është një qëllim i qartë i Direktivës për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane, dhe shumë qeveri janë të përqendruara në trajtimin e kësaj pike. Por, siç tregon edhe Figura 63, megjithëse niveli i përgjithshëm i aksesit në shërbime uji dhe sanitare është i lartë në të gjithë rajonin, ka akoma sfida të rëndësishme barazie për ofrimin e shërbimeve bazë dhe me cilësi të lartë të gjithëve. Për shembull, ka akoma 22.5 milion njerëz pa ujë nga rrjeti në banesat e tyre (shumica më e madhe e të cilëve, përdorin rrjete të përbashkëta, ose kanë burime apo puse në kopshtet e tyre), dhe 28 milion njerëz jetojnë pa tualete me shkarkim. Në këtë pikë popullata rurale, të varfrit dhe minoritetet përfaqësohen në raport të zhdrejtë me të tjerët. Edhe midis atyre që kanë akses në shërbime publike, tarifat që rriten me shpejtësi nënkuptojnë një barrë veçanërisht të madhe për 40 përqindëshin e poshtëm dhe për pjesën më të varfër të popullatës, sidomos në ato vende ku jetojnë pjesa më e madhe e popullatës së pa shërbyer (Moldavia, Rumania). Përballeshmëria e tarifave mund të kërcënojë përfitimet e zgjerimit të aksesit tek të gjithë përmes zhvillimit të infrastrukturës, nëse nuk zbatohen skema të shëndosha subvencionimi.
- ▶ **Performanca e shumë ofruesve shërbimesh në rajon është akoma prapa praktikave më të mira rajonale dhe ndërkombëtare, duke kërcënuar kështu qëndrueshmërinë afatgjatë të programeve të vazhdueshme të investimeve.** Ndërkohë që janë vënë re pririje pozitive që prej përfundimit të periudhës socialiste, gjatë viteve të fundit duket se progresi ka mbetur në vend dhe shumë kompani komunale, aktorët kryesorë që sigurojnë shërbime të qëndrueshme për të gjithë të paktën në zonat urbane, veprojnë në nivele më të ulëta se ato të praktikave të mira (Figura 64). Por, ky raport tregon se praktikave të përmirësuara të administrimit mund të ndihmojnë me lehtësimin e ndikimit kostovë në rritje të zhvillimit dhe administrimit të asetëve, si edhe se në shumicën e vendeve ka kompani që kanë performancë shumë më të mirë se ajo e kolegëve të tyre, pavarësisht organizimit dhe strukturës së sektorit. Mos trajtimi i performancës së kompanive komunale do të kërcënojë qëndrueshmërinë e investimeve të mëdha të vazhdueshme në infrastrukturë, veçanërisht për administrimin e ujërave të ndotura.

**FIGURA 64:** HENDEKU PËR PRAKTIKAT MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE PËR NJË KAMPION KOMPANISH KOMUNALE NË RAJON




BURIMI: TË DHËNA NGA IBNET / DANUBIS.ORG

- ▶ **Kuadri i përgjithshëm i financimit të sektorit nuk garanton shërbime universale me cilësi në këndvështrimin afatgjatë.** Direktiva e Kuadrit të Ujit dhe politikat e shëndosha të sektorit kanë sjellë përfshirjen e gjerë të parimit të rikuperimit të kostos në legjislacionin kombëtar, por shumë kompani komunale mezi arrijnë të rikuperojnë kostot e tyre të operimit nga tarifat, dhe tarifat përcaktohen gjerësisht duke marrë pak në konsideratë kuadrot rregullatorë ekzistues. Në të njëjtën kohë ky raport tregon se në shumicën e vendeve ka akoma hapësira të konsiderueshme për rritjen e tarifave pa krijuar kufizime në përballeshmëri për familjen mesatare. Financimi i investimeve, përfshirë nga fonde të BE-së, bëhet sipas rastit, dhe transfertat ndahen duke i kushtuar vëmendje të kufizuar barazisë dhe

efikasitetit të kostos së projekteve dhe tatime që ofrojnë subvencione pa pikësnyime të sakta (Figura 65). Tatimet dhe transfertat e konsiderueshme që shkojnë drejt sektorit të ujit përfaqësojnë një mundësi të humbur që qeveritë kombëtare të ofrojnë shtysat e duhura për ofruesit e shërbimeve. Hendeku i vlerësuar i investimeve është rreth 2.5 miliard USD në vit dhe nivelet e investimit në një sërë vendesh janë nën nivelet e nevojshme për të mirëmbajtur dhe administruar asetet në periudhën afatgjatë. Në të ardhmen pritet që kostot të vijnë të rriten me shpejtësi. Në mungesë të politikave të financimit të sektorit që sigurojnë shtysat e duhura të efikasitetit për ofruesit e shërbimeve si për operimin ashtu edhe për investime, shoqëruar me subvencione të qarta dhe të mirë përcaktuara për të trajtuar shqetësimet e përballeshmërisë së të varfërve, ofruesit e shërbimeve nuk do të jenë të aftë të ofrojnë shërbime universale dhe me cilësi të lartë në periudhën afatgjatë.

**FIGURA 65: MBULIMI I KOSTOS O&M DHE HENDEQET FINANCIARE NË INVESTIME NË RAJON**



PËRPUNIMI NGA AUTORËT BAZUAR NË MBLËDHJEN E TË DHËNAVE SOS, DUKE SUPOZUAR NEVOJAT E VENDIT PËR INVESTIMIN E PROJEKTUAR

- **Nevojiten më shumë të dhëna më të mira publike për politikë bërje të shëndoshë, përmirësim të performancës së kompanive komunale dhe llogaridhënie të administratës.** Një sfidë e përsëritur në shumë vende, dhe për t'u habitur, veçanërisht në ekonomitë më të avancuara përfshirë Austrinë apo Sloveninë, për shembull, është mungesa e të dhënave publike, të strukturuar, të besueshme dhe përfaqësuese mbi sektorin. Në mungesë të të dhënave dhe matjeve të qarta, drejtuesit e kompanive komunale nuk mund të vlerësojnë nëse veprimtaria e tyre është e barabartë me praktikat e mira. Pa informacion të besueshëm për financimin e sektorit, politikë bërësve u mungon një instrument kyç me të cilin të promovojnë shërbime të qëndrueshme, dhe në mungesë të të dhënave të vazhdueshme mbi aksesin në shërbime planifikuesit e sektorit nuk mund të sigurojnë që fondet e kufizuara publike u shkojnë atyre të cilëve u nevojiten më tepër. Mbase pika më e rëndësishme, duke patur parasysh shumtësinë e mëdha të fondeve publike që shpenzohen për të mbështetur shërbimet e ujit, është që qytetarët, tatimpaguesit dhe zyrtarët e tyre të zgjedhur në shumë vende nuk kanë akses në informacion transparent për t'i ndihmuar ata t'i kërkojnë llogari vendim marrësve të sektorit në të gjitha nivelet.

## C. Mundësitë

125. **Në përgjigje të sfidave të identifikuara në seksionin e mëparshëm, rajoni mund të ngrejë bazuar në disa mundësi të rëndësishme.** Krahasuar me rajonet e tjera në botë, sektori i shërbimeve të ujit në rajonin e Danubit ka disa asete të rëndësishme që mund të kthehen në mundësi për të vijuar me progresin e zhvillimit të sektorit, shpesh duke i kthyer sfidat në mundësi.

- ▶ **Procesi i integritit në BE vijon të paraqesë një mundësi të jashtëzakonshme për politika dhe financim për shumë vende.** Procesi i anëtarësimit në BE, për shumë vende të BE-së, ka qenë një mjet i rëndësishëm për të ngritur institucionet dhe për të forcuar shtetin ligjor. Pa dyshim që sektori i ujit do të përfitojë nga këto ndryshime. Më në veçanti për sektorin, procesi i negocimit dhe ndërmarrjes së angazhimeve të anëtarësimit krijon një kontroll më të madh të financimit dhe organizimit të sektorit. Vende si Bullgaria, Kroacia dhe Rumania i kanë përdorur këto procese për të planifikuar dhe zbatuar ndryshime të gjera dhe të mëdha në sektor. Për më tepër, fondet e BE-së, nëse përdoren si duhet, mund të jenë shtysë për ndryshime në sektor dhe të zvogëlojnë pabarazinë në ofrimin e shërbimeve.
- ▶ **Historia e kohëve të fundit ka treguar se sektori i ujit është i gatshëm për ndryshime.** Pavarësisht natyrës së tyre disi të paorganizuar, reformat e politikave të ndërmarra gjatë 15 viteve të fundit, që shkojnë nga decentralizimi tek partneriteti publik – privat dhe nga rajonalizimi në rregullim, tregojnë se sektori i ujit dhe ujërave të ndotura në rajonin e Danubit është shumë më i hapur ndaj ndryshimeve se sa në pjesë të tjera të botës. Në fakt, qeveritë në të paktën një të tretën e vendeve të rajonit po marrin aktualisht në konsideratë një reformë apo një tjetër. Nëse këto reforma janë të bazuara në analiza të shëndosha të sfidave thelbësore të sektorit dhe përmirësime graduale, ato mund të vijojnë të krijojnë moment pozitiv në sektor.
- ▶ **Miratimi i gjerë i kuadrove formale rregullatore dhe reformave të kthimit të kompanive komunale në korporata mund të ndihmojnë me promovimin e llogaridhënies më të madhe.** Decentralizimi masiv i veprave të ujit në qeverisjet vendore në fillimin e viteve '90 i fuqizoi shumë kryebashkiakët dhe qeverisjet vendore, duke e bërë llogaridhënien më të drejtpërdrejtë. Ndryshimet e kohëve të fundit në shumë vende për të krijuar kuadro më të fuqishme rregullatore, progresi i platformave të hapura të informacionit dhe legjisllacionit, modelet më të strukturuar të qeverisjes vendore të kompanive komunale (procesi i kthimit në korporatë) mund të ndihmojnë vendosjen e kontrolleve dhe ekuilibrave të duhur midis aktorëve të ndryshëm në nivel kombëtar dhe vendor.
- ▶ **Pavarësisht mangësive në drejtim, sektori mund të mbështetet në një forcë punëtore të fuqishme teknike.** Rajoni ka shumë shkolla dhe universitete të jashtëzakonshme teknike dhe stafi i kompanive dhe drejtuesit e nivelit të mesëm shpesh janë tejet të kualifikuar nga ana teknike. Me trajnimin e duhur për menaxhim dhe me ngritje kapacitetesh, këto burime mund të japin kontribut në vënien e institucioneve të sektorit në udhën e duhur. Shoqatat e veprave të ujit si OVGW në Austri, ARA në Rumani dhe SHUKALB në Shqipëri kanë pranuar rolin e rëndësishëm që ato luajnë në promovimin e kësaj rritje të profesionalizmit dhe po ofrojnë kurrikula formale trajnimi dhe, kur është e mundur, po llojnë që skemat e akreditimit të stafit të bëhen pjesë e kuadrit ligjor të sektorit. Në fakt, vetë Shoqata Kombëtare e Kompanive të Ujësllësimit në Zonën Ujëmbajtëse të Lumit Danub (IAWD) po diskuton aktualisht me shoqatat e veprave të ujit në rajon për të krijuar një partneritet më formal rajonal trajnimi.

## D. Fushat e Punës së Ardhshme

126. **Në disa raste duhet më shumë punë për të hartuar dhe zhvilluar politika të shëndosha për t'iu përgjigjur sfidave dhe mundësive të mësipërme dhe për të ofruar shërbime të qëndrueshme për të gjithë.** Ky studim i parë i Situatës së Sektorit ka konsoliduar një sasi tejet të madhe informacioni nga i cili mund të dallohen prirjet e hershme, por ka nxjerrë në pah fusha ku duhet më tepër punë për të qenë të aftë të nxirren përfundime të qarta dhe të jepet informacion për politika publike që i përgjigjen disa nga sfidave të identifikuara më lart.

- ▶ **Popullata pa ujë nga rrejtja dhe pa furnizim publik me ujë. Një numër i konsiderueshëm njerëzish nuk përfitojnë nga shërbimet publike dhe të ujit nga rrjeti në rajon, shpesh për shkak se ata jetojnë jashtë zonave të shërbimit të kompanive komunale.** Në mungesë të informacionit më të mirë se nga këta persona i marrin këto shërbime, me çfarë kostoje dhe cilësie, si dhe se cili do të ishte ndikimi i mirëqenies dhe ekonomik i ofrimit të niveleve më të larta të shërbimit për ta, është e vështirë të përcaktohet se si qeveritë mund të sigurojnë që e gjithë popullata të përfitojë nga shërbime të qëndrueshme. Duhet gjithashtu më shumë punë për të kuptuar se çfarë teknologjish (shih kutinë në Kapitullin IV), modelesh apo mekanizmash mbështetjeje me kosto të ulët apo me efikasitet kostoje gjatë ofrimit të shërbimit mund të zbatohen për të mbështetur popullatat pa i ngarkuar kompanitë komunale ekzistuese më shumë se ç'duhet duke i dhënë përgjegjësi për këto popullata.



- ▶ Shtysat e performancës së kompanive komunale. Përmirësimi i performancës së kompanive komunale është kyç për qëndrueshmërinë e shërbimeve që i ofrohen tre të katërtave të popullatës në rajonin e Danubit. Por ama, nuk arrihet të kuptohet mirë përse disa kompani komunale janë të suksesshme dhe disa të tjera jo. Shumë vende po mbledhin aktualisht lloje të ndryshme të dhënash mbi performancën e kompanive komunale dhe ky raport ka paraqitur një analizë të hershme të shtysave të performancës së kompanive. Megjithatë, disponueshmëria e të dhënave sistematike për periudha më të gjata kohore do t'i ndihmojë politikë bërësit në periudhën afatgjatë të kuptojnë prirjet dhe shtysat e performancës së kompanive komunale në vendet e tyre përkatëse dhe të marrin vendime të informuara mbi politikat.
- ▶ Përballueshmëria afatgjatë dhe subvencionet. Shumica e vendeve nuk po përballen akoma me probleme të konsiderueshme të përballueshmërisë së tarifave. Megjithatë, ka disa përjashtime dhe shumë vende presin të kenë rritje të vazhdueshme tarifash përtej nivelit të inflacionit. Duke qenë se pak vende kanë krijuar skema subvencionimi me pikësnyime të qarta për të lejuar zbatimin e parimit të rikuperimit të kostos pa krijuar probleme shoqërore, hartimi dhe zbatimi i përshtatshëm i skemave të tilla të subvencionimit duhet eksploruar më tej.
- ▶ Administrimi i ujërave të ndotura. Për shumicën e vendeve në zonën ujëmbajtëse të Danubit, administrimi i ujërave të ndotura dhe llumrave mbetet një sfidë e rëndësishme në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE. Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane kërkon nivele të konsiderueshme më të larta për largimin dhe trajtimin krahasuar me ato të mundësuar aktualisht dhe infrastruktura e re që po ndërtohet ose që duhet të ndërtohet krijon shtrëngime financiare dhe teknike për ofruesit e shërbimeve komunale. Kostot e operimit dhe vështirësitë sjellin mos funksionimin e përshtatshëm të disa impianteve dhe se duhen zhvilluar modele alternative të dhënies së shërbimit, që përfshijnë modele novatore të financimit dhe organizime të reja institucionale.

127. **Shumica e këtyre fushave duhet të trajtohen në nivel kombëtar në vendet ku sfidat përkatëse janë më të vështira, por puna e mëtejshme në nivel rajonal do të ndihmonte me dokumentimin dhe informimin më të gjerë të politikë bërjes.** Institucionet akademike, grupimet e rrahjes së ideve dhe partnerët për zhvillim do të luajnë rolin e tyre në trajtimin e këtyre mangësive në njohuri. Për më tepër, autorët shpresojnë se Programi i Ujit i Danubit do të jetë i aftë të mbështesë punën për të trajtuar disa nga pikat e diskutuara më lart në vitet e ardhshme së bashku me qeveritë e interesuara dhe me palët e interesit.

128. **Ky raport paraqiti situatën e sektorit dhe sfidat dhe mundësitë e tij kryesore, por nuk ofron rekomandime për politika.** Nëse politikë bërësit dhe administratorët e kompanive komunale dëshirojnë të marrin vetëm një gjë nga ky raport, kjo gjë lidhet me rëndësinë që ka për çdo qeveri dhe administratë kompanie analiza e sfidave të tyre aktuale bazuar në informacione të shëndosha, të mësuarit nga suksesi dhe gabimet e të tjerëve, dhe hartimi i një rruge progresi që do të pasqyrojë realitetin e tyre aktuale dhe përvojën rajonale dhe ndërkombëtare. Shumë nga sfidat dhe mundësitë e nënvizuara më lart, janë fusha ku po punohet aktualisht në kuadrin e Programit të Ujit të Danubit, dhe programi do të mundohet të punojë përkrah partnerëve të tij për të vazhduar me plotësimin e mangësive të nxjerra në pah nga analiza. Përpjekja e Programit të Ujit të Danubit ka qenë të ofrojë informacion për procese të tilla duke dokumentuar përvojat në të gjithë rajonin dhe duke mëkuar dialog përtej kufijve institucionalë dhe politikë. Autorët shpresojnë që ky raport të japë kontribut për realizimin e **politikave inteligjente, kompanive komunale të fuqishme dhe shërbimeve të qëndrueshme** për të gjithë.



# FAQET E VENDEVE

Faqet e Vendeve në vijim rendisin treguesit kryesorë të përdorur gjatë raportit dhe vlerat e mbledhura gjatë përpjekjes së mbledhjes së të dhënave SoS për secilin vend, së bashku me vitin dhe burimin dhe një vlerësim me vendet në faza të ngjashme anëtarësimi në BE, si dhe mesataren e përgjithshme të rajonit (të dyja në proporcion me popullatën).

Grafiku në fillim të çdo faqeve vendi paraqet rezultatet e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Sektorit. Rezultatet e vendit janë të shënuara me blu, ndërsa praktika më e mirë rajonale është në ngjyrë të gjelbër, kurse mesatarja me ngjyrë të kuqe.

Për më shumë detaje rreth qasjes metodologjike, ju lutemi të këshilloheni me shënimet metodologjike në fund të këtij dokumenti.




# SHQIPËRIA

Vend Kandidat për në BE

Vlerësimi i Qëndrueshmërisë së Sektorit

## 55



Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e shteteve anëtare BE	Mesatarja e Danubit	Më e mira e Danubit
<b>Konteksti i Shërbimeve</b>						
<b>Situata Social Ekonomike</b>						
Popullata [Milbanorë]	2013	B. Botërore 2015	2.774	3.053	8.451	n.a.
Rritja e Popullatës [shkalla e përbërë e rritjes 1990 -2013] [%]	1990-2013	B. Botërore 2015	-0.74	-0.33	-0.37	n.a.
Pjesa e popullatës urbane [%]	2013	B. Botërore 2015	55	51	63	n.a.
PBB për frymë, PPP [ndërkombëtare aktuale \$]	2013	B. Botërore 2015	10,489	11,154	16,902	n.a.
Raporti i varfërisë për frymë [\$2.50 në ditë [PPP] [% e popullatës]]	2012	B. Botërore 2015	6.7	3.55	1.65	n.a.
<b>Organizimi Administrativ</b>						
Nr. i njësive të qeverisjes vendore [bashkive]	2014	MSCV 2014	374 (to be 61)	85	1,987	n.a.
Përmasat mesatare të njësive të qeverisjes vendore [banorë]	2013	Llogaritje e autor.	7,416 (to be 45,469)	35,850	4,253	n.a.
<b>Burimet Ujore</b>						
Disponueshmëria e plotë e ujit të rinovueshëm [m <sup>3</sup> /frymë/vit]	2008-2012	FAO Aquastat 2015	9,551	8,128	7,070	n.a.
Tërheqja vjetore e ujërave të ëmbla,vendore [% e totalit të tërheqjeve]	2013	B. Botërore 2015	43	18	26	n.a.
Pjesa e ujërave sipërfaqësore si burim uji të pijshëm [%]	2014	ICPDR 2015	17	42	31	n.a.
<b>Organizimi i Shërbimeve</b>						
Numri i ofruesve formalë të shërbimit të ujit	2013	GDWSS 2013	58	75	661	n.a.
Popullata mesatare e shërbyer [banorë]	2013	Llogaritje e autor.	36,822	28,963	9,496	n.a.
Lloji kryesor i ofruesit të shërbimeve	Shoqëri anonime të ujësjellës kanalizimeve					
Fushëveprimi i shërbimit	Ujë dhe/ose shërbime sanitare					
Pronësia	Qeverisja vendore					
Shtirirja gjeografike	Kryesisht disa njësi të qeverisjes vendore					
Ligj për shërbimet e ujit?	Jo					
Ministri e vetme linje?	Po [Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës]					
Agjenci rregullatore?	Po [ERRU]					
Treguesit e performancës së komp. komunale mundësuar publikisht?	Po [www.erru.al]					
Shoqatë kombëtare kompanish komunale?	Po [SHUKALB për ujësjellës dhe kanalizime]					
Pjesëmarrja e sektorit privat	Vetëm përmes kontraktimit					
<b>Aksesi në Shërbime</b>						
<b>Furnizimi me ujë</b>						
Furnizimi nga rrjeti - mesatare [%]	2012	Llogaritje e autor.	78	89	83	100
Furnizimi nga rrjeti - 40%-shi i poshtëm [%]	2012	Llogaritje e autor.	72	81	76	100
Furnizimi nga rrjeti –më pak se \$2.50/ditë [PPP][%]	2012	Llogaritje e autor.	66	73	61	100
Përfshirë nga furnizimi publik - mesatare [%]	2013	GDWSS 2013	77	71	74	99





### Shërbimet Sanitare dhe Kanalizimet

Tualete me shkarkim - mesatare [%]	2012	Llogaritje e autor.	89	90	79	99
Tualete me shkarkim - 40%-shi i poshtëm	2012	Llogaritje e autor.	82	81	70	98
Tualete me shkarkim –më pak se \$2.50 / ditë [PPP] [%]	2012	Llogaritje e autor.	79	76	54	100
Përfshirë me kanalizime – mesatare [%]	2013	GDWSS 2013	64	53	66	94

### Trajtimi i ujërave të ndotura

Lidhur me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura [%]	2013	Vlerësim i eksp.	13	9	45	95
---	------	------------------	----	---	----	----

### Performanca e Shërbimeve

#### Cilësia e shërbimit

Konsumi familjar i ujit [litra/frymë/ditë]	2013	GDWSS 2013	95	165	122	n.a.
Vijueshmëria e furnizimit me ujë [orë/ditë]	2013	GDWSS 2013	12	19	20	24
Cilësia e ujit të pijshëm [% e kampionëve në përputhshmëri të plotë]	2013	GDWSS 2013	98	83	93	99.9
Cilësia e trajtimit të ujërave të ndotura [% e kampionëve në përputhje të plotë me BOD5]	–	–	–	n.a.	79	100
Bllokime kanalizimesh [numër/km/vit]	2013	IBNet 2015	15.0	9.3	5.0	0.2
Kënaqësia e klientëve [% e popullatës kënaqur me shërbimin]	2013	Gallup 2013	58	63	63	95

#### Efikasiteti

Uji pa të ardhura [%]	2013	GDWSS 2013	67	50	35	16
Uji pa të ardhura [m <sup>3</sup> /km/ditë]	2013	IBNet 2015	68	41	35	5
Prodhimtaria e stafit [ujësjellës dhe kanalizime][numri i punonjësve/1.000 lidhje]	2013	GDWSS 2013	5.6	11.5	9.6	2.0
Prodhimtaria e stafit [ujësjellës dhe kanalizime][numri i punonjësve/1.000 banorë të shërbyer]	2013	IBNet 2015	1.4	2.4	1.7	0.4
Shkalla e mbledhjes së faturave [të ardhura në para/të ardhurat e faturuara] [%]	2013	GDWSS 2013	82	85	98	116
Niveli i matjeve [lidhjet me matës/lidhjet] [%]	2013	GDWSS 2013	59	81	84	100
Indeksi i Performancës së Kompanive të Ujit [WUPI]	n.a.	Llogaritje e autor.	51	59	69	94

### Financimi i Shërbimeve

#### Burimet e Financimit

Financimi i përgjithshëm i sektorit [Euro/frymë/vit]	Llogaritje e autorëve	32	29	62	n.a.
Financimi i përgjithshëm i sektorit [raporti me PBB] [%]	Llogaritje e autorëve	0.39	0.34	0.45	n.a.
Përqindja e kostove të shërbimit financiar nga tarifat	Llogaritje e autorëve	50	67	67	n.a.
Përqindja e kostove të shërbimit financiar nga tatimet	Llogaritje e autorëve	26	17	13	n.a.
Përqindja e kostove të shërbimit financiar nga transfertat	Llogaritje e autorëve	24	16	20	n.a.

#### Shpenzimet e shërbimeve

Investimet mesatare vjetore [raporti me investimin e përgjithshëm të sektorit] [%]	Llogaritje e autorëve	48	32	38	n.a.	
Investimet mesatare vjetore [Euro/frymë/vit]	Llogaritje e autorëve	15	9	23	n.a.	
Vlerësim i investimeve të nevojshme për të arritur synimet [€/frymë/vit]	2012-2040	MPËT 2012	63	37	43	n.a.
Nga të cilat, pjesa për administrimin e ujërave të ndotura [%]	Llogaritje e autor.	80	70	61	n.a.	

#### Rikuperimi i Kostos

Tarifa mesatare familjare [ujësjellës dhe kanalizime përfshirë] [€/m <sup>3</sup> ]	2013	GDWSS 2013	0.74	0.57	1.32	n.a.
Kosto e operimit dhe mirëmbajtjes për njësi [€/m <sup>3</sup> ]	Llogaritje e autorëve	0.62	0.45	1.20	n.a.	
Mbulimi i kostove të operimit [të ardhura të faturuara/shpenzime operative]	2013	GDWSS 2013	0.95	1.01	0.96	1.49

#### Përbalueshmëria

Raporti i shpenzimeve të mundshme UK me të ardhurat mesatare [%]	2012	Llogaritje e autor.	2.2	1.6	2.6	n.a.
Raporti i shpenzimeve të mundshme UK me të ardhurat e 40%-shittë poshtëm [%]	2012	Llogaritje e autor.	3.3	2.5	3.8	n.a.
Pjesa e familjeve me shpenzime të mundshme UK mbi 5% [%]	2012	Llogaritje e autor.	3.1	1.6	14.1	n.a.

### të të ardhurave mesatare [%]

Vlerësimi i Qëndrueshmërisë së Sektorit	n.a.	Llogaritje e autor.	55	59	64	96
---	------	---------------------	----	----	----	----

# AUSTRIA

Shtet Anëtar i BE

Vlerësimi i Qëndrueshmërisë së Sektorit  
**96**



Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e shteteve anëtare BE	Mesatarja e Danubit	Më e mira e Danubit
----------	------	--------	-------	---------------------------------	---------------------	---------------------

### Konteksti i Shërbimeve

#### Situata Social Ekonomike

Popullata [Milbanorë]	2013	B. Botërore 2015	8,474	8,481	8,451	n.a.
Rritja e Popullatës [shkalla e përbërë e rritjes 1990-2013] [%]	1990-2013	B. Botërore 2015	0.43	-0.26	-0.37	n.a.
Pjesa e popullatës urbane [%]	2013	B. Botërore 2015	66	63	63	n.a.
PBB për frymë, PPP [ndërkombëtare aktuale \$]	2013	B. Botërore 2015	44,149	24,535	16,902	n.a.
Raporti i varfërisë për frymë [\$2.50 në ditë [PPP] [% e popullatës]]	—	—	—	1.86	1.65	n.a.

#### Organizimi Administrativ

Nr. i njësive të qeverisjes vendore [bashkive]	2014	Statistika Austria 2015	2,354	2,335	1,987	n.a.
Përmasat mesatare të njësive të qeverisjes vendore [banorë]	2013	Llogaritje e autor.	3,600	3,632	4,253	n.a.

#### Burimet Ujore

Disponueshmëria e plotë e ujit të rinovueshëm [m <sup>3</sup> /frymë/vit]	2008-2012	FAO Aquastat 2015	9,180	10,142	7,070	n.a.
Tërheqja vjetore e ujërave të ëmbla, vendore [% e totalit të tërheqjeve]	2013	B. Botërore 2015	18	38	26	n.a.
Pjesa e ujërave sipërfaqësore si burim uji të pijshëm [%]	2014	ICPDR 2015	0	16	31	n.a.

### Organizimi i Shërbimeve

Numri i ofruesve formalë të shërbimit të ujit	2015	ÖVGW 2015	5,465	1,060	661	n.a.
Popullata mesatare e shërbyer [banorë]	2013	Llogaritje e autor.	1,395	6,643	9,496	n.a.
Lloji kryesor i ofruesit të shërbimeve	Vendor / kompani komunale bashkiake					
Fushëveprimi i shërbimit	Ujë dhe / ose shërbime sanitare					
Pronësia	Bashkitë vendore / borde, kooperativa					
Shtirja gjeografike	Vendore / rajonale					
Ligj për shërbimet e ujit?	Po					
Ministri e vetme linje?	Po [Ministria e Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit dhe Administrimit të Ujërave]					
Agjenci rregullatore?	Jo					
Treguesit e performancës së komp. komunale mundësuar publikisht?	Jo					
Shoqatë kombëtare kompanish komunale?	Po [ÖVGW për ujin dhe OWAV për ujërat e ndotura]					
Pjesëmarrja e sektorit privat	Jo					

### Aksesit në Shërbime

#### Furnizimi me ujë

Furnizimi nga rrjeti - mesatare [%]	2012	Llogaritje e autor.	100	91	83	100
Furnizimi nga rrjeti - 40%-shi i poshtëm [%]	2012	Llogaritje e autor.	100	85	76	100
Furnizimi nga rrjeti - më pak se \$2.50/ditë [PPP][%]	2012	Llogaritje e autor.	100	77	61	100
Përfshirë nga furnizimi publik - mesatare [%]	2012	BMLFUW 2012	90	83	74	99



### Shërbimet Sanitare dhe Kanalizimet

Tualete me shkarkim - mesatare [%]	2012	Llogaritje e autor.	99	83	79	99
Tualete me shkarkim - 40%-shi i poshtëm	2012	Llogaritje e autor.	98	74	70	98
Tualete me shkarkim –më pak se \$2.50 / ditë [PPP] [%]	2012	Llogaritje e autor.	100	63	54	100
Përfshirë me kanalizime – mesatare [%]	2012	BMLFUW 2014	94	67	66	94

### Trajtimi i ujërave të ndotura

Lidhur me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura [%]	2012	BMLFUW 2014	95	62	45	95
---	------	-------------	----	----	----	----

### Performanca e Shërbimeve

#### Cilësia e shërbimit

Konsumi familjar i ujit [litra/frymë/ditë]	2012	Vlerësim i eksp.	140	113	122	n.a.
Vijueshmëria e furnizimit me ujë [orë/ditë]	2013	Vlerësim i eksp.	24	24	20	24
Cilësia e ujit të pijshëm [% e kampionëve në përputhshmëri të plotë]	2010	BMG 2015	99.9	96	93	99.9
Cilësia e trajtimit të ujërave të ndotura [% e kampionëve në përputhje të plotë me BOD5]	2012	BMLFUW 2014	100	79	79	100
Bllokime kanalizimesh [numër/km/vit]	–	–	–	3.0	5.0	0.2
Kënaqësia e klientëve [% e popullatës kënaqur me shërbimin]	2013	Gallup 2013	95	78	63	95

#### Efikasiteti

Uji pa të ardhura [%]	2012	ÖVGW 2015	16	34	35	16
Uji pa të ardhura [m <sup>3</sup> /km/ditë]	2012	ÖVGW 2015	7	14	35	5
Prodhimtaria e stafit [ujësjellës dhe kanalizime][numri i punonjësve/1.000 lidhje]	2012	ÖVGW 2015	2.0	8.7	9.6	2.0
Prodhimtaria e stafit [ujësjellës dhe kanalizime][numri i punonjësve/1.000 banorë të shërbyer]	2012	ÖVGW 2015	0.39	1.0	1.7	0.4
Shkalla e mbledhjes së faturave [të ardhura në para/të ardhurat e faturuara] [%]	2013	ÖVGW 2015	105	102	98	116
Niveli i matjeve [lidhet me matës/lidhjet] [%]	2012	ÖVGW 2015	100	96	84	100
Indeksi i Performancës së Kompanive të Ujit [WUPI]	n.a.	Llogaritje e autor.	94	80	69	94

### Financimi i Shërbimeve

#### Burimet e Financimit

Financimi i përgjithshëm i sektorit [Euro/frymë/vit]	Llogaritje e autorëve	185	101	62	n.a.
Financimi i përgjithshëm i sektorit [raporti me PBB] [%]	Llogaritje e autorëve	0.57	0.55	0.45	n.a.
Përqindja e kostove të shërbimit financiar nga tarifat	Llogaritje e autorëve	87	65	67	n.a.
Përqindja e kostove të shërbimit financiar nga tatimet	Llogaritje e autorëve	13	10	13	n.a.
Përqindja e kostove të shërbimit financiar nga transfertat	Llogaritje e autorëve	0	25	20	n.a.

#### Shpenzimet e shërbimeve

Investimet mesatare vjetore [raporti me investimin e përgjithshëm të sektorit] [%]	Llogaritje e autorëve	40	42	38	n.a.	
Investimet mesatare vjetore [Euro/frymë/vit]	Llogaritje e autorëve	73	42	23	n.a.	
Vlerësim i investimeve të nevojshme për të arritur synimet [€/frymë/vit]	2013-2021	KPC 2014	91	65	43	n.a.
Nga të cilat, pjesa për administrimin e ujërave të ndotura [%]	Llogaritje e autorëve	57	64	61	n.a.	

#### Rikuperimi i Kostos

Tarifa mesatare familjare [ujësjellës dhe kanalizime përfshirë] [€/m <sup>3</sup> ]	2012	Vlerësim i eksp.	3.25	2.18	1.32	n.a.
Kosto e operimit dhe mirëmbajtjes për njësi [€/m <sup>3</sup> ]	Llogaritje e autorëve	2.43	1.77	1.20	1.20	
Mbulimi i kostove të operimit [të ardhura të faturuara/shpenzime operative]	2012	Llogaritje e autor.	1.44	1.10	0.96	1.49

#### Përballueshmëria

Raporti i shpenzimeve të mundshme UK me të ardhurat mesatare [%]	2012	Llogaritje e autor.	1.0	3.1	2.6	n.a.
Raporti i shpenzimeve të mundshme UK me të ardhurat e 40%-shittë poshtëm [%]	2012	Llogaritje e autor.	1.6	4.7	3.8	n.a.
Pjesa e familjeve me shpenzime të mundshme UK mbi 5% [%]	2012	Llogaritje e autor.	1.4	24.7	14.1	n.a.

### Qëndrueshmëria e Shërbimeve


Vlerësimi i Qëndrueshmërisë së Sektorit	n.a.	Llogaritje e autor.	96	74	64	96
---	------	---------------------	----	----	----	----

# BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Vend i Mundshëm Kandidat për BE

Vlerësimi i Qëndrueshmërisë së Sektorit

## 57



Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e shteteve anëtare BE	Mesatarja e Danubit	Më e mira e Danubit
----------	------	--------	-------	---------------------------------	---------------------	---------------------

### Konteksti i Shërbimeve

#### Situata Social Ekonomike

Popullata [Milbanorë]	2013	B. Botërore 2015	3.829	3.053	8.451	n.a.
Rritja e Popullatës [shkalla e përbërë e rritjes 1990-2013] [%]	1990-2013	B. Botërore 2015	-0.72	-0.33	-0.37	n.a.
Pjesa e popullatës urbane [%]	2013	B. Botërore 2015	39	51	63	n.a.
PBB për frymë, PPP [ndërkombëtare aktuale \$]	2013	B. Botërore 2015	9,632	11,154	16,902	n.a.
Raporti i varfërisë për frymë [\$2.50 në ditë [PPP] [% e popullatës]]	2007	B. Botërore 2015	0.40	3.55	1.65	n.a.

#### Organizimi Administrativ

Nr. i njësive të qeverisjes vendore [bashkive]	2009	UNDP 2009	142	85	1,987	n.a.
Përmasat mesatare të njësive të qeverisjes vendore [banorë]	2013	Llogaritje e autor.	26,967	35,850	4,253	n.a.

#### Burimet Ujore

Disponueshmëria e plotë e ujit të rinovueshëm [ $m^3$ /frymë/vit]	2008-2012	FAO Aquastat 2015	9,781	8,128	7,070	n.a.
Tërheqja vjetore e ujërave të ëmbla, vendore [% e totalit të tërheqjeve]	—	—	—	18	26	n.a.
Pjesa e ujërave sipërfaqësore si burim uji të pijshëm [%]	2014	ICPDR 2015	19	42	31	n.a.

### Organizimi i Shërbimeve

Numri i ofruesve formalë të shërbimit të ujit	2014	UPKP 2015 & Gov. RS 2015	142	75	661	n.a.
Popullata mesatare e shërbyer [banorë]	2013	Llogaritje e autor.	15,641	28,963	9,496	n.a.
Lloji kryesor i ofruesit të shërbimeve	Bashkiakë					
Fushëveprimi i shërbimit	Ujë dhe shërbime sanitare					
Pronësia	Njësitë e qeverisjes vendore					
Shtirja gjeografike	Nga një në disa qytete					
Ligj për shërbimet e ujit?	Jo					
Ministri e vetme linje?	Po [FMPVS në FBiH & MSPCEE në RS]					
Agjenci rregullatore?	Jo					
Treguesit e performancës së komp. komunale mundësuar publikisht?	Jo					
Shoqatë kombëtare kompanish komunale?	Po [UPKP për FBiH / shërbimet komunale dhe VRS për RS]					
Pjesëmarrja e sektorit privat	Kufizuar në disa shërbime të vogla uji					

### Aksesit në Shërbime

#### Furnizimi me ujë

Furnizimi nga rrjeti - mesatare [%]	2012	Llogaritje e autor.	88	89	83	100
Furnizimi nga rrjeti - 40%-shi i poshtëm [%]	2012	Llogaritje e autor.	81	81	76	100
Furnizimi nga rrjeti - më pak se \$2.50/ditë [PPP] [%]	—	—	—	73	61	100
